



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Tretë Specializim Afatgjatë në
“Sëmundje të aparatit kardiovaskular”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë

Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:



1. Prof. Aziz Pollozhani
2. Dr.Shk. Daniela Teferiçi

Tetor/2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Specializime Afatgjata në “Sëmundje të aparatit kardiovaskular” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Mjekësore
3	Emërtimi i programit të studimit:	Specializime Afatgjata në “Sëmundje të aparatit kardiovaskular”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 664, datë 28.12.2017
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i tretë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	4 vite / 8 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	240 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Italisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Në bashkëpunim me Universitetin e Romës “Tor Vergata”
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 8
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	15 PAE: 8 Dr., 4 Prof. As. dhe 2 Prof. dhe 2 PAK: 1 Dr. dhe 1 Prof.As. 9 personel akademik udhëheqës klinik: 5 Dr., 3 Prof.As dhe 1 Prof.
18	Numri i studentëve:	18-19: 6 studentë 19-20: 8 studentë 20-21: 4 studentë 21-22: 6 studentë 22-23: Nuk ka



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës (200-400 fjalë)

Programi i studimit specializues afatagjatë në “Sëmundje të aparatit kardiovaskular”, ofruar nga Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, është hapur me Urdhër të MASR Nr. 664, datë 28.12.2017 dhe ka filluar veprimtarinë e tij akademike në vitin akademik 2018-2019. Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Shkencave Mjekësorë, Fakulteti i Mjekësisë në UNIZKM.

Programi i studimit specializues afatagjatë në “Sëmundje të aparatit kardiovaskular” realizohet me 240 kredite, me formë studimi me kohë të plotë dhe kohëzgjatje normale 4 vite akademike. Programi i përket nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe në fund të tij lëshohet diplomë specializimi në “Sëmundje të aparatit kardiovaskular”.

Programi i studimit ofrohet në bashkëpunim me Universitetin e Romës “Tor Vergata”. Diploma e lëshuar në përfundim të studimeve lëshohen vetëm nga Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”.

Prej hapjes së këtij programi studimi, janë regjistruar në program në total 30 studentë, si në vijim:

2018-2019: 8 studentë të regjistruar për herë të parë, prej të cilëve 2 janë çregjistruar dhe 1 ka pezulluar studimet për arsye personale;

2019-2020: 9 studentë të regjistruar për herë të parë, prej të cilëve 1 është çregjistruar;

2020-2021: 6 studentë të regjistruar për herë të parë, prej të cilëve 2 janë çregjistruar;

2021-2022: 7 studentë të regjistruar për herë të parë, prej të cilëve 1 është çregjistruar.

Për sa më lart, aktualisht në këtë program studimi janë 24 studentë.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës (200-400 fjalë)

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të jashtëm të ndjekur nga ASCAL. GVJ është trajnuar paraprakisht nga ASCAL, ku janë njohur me parimet kryesore të një procesi vlerësimi. Raporti i vlerësimit të jashtëm përmban informacionet e mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që Institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces vlerësimi. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin sa më reale, shkallën e përmbushjes së standardeve të cilësisë së Institucionit në ofrimin e këtij programi studimi, sipas 4 niveleve:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof. Aziz Pollozhani dhe Dr. Daniela Teferiçi. Gjatë këtij procesi GVJ është asistuar nga Koordinatorja Teknike e ASCAL Msc. Ersi Dako.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar dokumentat dhe informacionet e përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e Raportit të jashtëm, si dhe ka orientuar GVJ për hartimin e pyetjeve të cilat u realizuan gjatë vizitës në Institucion. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë edhe gjatë vizitës në institucion të zhvilluar në datat 15 dhe 16 Qershor 2023, sipas agjendës së hartuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm me asistencën e ASCAL.

Më datë 12.10.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 167/14 Prot., datë 12.10.2023, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

IAL, përmes AMS, më datë 13.10.2023, me shkresë zyrtare Nr. 27/4 Prot., datë 13.10.2023, ka dërguar komente mbi draft raportin. GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si në vijim:

1. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin I.6:

Komenti i IAL: Për një formim më të mirë të specialistëve në programet e specializimit UNIZKM mbështetet në Marrëveshjen e bashkëpunimit me Universitetin "Tor Vergata", Romë. Njësia kryesore që e ofron programin e studimit është Fakulteti i Mjekësisë pranë

Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" dhe Universiteti "Tor Vergata" Romë është Universiteti Partner ose njësia bashkëpunuese dhe jo njësia përgjegjëse.

Komenti i GVJ: Pas shqyrtimit të komentit nga Institucioni, GVJ ka marrë në konsideratë komentin dhe ka pasqyruar në këtë standard saktësimin e formulimit të fjalisë.

2. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin II.1:

Komenti i IAL: Drejtuesi i Departamentit të Shkencave Mjekësore të Fakultetit, në bashkëpunim të ngushtë me Drejtuesin e Shkollës së Specializimit dhe me mjekët udhëheqës klinikë, organizojnë aktivitetin praktik dhe klinik të specializantëve dhe bëjnë vlerësimin e arritjeve të specializantëve, gjithmonë duke pasur si referim udhëzimet dhe standardet e parashikuara nga VKM datë 24.12.2021 (këtu bashkëngjitur relacionet vjetore të specializantëve sipas Udhëzimeve të Ministrisë).



Komenti i GVJ: Në modelin e vlerësimit nga tutori klinik, nuk ka një shprehje me njësi matëse të punës së kryer në strukturën spitalore përkatëse, kështu që gjetjet e vendosura nga GVJ në këtë standard nuk ndryshojnë.

3. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin II.2, II.4 dhe II.6:

Komenti i IAL: Përditësimi i parë i rregullores së specializimeve është realizuar në tetor të vitit 2019 dhe është vendosur të shqyrtohet me përparësi në mbledhjen e ardhshme të Senatit Akademik të UNIZKM dhe anëtarëve pjesëmarrës nga Universiteti "Tor Vergata", Romë, përditësimi i kësaj rregulloreje, konform udhëzimeve dhe standardeve të Ministrisë, duke përfshirë kontratat e specializantëve, modelimin e kohëzgjatjes maksimale të programit të studimit dhe standardet e përcaktuara të vlerësimit.

Komenti i GVJ: Sikurse është cituar dhe konfirmuar në komentin e IAL-së, përditësimi i rregullores pritet të shqyrtohet në mbledhjen e ardhshme të Senatit Akademik të UNIZKM dhe anëtarëve pjesëmarrës nga Universiteti "Tor Vergata", Romë. Duke qenë se GVJ, për vlerësimin e përmbushjes së standardeve, bazohet në dokumentacionin aktual të përcjellë nga Institucioni dhe që është aktualisht në fuqi, përfshirë dhe rregulloren e studimeve të specializimi, gjetjet e vendosura nga GVJ në këto standarde nuk ndryshojnë.

4. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin II.11:



Komenti i IAL: Drejtuesi i Departamentit të Shkencave Mjekësore të Fakultetit të Mjekësisë, në komunikim të vazhdueshëm me Drejtuesin e Shkollës së Specializimit përgatit raporte vjetore për mbarëvajtjen e specialitetit (këtu bashkëngjitur relacionet vjetore).

Komenti i GVJ: Pas shqyrtimit të komentit dhe dokumentacionit të përcjellë nga IAL bashkëngjitur këtij komenti, GVJ shprehet se do të shtojë në argumentimin e tij në standard informacionin mbi hartimin e relacionit nga Përgjegjësi i Departamentit, por i qëndron gjykimit të dhënë nga ana e tij, pasi relacioni nuk përbën një raportim të mirëfilltë dhe nuk jep një informacion të plotë mbi ecurinë e programit të specializimit të hartuar nga njësia kryesore.

5. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin III.2 dhe III.5:



Komenti i IAL: Aktualisht specialistët e programit të studimit “Sëmundje të Aparatit Kardiovaskular” zhvillojnë aktivitetin e tyre pranë strukturave Spitalore: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Universiteti “Tor Vergata”, Spitali Vaninni “Figlie di San Camillo”, Policlinico “Casilino”, të cilat janë struktura me kapacitete funksionale dhe maksimale për të pëmbushur aktivitetin praktik. Specialistëve u ofrohet mundësia që gjatë viteve të zhvillimit të programit të mund të kalojnë nga një strukturë në tjetrën për të pëmbushur çdo aspekt të aktivitetit klinik. Në momentin që do të kemi specialistët për të frekuentuar struktura të cilat nuk janë qendra spitalore të mëdha, do kërkohet çdo e dhënë për të vërtetuar kapacitetet infrastrukturore dhe të burimeve njerëzore që të pëmbushin kriteret e parashikuara në udhëzimin e Ministrisë.

Aktualisht, specialistët nuk zhvillojnë aktivitet praktik pranë Spitalit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” dhe në momentin që kjo strukturë do jetë me kapacitete plotësisht funksionale dhe e akredituar dhe mjekët të pëmbushin kriteret për të qenë tutor klinik, do të merret në konsideratë mundësia e zhvillimit të aktivitetit praktik nga ana e specialistëve duke pasur në objektiv një bashkëpunim të frytshëm të të dy palëve.



Komenti i GVJ: Pas shqyrtimit të komentit të IAL, GVJ inkurajon institucionin për punën e mëtejshme dhe masat që mund të marrë në vijim, por duke qenë se GVJ, për vlerësimin e pëmbushjes së standardeve, bazohet në situatën dhe gjetjet aktuale përfshirë vizitën në ambjentet spitalore, gjetjet e vendosura nga GVJ në këto standarde nuk ndryshojnë.

6. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin III.6:

Komenti i IAL: Dëshirojmë të sjellim në vëmendjen tuaj se Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë, pjesë e së cilës është UNIZKM, depoziton çdo vit pranë Drejtorisë Tatimore, Bilancin Vjetor sipas legjislacionit shqiptar, i cili tregon performancë financiare pozitive dhe të qëndrueshme. Gjithashtu, institucioni ka raporte vjetore auditimi që mbulon fushat e veprimtarisë së tij.





Komenti i GVJ: Pas shqyrtimit të komentit nga IAL, GVJ ka shtuar këtë informacion në analizën e bërë prej tij në këtë standard, por nga IAL nuk është përcjellë ndonjë e dhënë apo dokument provues për raporte financiare apo raportet vjetore të auditimit për të mbështetur komentin e bërë, ndaj gjetjet e GVJ në këtë standard nuk ndryshojnë.





Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Tretë Specializim Afatgjatë në “Sëmundje të Aparatit Kardiovaskular”

I. KUADRI I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT SPECIALIZIM AFATGJATË

Standardi I.1	
Programi i studimit i ciklit të tretë Specializim afatgjatë në fushën e mjekësisë ofrohet nga institucione të arsimit të lartë që përmbushin kriteret ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Programi i specializimit afatgjatë ofrohet nga institucione me statusin universitet, i akredituar në Republikën e Shqipërisë.	Programi i studimit Specializues Afatgjatë në “Sëmundje të Aparatit Kardiovaskular” ofrohet nga Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” (UNIZKM), institucion jopublik i arsimit të lartë, hapur me VKM nr. 567, datë 27.08.2004 dhe riorganizuar me VKM Nr. 670, datë 28.09.2011. UNIZKM është akredituar si IAL me Urdhër Nr. 375, datë 18.10.2007, Urdhër Nr. 136, datë 25.03.2016 dhe Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 112, datë 15.12.2017, me kohëzgjatje 6 vite dhe afat përfundimtar të vlefshmërisë së akreditimit deri më 14.12.2023. <i>Evidenca nr. 1, 2, 3, 7, 8.</i>
Kriteri 2: Programi i specializimit afatgjatë që ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, brenda ose jashtë vendit të jenë të akredituara në vendin e origjinës.	Programi i studimit Specializues Afatgjatë në “Sëmundje të Aparatit Kardiovaskular” është hapur me Urdhër Nr. 664, datë 28.12.2017, me 240 kredite, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 4 vite akademike, në përfundim të të cilit lëshohet Diplomë Specializimi në “Sëmundje të Aparatit Kardiovaskular”. Ky program studimi ofrohet nga Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, në bashkëpunim me Universitetin “Tor Vergata”, Romë, Itali. Diploma e lëshuar në përfundim të programit të studimit, që i referohet nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, lëshohet vetëm nga Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”. Institucioni bashkëpunues është akredituar në vendin e tij të origjinës nga Agjencia Kombëtare e Vlerësimit të Sistemit të Universitetit dhe Kërkimit (ANVUR). <i>Evidenca nr. 4, 9.</i>
Kriteri 3: Programi i specializimit afatgjatë hartohet nga njësitë bazë përgjegjëse/shërbimet përgjegjëse të institucionit nëpërmjet	Bazuar në aktet e brendshme rregulatore të UNIZKM (Statut/Rregullore e Fakultetit të Mjekësisë) është hartuar programi i studimit Specializues Afatgjatë në “Sëmundje të Aparatit





<p>procedurave të brendshme transparente dhe miratohet në përputhje me statutin, rregulloren dhe aktet e tjera organizative të institucionit.</p>	<p>Kardiovaskular”, nga Departamenti i Shkencave Mjekësore, Fakulteti i Mjekësisë.</p> <p>Më datë 17.05.2017, bazuar në marrëveshjen kuadër për bashkëpunim në zhvillimin e veprimtarive formuese në fushën e mjekësisë dhe shëndetësisë të UNIZKM nënshkruar nga UNIZKM dhe Universiteti “Tor Vergata” në datat 7 dhe 23 Korrik 2014, propozimin e Dekanit të Fakultetit miratuar me Vendim Senati datë 25.10.2015, vendimin e nënshkruar ndërmjet Ministrisë Shqiptare të Shëndetësisë dhe UNIZKM më 02.06.2016 me nr.prot. 3082, rezolutën e miratuar nga Komiteti i Përbashkët Teknik më 27.04.2017, marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara me Strukturat Shëndetësore publike dhe private, është nënshkruar ndërmjet UNIZKM dhe Universitetit të Romës “Tor Vergata” protokollin ekzekutiv për hapjen dhe funksionimin e programeve të ciklit I, II dhe III të në UNIZKM, përmes së cilës, Universiteti “Tor Vergata” merr përsipër, ndër të tjerash, të mbështesë përfundimin e programeve të specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë, ku përfshihet edhe programi “Sëmundje të Aparatit Kardiovaskular”, në bashkëpunim me pedagogët e tij të angazhuar edhe në programe të tjera studimi.</p> <p><i>Evidenca nr. 15, 17, 30.</i></p>
<p>Kriteri 4: Programi i specializimit afatgjatë përfshin formim teorik e praktik në fushën e specialitetit, i cili realizohet njëkohësisht në një universitet të akredituar, dhe në një institucion spitalor ose në një institucion shëndetësor të akredituar nga institucioni shtetëror përgjegjës për akreditimin e institucioneve shëndetësore. Institucionet i arsimit të lartë duhet të kenë zhvilluar dhe akredituar/riakredituar programet e integruara të ciklit të dytë në fushën e mjekësisë në momentin e ofrimit të një programi të ciklit të tretë.</p>	<p>Programi i studimit Specializues Afatgjatë në “Sëmundje të Aparatit Kardiovaskular” parashikon formim teorik dhe praktik, i cili realizohet nga UNIZKM, institucion jopublik i akredituar me VBA Nr. 112, datë 15.12.2017, si dhe në struktura spitalore apo institucione shëndetësore të akredituara.</p> <p>UNIZKM ka nënshkruar marrëveshje me disa institucione publike dhe private për këtë program studimi në Shqipëri, si: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, Spitali Rajonal i Durrësit, Spitali Amerikan, Spitali Gjerman, si dhe disa struktura spitalore në Itali, si: Eurosanita Spa Policlinico Casiliano, Qendra Shëndetësore Cn2 Alba-Bra, Il Gran Ospedale Metropolitan Bianchi Melacrino Morelli, Qendra Bonino Neurolesi Pulejo, Sanigest Spa. Këto struktura marrin përsipër të vënë në dispozicion infrastrukturën konform standardeve shtetërore të cilësisë për specializimet në fushën e mjekësisë dhe akteve të tjera nënligjore, si dhe personelin mjekësor me kualifikimet e nevojshme për realizimin e tutorazhit klinik.</p>
<p>Kriteri 5: Programi i specializimit afatgjatë kryhet me kohë të plotë dhe përfshin pjesëmarrjen në veprimtaritë mjekësore të</p>	






<p>departamenteve/shërbimeve ku ofrohet formimi, në përputhje me procedurat e përcaktuara dhe nën mbikëqyrjen e autoritetit apo entit përgjegjës.</p>	<p>UNIZKM ofron dhe ka të akredituara programe të integruara të studimit të ciklit të dytë. Programi i studimit zhvillohet në përputhje me programin përkatës të specializimit, procedura të paracaktuara dhe nën mbikëqyrjen e personave përgjegjës, Drejtori i programit të studimit, Udhëheqësit akademikë dhe Udhëheqësit klinikë (tutorët).</p> <p><i>Evidenca nr. 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 22, 23, 25, 28, 38, 39.</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Specializues Afatgjatë në "Sëmundje të Aparatit Kardiovaskular" ofrohet nga Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" (UNIZKM), institucion jopublik i arsimit të lartë, i licensuar dhe akredituar në Republikën e Shqipërisë, sipas procedurave dhe standardeve të legjislacionit në fuqi, nga strukturat shtetërore përgjegjëse.</i></p> <p><i>Programi ofrohet në bashkëpunim me Universitetin e Romës "Tor Vergata", i akredituar në vendin e tij të origjinës nga Agjencia Kombëtare e Vlerësimit të Sistemit të Universitetit dhe Kërkimit (ANVUR).</i></p> <p><i>Programi i studimit parashikon formim teorik dhe praktik, i cili realizohet nga UNIZKM, si dhe në struktura spitalore apo institucione shëndetësore të akredituara me të cilat ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.</i></p> <p><i>Programi i studimit zhvillohet në përputhje me programin përkatës të specializimit, procedura të paracaktuara dhe nën mbikëqyrjen e personave përgjegjës, Drejtori i programit të studimit, Udhëheqësit akademikë dhe Udhëheqësit klinikë (tutorët).</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>



<p>Standardi I.2 Programi i studimit specializues afatgjatë në mjekësi ofrohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1: Programi i studimit specializim afatgjatë hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të strategjisë së zhvillimit të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Specializues Afatgjatë në "Sëmundje të Aparatit Kardiovaskular" është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe zbatim të Statutit të UNIZKM, ku në nenin 9 të tij parashikohet se UNIZKM, në përputhje me rregullat e sistemit ligjor shqiptar, çon përpara misionin e tij dhe kryen çdo veprimtari institucionale brenda sistemit universitar kombëtar dhe rajonal, duke</p>

	<p>bashkëpunuar me Institucionet e tjera të arsimit të lartë dhe duke menaxhuar, tërësisht në mënyrë të pavarur, marrëdhëniet që lidhen me këtë bashkëpunim. Për realizimin e programeve didaktike, trajnuese dhe kërkimore-shkencore, UNIZKM shfrytëzon strukturat e Fondacionit ZKM dhe ato të vëna në dispozicion nga institucione të tjera me të cilat ka marrëveshje.</p> <p>Ky program studimi është në përputhje me misionin, parimet dhe vlerat e tij dhe strategjinë për ndërkombëtarizimin e programit të studimit në bashkëpunim me palë të treta, edhe jashtë vendit.</p> <p><i>Evidenca nr. 15, 16, 17.</i></p>						
<p>Kriteri 2: Programi i specializimit afatgjatë ka të përcaktuara qartë emërtimin, organizimin, strukturën, përmbajtjen, qëllimin dhe objektivat e tij, të harmonizuara me ato të institucionit/institucioneve ofrues, në përputhje dhe me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve</p>	<p>Sipas Urdhër të hapjes së këtij programi studimi Nr. 664, datë 28.12.2017, emërtimi i programit specializues afatgjatë është “Sëmundje të Aparatit Kardiovaskular” dhe është i organizuar në 4 vite akademike, me 240 ECTS, në formën e studimit me kohë të plotë dhe i përket nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi i studimit ka të përcaktuara qartë emërtimin, organizimin, strukturën, përmbajtjen, qëllimin dhe objektivat e tij. Ky program studimi ka për qëllim formimin e specialistit të aftë për të operuar sipas mjekësisë së bazuar në vërtetim, i cili ka fituar mjetet e aftësive intelektuale dhe profesionale për edukimin e vazhdueshëm, aftësitë e përgjithshme të specialistit të sëmundjeve kardiovaskulare, përmes një qasjeje kritike ndaj njohurive dhe përvetësimit eksperimental në terren përmes aftësive kërkimore, kuptimit të të dhënave dhe fenomeneve, rishikimit kritik të njohurive dhe ripropozimit të tyre në kontekstin real.</p> <p><i>Evidenca nr. 3, 4, 18, 22, 25.</i></p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Specializues Afatgjatë në “Sëmundje të aparatit kardiovaskular” është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe zbatim të Statutit të UNIZKM dhe është në përputhje me misionin, parimet dhe vlerat e tij dhe strategjinë për ndërkombëtarizimin e programit të studimit në bashkëpunim me palë të treta, edhe jashtë vendit.</i></p> <p><i>Programi i studimit ka të përcaktuara qartë emërtimin, organizimin, strukturën, përmbajtjen, qëllimin dhe objektivat e tij.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="571 1568 762 1637"></th> <th data-bbox="762 1568 965 1637">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="965 1568 1169 1637">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="571 1637 762 1680"></td> <td data-bbox="762 1637 965 1680"></td> <td data-bbox="965 1637 1169 1680" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi I.3	
Programi i studimit specializim afatgjatë synon të plotësojë nevojat aktuale që ka vendi për specialistë në fushën e mjekësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1: Programet e studimeve specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë synojnë të plotësojnë kërkesat e tregut të punës në përputhje me nevojat për specialistë në fushën e mjekësisë.</p>	<p>Propozimi për hapjen e programit të specializimit “Sëmundje të Aparatit Kardiovaskular” lind nga nevoja për përgatitjen e specialistëve për t’ju përgjigjur nevojave specifike të pacientëve për trajtimin e tyre. Sipas studimit të tregut të punës të realizuar nga UNIZKM, konsiderohet se Shqipëria është në mungesë të specialistëve në këtë fushë. Sipas të dhënave të Urdhërit të Mjekëve, janë 72 mjekë të specializuar për sëmundjet e aparatit kardiovaskular, duke patur kështu raportin 2.5 kardiologë për 100 mijë banorë. Duke patur në konsideratë edhe të dhënat e INSTAT-it, sipas të cilave 52.2% e vdekjeve shkaktohen nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut, rritjen e numrit të pacientëve që vuajnë nga insuficienca kardiake, shkallës së infarkteve, të shtuar edhe nga pandemia e dy viteve të fundit, hapja e këtij programi studimi specializues afatgjatë dhe formimi i specialistëve në këtë fushë të mjekësisë, i përgjigjet kërkesave dhe nevojave të tregut.</p> <p><i>Evidenca nr. 18, 19, 20.</i></p>
<p>Kriteri 2: Numri i përgjithshëm i specializantëve dhe numri i atyre që e ndjekin këtë program studimi çdo vit përcaktohet në përputhje me politikat shtetërore të zhvillimit të fushës së shëndetësisë dhe kapacitetet pritëse të strukturave të përfshira në rrjetin formues (në varësi të numrit të personelit, kapaciteteve pritëse, etj).</p>	<p>Sipas rregullores së programit të studimit, kuotat e pranimit në programet e specializimit afatgjatë në mjekësi dhe tarifat përkatëse, kushtet dhe procedurat specifike për pjesëmarrje përcaktohen çdo vit me Vendim të Senatit Akademik, me propozimin e Fakultetit të Mjekësisë dhe në lidhje me strukturat në dispozicion dhe në përputhje me politikat e zhvillimit shëndetësor të vendit.</p> <p>Sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 106, datë 10.11.2017 “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë, program studimi specializues afatgjatë në “Sëmundje të Aparatit Kardiovaskular”, në bazë të të cilit është lëshuar urdhëri i hapjes së këtij programi studimi Nr. 664, datë 28.12.2017, numri i studentëve të parashikuar në këtë program studimi ka qenë 4 studentë. Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga UNIZKM, në këtë program studimi janë pranuar e regjistruar 8 studentë.</p> <p>Nga ana tjetër, shteti dhe Ministria përgjegjëse e Shëndetësisë përcakton çdo vit kuotat për programet e specializimit, sipas politikave për zhvillimin e sektorit shëndetësor dhe kapaciteteve pritëse të strukturave të përfshira në rrjetin formues.</p>

	<i>Evidenca nr. 3, 4, 12, 21; Evidenca shitesë gjatë vizitës nr. 3.</i>		
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit specializim afatgjatë synon të plotësojë nevojat aktuale që ka vendi për mjekë specialistë të sëmundjeve të aparatit kardiovaskular.</i></p> <p><i>Sipas rregullores së programit të studimit, kuotat e pranimit në programet e specializimit afatgjatë në mjekësi dhe tarifat përkatëse, kushtet dhe procedurat specifike për pjesëmarrje përcaktohen çdo vit me Vendim të Senatit Akademik, me propozimin e Fakultetit të Mjekësisë dhe në lidhje me strukturat në dispozicion dhe në përputhje me politikat e zhvillimit shëndetësor të vendit.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X



Standardi I.4

Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1: Programi i specializimit afatgjatë përfshin formim teorik e praktik në fushën e specialitetit, i cili realizohet njëkohësisht në një universitet të akredituar dhe në një institucion spitalor ose në një institucion shëndetësor të miratuar dhe akredituar për këtë qëllim nga Ministria përgjegjëse për shëndetësinë.</p>	<p>Programi i studimit Specializues Afatgjatë në “Sëmundje të Aparatit Kardiovaskular” parashikon formim të karakterit teorik dhe praktik, i cili realizohet në strukturat universitare të UNIZKM, institucion jopublik i akredituar me VBA Nr. 112, datë 15.12.2017, në strukturat klinike-spitalore publike dhe private për të cilat janë bërë marrëveshje specifike për këtë qëllim, si dhe në struktura të tjera të akredituara dhe aprovuara për këtë qëllim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, konform standardeve shtetërore të cilësisë për specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë.</p> <p>UNIZKM ka nënshkruar marrëveshje me disa institucione publike dhe private për këtë program studimi në Shqipëri, si: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, Spitali Rajonal i Durrësit, Spitali Amerikan, Spitali Gjerman, si dhe disa struktura spitalore në Itali, si: Eurosanita Spa Policlinico Casiliano, Qendra Shëndetësore Cn2 Alba-Bra, Il Gran Ospedale Metropolitan Bianchi Melacrino Morelli, Qendra Bonino Neurolesi Pulejo, Sanigest Spa.</p> <p><i>Evidenca nr. 8, 12, 13, 14, 15, 17, 22, 23, 25, 26.</i></p>
<p>Kriteri 2: Programi i specializimit afatgjatë kryhet me kohë të plotë dhe përfshin</p>	<p>Programi i studimit realizohet në 4 vite akademike, 240 ECTS dhe me kohë të plotë. Specializanti, gjatë periudhës së specializimit, duhet të përftojë njohuri teorike dhe praktike të mjaftueshme për</p>

<p>pjesëmarrjen në veprimtaritë akademike, klinike/diagnostikuese të departamenteve dhe/ose shërbimeve ku ofrohet formimi, në përputhje me rregulloren e programeve të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë.</p>	<p>ushtrimin e funksioneve të tij si mjek i specializuar, në mënyrë të pavarur në përfundim të specilizimit afatgjatë, në fushën e trajtimit, dijonistikimit dhe parandalimit të patologjive.</p> <p>Sipas Rregullores së programit të studimit, neni 7, përcaktohet që struktura e programit të studimit përmban të paktën 80% të ECTS-së totale aktivitete klinike profesionalizuese dhe 20% studime të organizuara teorike të shpërndara në vite. Raporti i lëndëve të përcaktuara në programin e studimit përbëhet nga 60% lëndë specifike të programit të specializimit, 30% lëndë karakterizuese të fushës ku bën pjesë programi specializues, 5% lëndë të formimit bazë, lëndë ndërdisiplinore ose plotësuese dhe 5% provimi përfundimtar. Ndërkohë 15% e totalit të lëndëve specifike dhe 15% e totalit të lëndëve karakterizuese duhet të jenë lëndë me zgjedhje. Për realizimin e sa më sipër specializanti ushtrohet në mënyrë të pavarur, por nën mbikëqyrjen e pedagogëve, mjekëve specialistë, udhëheqësve klinikë dhe tutorëve, të cilët ndjekin specializantin gjatë punës.</p> <p><i>Evidenca nr. 12, 25.</i></p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit parashikon formim të karakterit teorik dhe praktik, i cili realizohet në strukturat universitare të UNIZKM, në strukturat klinike-spitalore publike dhe private për të cilat janë bërë marrëveshje specifike për këtë qëllim, si dhe në struktura të tjera të akredituara dhe aprovuara për këtë qëllim, konform standardeve shtetërore të cilësisë për specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë.</i></p> <p><i>Programi i studimit realizohet me kohë të plotë dhe përfshin pjesëmarrjen në veprimtari akademike, klinike/diagnostikuese të departamenteve dhe shërbimeve ku ofrohet formimi.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="571 1332 762 1400">P</th> <th data-bbox="762 1332 954 1400">P</th> <th data-bbox="954 1332 1161 1400">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1161 1332 1386 1400">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="571 1400 762 1440"></td> <td data-bbox="762 1400 954 1440"></td> <td data-bbox="954 1400 1161 1440"></td> <td data-bbox="1161 1400 1386 1440">X</td> </tr> </tbody> </table>	P	P	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
P	P	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						



<p>Standardi I.5 Programi i studimit i ciklit të tretë specializim afatgjatë në fushën e mjekësisë synon të plotësojë nevojat që ka vendi për specialistë në fushën e mjekësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1: Për hartimin e programit të specializimit afatgjatë, njësia bazë përgjegjëse/shërbimi përgjegjës, kryen studime dhe</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Karrierës në UNIZKM ka realizuar një studim të tregut të punës për sëmundjet e sistemit kardiovaskular, i cili synon të përshkruajë ciklet dhe dinamikën e sektorit mjekësor për</p>

<p>analiza mbi situatën, zhvillimet, nevojat, prioritetet në fushën e përgjithshme dhe specifike të programit dhe/ose të politikave shtetërore të zhvillimit të fushës së shëndetësisë, të cilat bëhen pjesë e projekt propozimit përpara hapjes së programit.</p>	<p>të kuptuar temat strategjike që drejtojnë evolucionin e profesionit të mjekut. Sikurse përmendur edhe në standardin I.3 më lart, sipas studimit të tregut të punës konsiderohet se Shqipëria është në mungesë të specialistëve në këtë fushë. Sipas të dhënave të Urdhërit të Mjekëve, janë 72 mjekë të specializuar për sëmundjet e aparatit kardiovaskular, duke patur kështu raportin 2.5 kardiologë për 100 mijë banorë, e ku pjesa më e madhe e mjekëve kardiologë janë të përqëndruar në Tiranë. Duke patur në konsideratë edhe të dhënat e INSTAT-it, sipas të cilave 52.2% e vdekjeve shkaktohen nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut, rritjen e numrit të pacientëve që vuajnë nga insuficienca kardiake, shkallës së infarkteve, të shtuar edhe nga pandemia e dy viteve të fundit, hapja e këtij programi studimi specializues afatgjatë dhe formimi i specialistëve në këtë fushë të mjekësisë, i përgjigjet kërkesave dhe nevojave të vendit.</p> <p>Gjithashtu, edhe shteti shqiptar ka përfshirë ndër prioritetet e tij edhe përmirësimin e sektorit të shëndetësisë, rritjen e numrit të mjekëve specialist dhe ribërjen e hartës gjeografike të nevojës për mjekë specialistë sipas rajoneve.</p> <p><i>Evidenca nr. 18, 19, 20.</i></p>
<p>Kriteri 2: Programi i specializimit afatgjatë ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e specialistëve në fushën e mjekësisë me njohuri të thelluara kërkimore, si dhe aftësi dhe kompetenca klinike/diagnostikuese në fushat përkatëse të mjekësisë, në përputhje me kërkesat dhe nevojat që ka vendi.</p>	<p>Programi i specializimit ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e specialistëve në fushën e sëmundjeve të aparatit kardiovaskular, në përputhje me kërkesat dhe nevojat që ka vendi. Programi synon të formojë dhe të specializojë studentë të cilët në përfundim të këtij programi specializues, të ofrojë një shërbim cilësor shëndetësor të specializuar dhe bashkëkohor për pacientin, trajtimin dhe parandalimin e patologjive të ndryshme, duke ndjekur rregullat e etikës dhe sjelljes në fushën përkatëse, si edhe përmes kërkimit shkencor, për të mundur ngritjen e një sistemi shëndetësor konform standardeve më të mira europiane.</p>
<p>Kriteri 3: Programi i specializimit afatgjatë hartohet dhe harmonizohet me programe të ngjashme të ofruar nga institucione partnere vendase apo të huaja, udhëzues, direktiva të BE, të institucioneve dhe organizmave ndërkombëtare me të cilat është partner apo bashkëpunon vendi ynë.</p>	<p>Për përmbushjen e objektivave të programit dhe trajnimin e specialistëve, UNIZKM mbështetet edhe në marrëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar me Universitetin e Romës "Tor Vergata", përmes së cilës mundësohet bashkëpunimi për zhvillimin e aktiviteteve trajnuese në fushën mjekësore dhe shëndetësore, harmonizimi i programit specializues me ofertën e trajnimit të propozuar nga universiteti bashkëpunues, përshtatja me udhëzimet dhe direktivat e BE-së dhe rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar,</p>
<p>Kriteri 4: Me qëllim rritjen e bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar, mobilitetit dhe</p>	

<p>përfshirjen në veprimtaritë akademike të programit edhe të specialistëve/profesionistë të huaj, programi mund të aplikohet pjesërisht ose i plotë edhe në një nga gjuhët e BE-së.</p>	<p>duke nxitur kështu edhe mobilitetin dhe përfshirjen e specialistëve të huaj në aktivitete akademike.</p> <p>Programi i studimit ofrohet në gjuhën italiane, duke lehtësuar kështu edhe transferimin e specialistëve për pjesëmarrje në veprimtaritë akademike apo spitalore drejt dy shteteve: Italisë dhe Shqipërisë.</p> <p><i>Evidenca nr. 11, 12, 25, 26, 29; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 5: Programet e studimeve specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë synojnë të plotësojnë kërkesat e tregut të punës në përputhje me nevojat për specialistë në fushën e mjekësisë.</p>	<p>Me rritjen e morbiditetit dhe mortalitetit nga sëmundjet kardiovaskulare dhe me rritjen e jetëgjatësisë së popullatës dhe nga ana tjetër, emigrimi i mjekëve kryesisht drejt Gjermanisë, ka nxjerrë në pah nevojën e rritur për specialistë kardiologë në vendin tonë.</p> <p><i>Evidenca nr. 12, 18, 25.</i></p>
<p>Kriteri 6: Numri i përgjithshëm i specialistëve dhe numri i atyre që e ndjekin këtë program studimi çdo vit përcaktohet në përputhje me politikat shtetërore të zhvillimit të fushës së shëndetësisë dhe kapacitetet pritëse të Institucioneve të arsimit të lartë dhe strukturave shëndetësore të përfshira në rrjetin formues (në varësi kapaciteteve pritëse akademike/profesionale dhe infrastrukturore).</p>	<p>Sipas rregullores së programit të studimit, kuotat e pranimit në programet e specializimit afatgjatë në mjeksëi dhe tarifat përkatëse, kushtet dhe procedurat specifike për pjesëmarrje përcaktohen çdo vit me Vendim të Senatit Akademik, me propozimin e Fakultetit të Mjekësisë dhe në lidhje me strukturat në dispozicion dhe në përputhje me politikat e zhvillimit shëndetësor të vendit.</p> <p>Sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 106, datë 10.11.2017 “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë, program studimi specializues afatgjatë në “Sëmundje të Aparatit Kardiovaskular”, në bazë të të cilit është lëshuar urdhëri i hapjes së këtij programi studimi Nr. 664, datë 28.12.2017, numri i studentëve të parashikuar në këtë program studimi ka qenë 4 studentë. Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga UNIZKM, në këtë program studimi në vitin e pare të hapjes së tij janë pranuar e regjistruar 8 studentë, prej të cilëve 2 janë çregjistruar.</p> <p>Gjithashtu, shteti dhe Ministria përgjegjëse e Shëndetësisë përcakton çdo vit kuotat për programet e specializimit, sipas politikave për zhvillimin e sektorit shëndetësor dhe kapaciteteve pritëse të strukturave të përfshira në rrjetin formues.</p> <p><i>Evidenca nr. 3, 4, 12, 21, 25; Evidenca shtesë gjatë vizitës nr. 3.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UNIZKM ka realizuar një studim të tregut të punës për sëmundjet e sistemit kardiovaskular, i cili synon të përshkruajë ciklet dhe dinamikën e sektorit mjekësor për të kuptuar temat strategjike që drejtojnë evolucionin e profesionit të mjekut. Sipas studimit të tregut të punës konsiderohet se Shqipëria është në mungesë të</i></p>






	<p><i>specialistëve në fushën e sëmundjeve të aparatit kardiovaskular, ndaj ky programi studimi dëshmon se plotëson këto nevoja. Kjo është në përputhje edhe me prioritetin e shtetit shqiptar për përmirësimin e sektorit të shëndetësisë, rritjen e numrit të mjekëve specialistë dhe ribërjen e hartës gjeografike të nevojës për mjekë specialistë sipas rajoneve.</i></p> <p><i>Programi i specializimit ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e specialistëve në fushën e sëmundjeve të aparatit kardiovaskular, në përputhje me kërkesat dhe nevojat që ka vendi. Kuotat e pranimit në programet e specializimit afatgjatë në mjekësi dhe tarifat përkatëse, kushtet dhe procedurat specifike për pjesëmarrje përcaktohen çdo vit me Vendim të Senatit Akademik, me propozimin e Fakultetit të Mjekësisë dhe në lidhje me strukturat në dispozicion dhe në përputhje me politikat e zhvillimit shëndetësor të vendit.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet sërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X



Standardi I.6

Organizimi i programit të specializimit afatgjatë është në përputhje me fushën akademike dhe në bazë specialiteti.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1: Programi i specializimit afatgjatë organizohet në nivel njësie bazë ose shërbimi (pjesë përbërëse e departamentit) të cilat janë përgjegjës për mbarëvajtjen dhe ecurinë e tij.</p> <p>Kriteri 2: Njësia përgjegjëse ka profilin, përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike e mjekësore të specialitetit për ofrimin e programit të specializimit.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit është Departamenti i Shkencave Mjekësore, pjesë e Fakultetit të Mjekësisë në UNIZKM.</p> <p>Fakulteti i Mjekësisë përbëhet nga 3 departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Shkencave Biomjeksore; 2. Departamenti i Shkencave Kirurgjikale; 3. Departamenti i Shkencave Mjekësore. <p>Sipas të dhënave të paraqitura nga Institucioni në tabelën 2.1 të tabelave përmbledhëse, Departamenti i Shkencave Mjekësore, në vitin akademik 22-23 përbëhet nga 14 personel akademik efektiv, prej të cilëve 3 mbajnë titullin “Profesor”, 4 mbajnë titullin “Profesor i Asociuar” dhe 7 kanë gradën shkencore “Doktor”, dhe 3 personel akademik me kontratë, prej të cilëve 1 mban titullin “Profesor i Asociuar” dhe 2 kanë gradën shkencore “Doktor”.</p>



	<p>Gjithashtu, ky departament ka 9 udhëheqës klinik dhe 25 personel ndihmës-akademik.</p> <p>Sipas të dhënave të paraqitura nga Institucioni në tabelën 2.2 të tabelave përmbledhëse, Departamenti, në vitin akademik 21-22 përbëhej nga 15 personel akademik efektiv, prej të cilëve 3 me titullin “Profesor”, 4 me titullin “Profesor i Asociuar” dhe 8 me gradën shkencore “Doktor”, dhe 2 personel akademik me kontratë, prej të cilëve 1 me titullin “Profesor i Asociuar” dhe 1 me gradën shkencore “Doktor”. Gjithashtu, ky departament ka patur në përbërje në këtë vit akademik 9 udhëheqës klinik dhe 25 personel ndihmës-akademik.</p> <p>Programi specializues realizohet nëpërmjet një strukture organizative të përbërë nga kapacitete të përshtatshme profesionale dhe pedagogjike, ku përfshihen pedagogët, tutorët, udhëheqësit klinikë dhe ekspertë të fushës së specializimit.</p> <p>Për çdo program studimi specializues, sipas rregullores së programit, përcaktohen Drejtori i programit, Këshilli Drejtues, Përgjegjësi për menaxhimin ekonomik-financiar dhe përmbushjen e kërkesave administrative në nivel universiteti dhe një përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm.</p> <p>Drejtori i këtij programi studimi, me propozimin e Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë dhe emërim nga Rektori, është caktuar Prof. F.R.</p> <p>Në nivel njësie bazë programi i studimit disponon pedagogë të angazhuar në procesin e mësimdhënies brenda programit, si dhe pedagogë jo anëtarë të personelit akademik të universitetit/personel me eksperiencë didaktike-formuese të dokumentuar pranë strukturave të përfshira në rrjetin formues me të cilët lidhet një kontratë specifike private.</p> <p>Gjithashtu, studenti specializant ka një tutor (udhëheqës klinik), i cili e ndjek atë gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe është përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit, zhvillimin dhe monitorimin e punës së studentit.</p> <p><i>Evidenca nr. 12, 15, 17, 28; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 3: Programet e studimit mbështeten mbi objektiva të qartë profesionale dhe janë të integruar</p>	<p>UNIZKM ka të përcaktuara qartë objektiva e programit të studimit, të cilat ndahen në objektiva të formimit bazë, objektiva të formimit</p>

me veprimtaritë
klinike/diagnostikuese.

të përgjithshëm dhe objektiva arsimore specifike për tipologjinë e programit, dhe integrimin me veprimtari klinike e diagnostifikuese.

- Objektivat e formimit bazë: specializanti duhet të marrë njohuri të avancuara të anatomisë, morfologjisë dhe funksionalitetit të aparatit kardiovaskular duke përfshirë bazat funksionale dhe patologjike biologjike, molekulare dhe imunologjike, të mësojë dhe zbatojë teknikat e fiziologjisë dhe fiziopatologjisë, etj;
- Objektivat e formimit të përgjithshëm: specializanti duhet të marrë njohuri themelore të fiziopatologjisë së organeve dhe sistemeve të ndryshme, njohuritë teorike dhe praktike të nevojshme për njohjen e sëmundjeve që prekin sistemet e ndryshme të trupit, njohuritë teorike dhe praktike të sektorëve kryesorë të instrumenteve dhe laboratorëve, diagnostifikimi në lidhje me sëmundjet e sipërpërmendura, fitimi i aftësisë për të vlerësuar lidhjet dhe ndikimet e brendshme dhe specialistike. Specializanti duhet të zhvillojë aftësinë për të inkuadruar klinikisht pacientin në bazë të anamnezës dhe ekzaminimit fizik, të zhvillojë aftësi kritike diagnostifikuese dhe analitike, të njihet me procedurat kryesore diagnostifikuese dhe hetimet laboratorike-instrumentale, të dijë nën aspektin klinik dhe terapeutik patologjitë më të shpeshta të kompetencës së tipologjive të klasës dhe mjekësisë së brendshme, të fitojë njohuri për një ekspertizë të specializuar në vlerësimin e pacientëve me dhimbje akute në gjoks, diagnostifikimin dhe trajtimin e infarktut akut të miokardit, trajtimin e arrestit kardial, rianimit kardio-respirator, etj;
- Objektivat arsimore specifike për tipologjinë e programit: përvetësimi i njohurive bazë të fiziologjisë anatomike, biokimisë dhe gjenetikës së sistemit kardial për të krijuar bazën për mësimin e terapisë laboratorike, klinike dhe kardiace; përvetësimi i nocioneve bazë të matematikës, fizikës, statistikës dhe teknologjisë së informacionit, për të kuptuar fiziologjinë e qarkullimit dhe për përpunimin e të dhënave dhe imazheve me interes klinik; përvetësimi i njohurive të avancuara mbi mekanizmat etipatogjenike dhe fiziopatologjike që përcaktojnë zhvillimin e sëmundjeve të lindura dhe të fituara të zemrës, si dhe njohuritë kryesore të





diagnozës semiotike, klinike, instrumentale dhe laboratorike të zbatueshme jo vetëm për sëmundjet kardiovaskulare; përvetësimi i njohurive bazë teorike dhe teknike në të gjithë sektorët diagnostikues të kardiologjisë joinvazive dhe invazive tek të rriturit dhe moshë pediatrike, etj.

Specializanti duhet të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme klinike të lidhura ngushtë me fushën specifike në të cilën ndjek studimet, të cilat e ndihmojnë të aftësohet për:



- Përvetësimin e metodologjive dhe njohurive klinike e kërkimore për veprimtari krijuese të pavarura si: artikuj shkencorë, prezantime rastesh klinike, etj;
- Punën e pavarur në laborator/klinikë/sallë operatore;
- Përdorimin e burimeve bashkëkohore të informacionit dhe administrimin e informacionit;
- Përdorimin e teknologjive bashkëkohore për prezantime shkencore;
- Përvetësimin e metodave të avancuara të analizës dhe përpunimit të të dhënave;
- Njohjen dhe përvetësimin e terminologjisë së specializuar lidhur me fushën klinike të specializimit.

Disa prej aktiviteteve profesionale të detyrueshme për arritjen e objektivave të trajnimit janë:

- të ketë asistuar personalisht raste të patologjisë kardiovaskulare, disa prej të cilave në kujdesin intensiv kardiak, pjesëmarrja aktive në mbledhjen e të dhënave anamnestike, kryerja e një ekzaminimi objektiv, propozimi i programimit të diagnostikimit dhe ndërhyrjet terapeutike, etj;
- të ketë paraqitur qartë dhe me kompetencë raste klinikisht paradigmatiche të patologjive kardiovaskulare në takimet formale të programit;
- të ketë kryer personalisht dhe në çdo rast të raportuar elektrokardiogramë standard dhe EKG dinamike;
- të ketë kryer personalisht të paktën tesa provokuese dhe/ose farmakologjike;
- të ketë kryer personalisht ekokardiogramë njëdimensionale, dydimensionale dhe Doppler me 900 raporte;



	<p>- të ketë demonstruar aftësinë për të njohur dhe interpretuar saktë radiogramet, shintigrafitë, CT dhe MRI në lidhje me patologjinë kardiovaskulare – 400;</p> <p>- të kenë marrë pjesë në kryerjen e kateterizimeve të djathta, me llogaritjen e paramentrave relativ hemodinamikë dhe koronarografisë;</p> <p>- të kenë fituar njohurit teorike dhe eksperiencë klinike në menaxhimin e pacientit akut dhe në reanimacionin kardiorespirator në periudhë të përshtatshme në Njësinë e Terapisë Intensive Koronare.</p> <p><i>Evidenca nr. 12, 25; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 4: Fusha specifike e programit të specializimit afatgjatë është në përputhje me fushën akademike të specialitetit të njësisë përgjegjëse (departament/shërbim) për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit në përputhje me direktivat dhe udhëzimet kombëtare e europiane.</p>	<p>Fusha specifike e programit të specializimit afatgjatë përputhet me fushën e specialitetit akademik të Fakultetit të Mjekësisë, përgjegjëse për programin e specializimit, sipas klasifikimit të programit të studimit në përputhje me direktivat kombëtare dhe evropiane dhe udhëzime.</p> <p><i>Evidenca nr. 15; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 5: Në rastet kur programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera, fusha e specifike e programit të specializimit është në përputhje me fushën akademike e të specialitetit të njësisë/ve përgjegjëse në institucionet respektive.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet nga UNIZKM në bashkëpunim me Universitetin e Romës “Tor Vergata”. Fusha specifike e programit është në përputhje me fushën akademike dhe të specialitetit të Fakultetit të Mjekësisë, si një nga njësitë e Universitetit “Tor Vergata”, i cili është universiteti partner.</p> <p><i>Evidenca nr. 26.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Organizimi i programit të specializimit afatgjatë është në përputhje me fushën akademike dhe në bazë specialiteti.</i></p> <p><i>Njësia përgjegjëse ka profilin, përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike e mjekësore të specialitetit për ofrimin e programit të specializimit.</i></p> <p><i>UNIZKM ka të përcaktuara qartë objektivat e programit të studimit, të cilat ndahen në objektiva të formimit bazë, objektiva të formimit të përgjithshëm dhe objektiva arsimore specifike për tipologjinë e programit, dhe integrimin me veprimtari klinike e diagnostifikuese.</i></p> <p><i>Fusha specifike e programit është në përputhje me fushën akademike dhe të specialitetit të Fakultetit të Mjekësisë, si një nga</i></p>






	njësitë e Universitetit "Tor Vergata", i cili është universiteti partner.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

II. ORGANIZIMI, STRUKTURA DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT

Standardi II.1	
Organizimi i programit bazohet në rregullore dhe udhëzues të posaçëm të programit të specializimit afatgjatë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Njësia kryesore përgjegjëse për organizimin, zhvillimin e programeve të specializimeve, përcakton në mënyrë të detajuar rregullat e organizimit e të funksionimit të programeve të specializimeve dhe i përditëson ato në funksion të përmirësimit të cilësisë.	Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit është Fakulteti i Mjekësisë. Ky fakultet përbëhet nga 3 departamente: Departamenti i Shkencave Biomjekësore, Departamenti i Shkencave Kirurgjike dhe Departamenti i Shkencave Mjekësore, i cili është dhe departamenti përgjegjës për këtë program studimi. UNIZKM ka miratuar Rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjatë, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, që prej hapjes së programit të studimit në 2017, e më pas, më Vendim të Senatit Akademik nr. 239/2, datë 13.06.2019 ka miratuar Rregulloren e përditësuar të specializimeve. <i>Nevojitet që kjo rregullore të përditësohet në përputhje me VKM Nr. 824, datë 24.12.2021 për miratimin e Kodit të Cilësisë.</i>
Kriteri 2: Elementët e organizimit të programit, përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet, përcaktohen në rregulloren e specializimeve afatgjatë dhe në akte të tjera të miratuara nga institucioni.	
Kriteri 3: Institucioni harton dhe miraton udhëzues, modele për raportimin, vlerësimin dhe arritjet e specializantëve gjatë gjithë vitit akademik dhe të studimeve.	Në këtë rregullore, por dhe në dokumenta të tjera si psh. programi i specializimit në Sëmundjet e Aparatit Kardiovaskular, janë të përcaktuara mënyra e organizimit dhe funksionimit të programit të studimit, struktura dhe elementët e programit të studimit, kapacitetet profesionale dhe pedagogjike, të drejtat dhe detyrimet e studentëve, arritjet e specializantëve dhe vlerësimi i tyre, kriteret dhe procedura e pranimit të studentëve, menaxhimi i përmirësimit të cilësisë dhe performancës së programit të studimit, etj.

Sipas rregullores së programit, specialisti që në fillim të programit të studimit pajiset me Librezën e Studentit, ku duhet të shënohen të gjitha notat dhe vlerësimet vjetore të tij. Për të gjitha aktivitetet e parashikuara në programin e studimit të cilat përmbajnë vlerësim apo kërkohet të certifikohet frekuentimi, studenti paraqitet me librezë, e cila në përfundim të aktivitetit përkatës plotësohet nga pedagogu që ka qenë përgjegjës për zhvillimin e këtij aktiviteti.


Sipas dokumentit të prezantimit të programit të studimit, specialistët janë të detyruar të hartojnë një ditar të posaçëm trajnimi personal, ku duhet të raportojnë me detaje numrin dhe llojin e akteve dhe ndërhyrjeve, të cilat duhet të vërtetohen nga drejtuesi i institucionit ku ka kryer trajnimin. Në fund të çdo viti të programit, drejtori i programit verifikon që dokumenti është plotësuar dhe se aktivitetet e kryera janë në përputhje me ato të parashikuara në planin individual të trajnimit të përcaktuar në fillim të vitit akademik. Programi ka një sistem vlerësimi, në të cilin në mënyrë periodike dhe të dokumentuar, specialisti vlerësohet mbi njohuritë dhe aftësitë e fituara dhe nivelet e autonomisë së arritur. Vlerësimi kryhet nga pedagogët dhe udhëheqësit që kanë mbikëqyrur periudhën kohore të konsideruar, duke përdorur mjete vlerësimi të përbashkëta, të vlefshme dhe të riprodhueshme. Të gjitha vlerësimet që kanë të bëjnë me secilin specialist diskutohen dhe përmbledhen në një vendim përfundimtar vjetor, i cili ratifikohet nga organet kompetente, të cilat në tërësi garantojnë procesin e vlerësimit dhe mbi bazën e tij, caktimin e niveleve të specialistëve. Në bazë të këtij vlerësimi, në rast të një gjykimi pozitiv, specialistëve i lejohej të përparojnë në vitin pasardhës ose të pranohen në provimin përfundimtar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga UNIZKM, konstatohet se në modelin e vlerësimit nga tutori klinik, nuk ka një shprehje me njësi matëse të punës së kryer në strukturën spitalore përkatëse. Për sa më lart, GVJ rekomandon që aktivitetet e realizura në raportin e tutorit të prezantohen me numrin e realizuar ose të asistimeve respektivisht pjesëmarrjes në aktivitetin e kërkuar.



Evidenca nr. 12, 25, 31, 32, 43; Evidenca shitesë gjatë vizitës nr. 6.

Konkluzione	<p>UNIZKM ka miratuar Rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata, ku përcaktohen në mënyrë të detajuar rregullat e organizimit e të funksionimit të programit të specializimit, elementët dhe organizimi i programit, përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet, kapacitetet profesionale dhe pedagogjike, arrijtet e specialistëve dhe vlerësimi i tyre, kriteret dhe procedura e pranimit të studentëve, menaxhimi i përmirësimit të cilësisë dhe performancës së programit të studimit, etj. Rregullorja duhet të përditësohet në përputhje me VKM Nr. 824, datë 24.12.2021 për miratimin e Kodit të Cilësisë. Në modelin e vlerësimit nga tutori klinik nuk ka një shprehje me njësi matëse të punës së kryer në strukturën spitalore përkatëse. GVJ rekomandon që aktivitetet e realizura në raportin e tutorit të prezantohen me numrin e realizuar ose të asitimeve respektivisht pjesëmarrjes në aktivitetin e kërkuar.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	



Standardi II.2 Përmbajtja e programit të studimit specializim afatgjatë organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe në udhëzues të hapësirës evropiane në arsimin e lartë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1: Për kryerjen e programeve të studimeve specializuese afatgjata, studenti duhet të grumbullojë jo më pak se 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e këtyre programeve të studimeve është jo më pak se 2 vite akademike, në përputhje me ligjin e profesioneve të rregulluara, dhe përcaktimeve në shtojcën 1.</p>	<p>Programi i studimit specializues afatgjatë në “Sëmundje të Aparatit Kardiovaskular” organizohet në 4 vite akademike dhe në përfundim të tij studentët duhet të kenë siguruar 240 ECTS.</p> <p><i>Evidenca nr. 3, 4, 12, 22.</i></p>
<p>Kriteri 2: Kohëzgjatja e normale e programeve të specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë është sipas shtojcës nr 1 dhe kohëzgjatja maksimale nuk mund të jete me shume se dyfishi i kohëzgjatjes normale të specializimit afatgjatë.</p>	<p>Sipas rregullores së programit të studimit, neni 36 dhe 37, parashikohet që specializimi nuk mund të zgjasë më tepër se 1 vit nga kohëzgjatja zyrtare e tij duke zbritur kohën e sëmundjeve të mundshme të vërtetuar në mënyrë të duhur, dhe se specialisti që nuk kalon vlerësimin përfundimtar ka të drejtë t’i nënshtrohet edhe një herë tjetër këtij vlerësimi, por jo më vonë se 1 vit pas përfundimit të specializimit.</p> <p>Sipas nenit 90 të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, pika 1, sikurse parashikuar edhe në këtë kriter, kohëzgjatja maksimale e studimeve</p>



	<p>në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti ka pezulluar studimet. <i>Për sa më lart, UNIZKM duhet të përditësojë rregulloren e programit të studimit, për të qenë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 12, 22.</i></p>
<p>Kriteri 3: Përmbajtja e programit, organizimi, vlerësimi dhe monitorimi përafrohen me shembuj të ngjashëm në institucione ndërkombëtare të hapësirës evropiane të arsimit të lartë.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet në bashkëpunim me Universitetin e Romës “Tor Vergata” dhe si i tillë përmbajtja e programit është në harmoni dhe ngjashmëri me programet e studimit specializuese afatgjata të universitetit partner.</p> <p><i>Evidenca nr. 3, 4, 11, 26, 30</i></p>
<p>Kriteri 4: Programet e studimeve specializuese afatgjata përfshijnë të paktën 80% të ECTS-ve totale për aktivitete klinike/diagnostikuese e profesionalizuese, sipas specializimit përkatës, dhe 20% për studime të organizuara teorike të shpërndara në vite sipas një programi të paracaktuar në fillim të programit të studimit.</p>	<p>Sipas Rregullores së programit të studimit, neni 7, përcaktohet që struktura e programit të studimit përmban të paktën 80% të ECTS-së totale aktivitete klinike profesionalizuese dhe 20% studime të organizuara teorike të shpërndara në vite. Raporti i lëndëve të përcaktuara në programin e studimit përbëhet nga 60% lëndë specifike të programit të specializimit, 30% lëndë karakterizuese të fushës ku bën pjesë programi specializues, 5% lëndë të formimit bazë, lëndë ndërdisiplinore ose plotësuese dhe 5% provimi përfundimtar. Ndërkohë 15% e totalit të lëndëve specifike dhe 15% e totalit të lëndëve karakterizuese duhet të jenë lëndë me zgjedhje.</p> <p><i>Evidenca nr. 12, 22, 25.</i></p>
<p>Kriteri 5: Raporti i lëndëve (referuar totalit të ECTS) të përcaktuara në programin e studimit përbëhet, nga: 60% lëndë specifike; 30% lëndë karakterizuese të fushës; 5% lëndë të formimit bazë, ndërdisiplinore ose integruese dhe për aktivitete të tjera; 5% provimi përfundimtar etj. ; Jo me shume se 15% e totalit e lëndëve vjetore duhet të jenë lëndë me zgjedhje, sipas kuadrit ligjor në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 6: Në përfundim të çdo viti organizohet provimi vlerësues teorik dhe praktik i lëndës i cili vlerësohet me notë. Vlerësimi vjetor i lëndës kryhet nga një komision i përbërë nga të paktën 2 (dy) pedagoge. Nder ta, te paktën njeri prej tyre duhet te jete pedagog</p>	<p>Sipas nenit 14 të rregullores së programit të studimit, në përfundim të çdo viti akademik, organizohet një provim vlerësues teorik dhe praktik, i cili vlerësohet me notë. Vlerësimi vjetor kryhet nga një komision i përbërë nga të paktën 5 anëtarë, specialistë të fushës përkatëse ose të përfaqësues të sipas modeleve të zhvilluara. Specializantët që vlerësohen jo kalues 5 herë, marrin një dëshmi për modulet e zhvilluara, së bashku me kreditet e grumbulluara dhe</p>

<p>me kohe te plote ne fushën përkatëse ndërsa pedagogu i dyte specialist me përvojë i fushës përkatëse ose të përfaqësues të sipas moduleve të zhvilluara. Studentët që vlerësohen negativisht 5 herë marrin një dëshmi për modulet e zhvilluara, së bashku me kreditet e grumbulluara dhe i ndërpresin studimet e specializimeve afatgjata.</p>	<p>i ndërpresin studimet. Studenti mund të aplikojë për të konkuruar në një program tjetër specializues jo më shumë se 1 herë. Studentit mund t'i njihen ECTS-të e grumbulluara për studimet e organizuara teorike nga ana e Këshillit Drejtues, nëse gjykohet se përputhen me fushën e programit të ri ku ka aplikuar, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Evidenca nr. 12; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 7: Studenti i nënshtrohet provimit përfundimtar/final në përfundim të programit specializues i cili përfshin testimin praktik dhe me gojë të studentit dhe/ose paraqitjen e temës të diplomës. Komisioni për vlerësimin përfundimtar të studentit përbëhet nga 5 specialistë të fushës pedagogje me kohe te plote të IAL që ofron specializimin, ose të një fushe të afërt, me eksperiencë të paktën 10 (dhjetë) vjeçare në fushën përkatëse. Kryetar i komisionit duhet te jete një pedagog me kohë te plote i fushës përkatëse, përgjegjës për programin e specializimit afatgjate ne ketë fushe.</p> <p>Disa nga njohuritë bazë për të cilat aplikanti testohet në provimin përfundimtar, janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Zhvillimi i sensit kritik lidhur me situatat e ndryshme klinike; Lidhjet mes fushave të ndryshme të mjekësisë; Aftësi të zhvilluara për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës në klinikë; Kompetencë për të menaxhuar kompleksitetin e situatave klinike dhe për të dhënë zgjidhje në raste emergjente. 	<p>Sikurse parashikuar në nenin 15 të rregullores së programit, specialisti i nënshtrohet provimit përfundimtar në përfundim të programit, i cili konsiston në një testim praktik, një testim me gojë prej të paktën 30 minutësh dhe paraqitjen e temës eksperimentale-studimore të diplomës.</p> <p>Komisioni i ngritur për këtë qëllim përbëhet nga të paktën 5 anëtarë specialistë të fushës ose të një fushe të përfaqësues, me eksperiencë profesionale të paktën 10 vjeçare dhe akademike në fushën përkatëse, ndër të cilët 2 përfaqësues nga MSHMS, 1 nga Urdhëri profesional përkatës dhe 2 të përzgjedhur nga fakulteti që ofron programin e studimit.</p> <p>Disa prej njohurive bazë të cilat janë pjesë e testimit përfundimtar janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Zhvillimi i sensit kritik lidhur me situatat e ndryshme klinike; – Lidhjet mes fushave të ndryshme të mjekësisë; – Aftësi të zhvilluara për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës në klinikë; – Kompetencë për të menaxhuar kompleksitetin e situatave klinike dhe për të dhënë zgjidhje në raste emergjente. <p><i>Evidenca nr. 12; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 8: Në kuadër të përmirësimit të programit, njësi përgjegjëse ka të drejtën e ndryshimeve në përmbajtje të formimit teorik të programit të</p>	<p>Sipas Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit mund të realizojë ndryshime në përmbajtje të formimit teorik të programit të studimit, nëse e gjykon të nevojshme, deri në masën 20%. Këto ndryshime mund të</p>






<p>specializimit, dokumenton procedurën në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>realizohen vetëm pasi programi të ketë kaluar një proces akreditimi. Duke qenë se ky program është duke iu nënshtruar procesit të akreditimit për herë të parë, nuk janë realizuar ndryshime të tilla.</p> <p><i>Vizita në Institucion.</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit specializues afatgjatë në “Sëmundje të Aparatit Kardiovaskular” organizohet në 4 vite akademike dhe në përfundim të tij studentët duhet të kenë siguruar 240 ECTS. Sipas rregullores së programit të studimit, neni 36 dhe 37, parashikohet që specializimi nuk mund të zgjasë më tepër se 1 vit nga kohëzgjatja zyrtare e tij duke zbritur kohën e sëmundjeve të mundshme të vërtetuar në mënyrë të duhur, dhe se specializanti që nuk kalon vlerësimin përfundimtar ka të drejtë t’i nënshtrohet edhe një herë tjetër këtij vlerësimi, por jo më vonë se 1 vit pas përfundimit të specializimit. Sipas nenit 90 të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, pika 1, sikurse parashikuar edhe në këtë standard, kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti ka pezulluar studimet. Për sa më lart, UNIZKM duhet të përditësojë rregulloren e programit të studimit, për të qenë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Në përfundim të çdo viti akademik, organizohet një provim vlerësues teorik dhe praktik, i cili vlerësohet me notë. Vlerësimi vjetor kryhet nga një komision i përbërë nga të paktën 5 anëtarë, specialistë të fushës përkatëse ose të përafërt me të sipas modeleve të zhvilluara. Specializanti i nënshtrohet provimit përfundimtar në përfundim të programit, i cili konsiston në një testim praktik, një testim me gojë prej të paktën 30 minutësh dhe paraqitjen e temës eksperimentale-studimore të diplomës. Në rregullore janë të parashikuara njohuritë bazë të cilat janë pjesë e testimit përfundimtar.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>



Standardi II.3	
Pranimi i studentëve në një program studimi specializues afatgjatë në fushën e mjekësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1: Studenti i pranuar në programin e studimit specializues afatgjatë në fushën e mjekësisë ka përfunduar programin e integruar të studimeve universitare të integruara të ciklit të dytë me kohëzgjatje 5 vjeçare (300 ECTS) në Farmaci dhe Stomatologji dhe 6 vjeçare (360 ECTS) në Mjekësi e përgjithshme, pranë një universiteti të akredituar për programin në fjalë dhe ka fituar diplomën universitare "Master i Shkencave". Për studentët e diplomuar në të njëjtat programe jashtë shtetit, duhet të paraqesin diplomën dhe lejen për ushtrimin e profesionit të njohur nga institucioni shtetëror përgjegjës.</p>	<p>UNIZKM ka të përcaktuara në rregulloren e programit kriteret dhe procedurën e pranimit të studentëve. Në programet e studimit specializuese afatgjata mund të aplikojnë kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të kenë përfunduar një program të integruar studimi të ciklit të dytë në Mjekësi dhe Kirurgji në një IAL të akredituar dhe kanë fituar një diplomë të vlefshme; - të zotërojnë licensë për të ushtruar profesionin e mjekut. Ata të cilët nuk zotërojnë licensën e ushtrimit të profesionit mund të aplikojnë dhe nëse rezultojnë fitues mund të pranohen me rezervë dhe duhet të marrin licensën brenda vitit të parë të specializimit, në të kundërt përjashtohen nga programi; - të zotërojnë një certifikatë ndërkombëtare të gjuhës angleze, frënge, spanjolle, gjermane ose italiane, në nivel C1. Kjo certifikatë nuk i kërkohet kandidatëve që janë shtetas të BE-së dhe vijnë nga vendet ku përdoren gjuhët e parashikuara, ose që kanë përfunduar një cikël studimesh në një prej këtyre gjuhëve. <p><i>Evidenca nr. 12, 34; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 2: Kandidati që aplikon për të vazhduar programin e studimeve të ciklit të tretë, për specializim afatgjatë në fushën e mjekësisë, i nënshtrohet një konkursi pranimi për të testuar njohuritë në fushën përkatëse të studimit.</p>	<p>Me propozim të Dekanit dhe miratim të Rektorit, ngrihet Komisioni i Vlerësimeve të pranimeve, i cili përbëhet nga të paktën 3 anëtarë të zgjedhur nga personeli akademik i fushave të specializimit, të cilët duhet të kenë së paku gradën shkencore Doktor apo PhD dhe të kenë një eksperiencë profesionale të paktën 10 vjeçare në fushën përkatëse.</p> <p>Nga vendimi i miratimit të këtij komisioni nga Rektori me nr. 26/1 prot., datë 22.02.2023, rezulton se komisioni përbëhet nga 4 anëtarë, ku 3 prej tyre mbajnë titullin Profesor dhe 1 gradën shkencore Dr.</p> <p>Vlerësimi i kandidatëve përmes konkursit të pranimit ka një sistem pikëzimi si më poshtë vijon:</p>
<p>Kriteri 3: Vlerësimi i studentit për pranimin në një program studimi bëhet me pikë kumulative duke vlerësuar të paktën elementët e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> • notën mesatare (notën përfundimtare sipas tipologjisë së diplomës që ai disponon) për jo më shumë se 30% të pikëve totale, • testimin e përgjithshëm me shkrim për 30-40% të pikëve totale, 	<ul style="list-style-type: none"> • 30 pikë është testi me shkrim mbi njohuritë e përgjithshme të lëndës; • 40 pikë është testi mbi njohuritë specifike të programit të specializimit; • 20 pikë është nota mesatare e ponderuar e kandidatëve të cilët kanë përfunduar studimet në Shqipëri dhe nota e diplomës e kandidatëve të cilët kanë përfunduar studimet jashtë;

<ul style="list-style-type: none"> • testimin me shkrim specifik sipas programit të specializimit për të cilin konkurren për 40-50% të pikëve totale. 	<ul style="list-style-type: none"> • 10 pikë është intervista me gojë. <p><i>Evidenca nr. 12, 34, 35.</i></p>
<p>Kriteri 4: Kandidati që aplikon në programet e ciklit të tretë specializim afatgjatë duhet të ketë përfunduar me sukses provimin e shtetit në profesionin përkatës ose të ketë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në RSH ose jashtë saj (njohur në RSH). Studenti mund të riaplikojë për të konkuruar në një program tjetër specializues në një IAL sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Studentit mund t'i njihen ECTS-të e grumbulluara për studimet e organizuara teorike nëse gjykohet se përputhen me fushën e programit të ri ku ai ka aplikuar.</p>	<p>Sikurse parashikuar në rregulloren e programit të studimit, një prej kriterëve që kandidatët duhet të plotësojnë për të aplikuar për pranimin në këtë program studimi është zotërimi i licensës për të ushtruar profesionin e mjekut. Ata kandidatë të cilët nuk zotërojnë licensën e ushtrimit të profesionit mund të aplikojnë dhe nëse rezultojnë fitues mund të pranohen me rezervë dhe duhet të marrin licensën brenda vitit të pare të specializimit, në të kundërt përjashtohen nga programi. Në dokumentacionin e verifikuar gjatë vizitës në institucion për studentët e këtij programi studimi, u verifikua gjithashtu pajisja e këtyre studentëve me licensën e ushtrimit të profesionit.</p> <p><i>Evidenca nr. 12; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 5: Kriteret minimale për t'u kualifikuar në përzgjedhjen e programit të studimit specializim afatgjatë janë të pasqyruara në rregulloren e programeve të studimeve të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë dhe të aprovuara nga Senati Akademik.</p>	<p>Kriteret minimale dhe procedura për t'u kualifikuar në përzgjedhjen e programit të studimit specializim afatgjatë janë të pasqyruara në kreun III të rregullosës së programeve të studimeve të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, të miratuar nga Senati Akademik.</p> <p><i>Evidenca nr. 12, 37.</i></p>
<p>Kriteri 6: Aplikanti njihet me rregulloren e specializimeve afatgjata të miratuar nga Senati akademik i IAL, me kriteret minimale të pranimit, në faqen zyrtare të IAL dhe/ose njësisë kryesore, para se të pranohet në të.</p>	<p>Me dorëzimin e dokumentacionit për pranimin në konkurs, kandidatit i vihet në dispozicion një kopje e formularit të aplikimit e firmosur nga palët dhe vulosur me vulën e fakultetit, rregullorja e konkurimit ose adresa e internetit ku mund ta gjëjë, si dhe të dhënat për datën e shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i Vlerësimit dhe se ku mund të informohet mbi vendin dhe orën e konkurimit dhe rezultatin përfundimtar. Studentët mund të njihen gjithashtu me informacionin e nevojshëm edhe përmes faqes zyrtare të internetit të UNIZK.</p> <p><i>Evidenca nr. 12.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UNIZKM ka të përcaktuara në rregulloren e programit kriteret dhe procedurën e pranimit të studentëve. Kandidati që aplikon për të vazhduar programin e studimeve të ciklit të tretë, për specializim</i></p>



	<p>afatgjatë në fushën e mjekësisë, i nënshtrohet një konkursi pranimit për të testuar njohuritë në fushën përkatëse të studimit, në bazë një sistemi pikëzimi për njohuritë e përgjithshme dhe specifike, notën mesatare të pondëruar dhe intervistën me gojë. Kandidatët për specializantë duhet të plotësojnë kriterin e zotërimit të licensës për të ushtruar profesionin e mjekut.</p> <p>Me dorëzimin e dokumentacionit për pranimin në konkurs, kandidatit i vihet në dispozicion një kopje e formularit të aplikimit e firmosur nga palët dhe vulosur me vulën e fakultetit, rregullorja e konkurimit ose adresa e internetit ku mund ta gjëjë, si dhe të dhënat për datën e shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni i Vlerësimit dhe se ku mund të informohet mbi vendin dhe orën e konkurimit dhe rezultatin përfundimtar.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.4	
Hartimi dhe miratimi i rregullores së specializimeve afatgjata.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Rregullorja është hartuar në përputhje me standardet e specializimeve në fushën e mjekësisë dhe me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>UNIZKM ka miratuar Rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, që prej hapjes së programit të studimit në vitin 2017, e më pas, më Vendim të Senatit Akademik nr. 239/2, datë 13.06.2019 ka miratuar Rregulloren e përditësuar të specializimeve. Sikurse përmendur edhe më lart, Rregullorja propozohet nga Njësia kryesore që ofron programin e specializimeve dhe aprovohet nga Senati Skadematik i IAL.</p> <p>Rregullorja duhet të përditësohet në përputhje me VKM Nr. 824, datë 24.12.2021 për miratimin e Kodit të Cilësisë.</p>
Kriteri 2: Rregullorja hyn në fuqi në fillim të çdo viti akademik dhe përditësohet çdo vit të ri akademik. Nëse ska ndryshime, është në fuqi rregullorja e fundit e përditësuar.	
Kriteri 3: Përditësimet në rregulloren e specializimeve afatgjata i përkasin ciklit të specializimit që fillojnë për herë të parë me rregulloren e përditësuar deri në përfundim të tij. Nëse është të nevojshme, ndryshimet në rregulloret pasardhëse duhet të përjashtojnë shprehimisht ciklin e nisur të specializimit.	
Kriteri 4: Rregullorja propozohet nga Njësia kryesore që ofron programin e specializimeve dhe	

aprovohet nga senati akademik i IAL.							
Konkluzione	<i>UNIZKM ka miratuar Rregulloren e studimeve të specializimeve afatagjata. Kjo rregullore duhet të përditësohet në përputhje me VKM Nr. 824, datë 24.12.2021 për miratimin e Kodit të Cilësisë.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>et</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	et	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
et	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	X						

Standardi II.5	
Rregullorja përcakton kriteret dhe mënyrën e përzgjedhjes së organeve drejtuese të programeve specializuese dhe tutorëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Në rregullore pasqyrohen qartë kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së përgjegjësit të programit të specializimit, sipas përcaktimeve në këto standarde.	<p>Në rregulloren e programit të studimit janë të përcaktuara kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së organeve drejtuese të programit të studimit, si dhe detyrat e tyre.</p> <p>Përgjegjësi/Drejtori i programit të specializimit duhet të ketë të paktën titullin “Profesor i Asociuar” ose një kualifikim të përfituar në vende perëndimore dhe të konsideruar të barasvlefshëm me të, si dhe 10 vite përvojë në ushtrimin e profesionit. Drejtori i programit të studimit “Sëmundje të Aparatit Kardiovaskular” është Prof. F.R, emëruar nga Rektori i UNIZKM me vendim nr. 37 prot., datë 29.01.2019.</p> <p>Sipas vendimit të Dekanit të fakultetit nr. 4_1/20 prot., datë 21.01.2020 “Masat për funksionimin e shkollave të specializimit” është parashikuar gjithashtu që drejtori i shkollës së specializimit ka për detyrë të mbajë kontakte me tutorin klinik dhe të përgatisë e nënshkruajë një raport vjetor, duke hartuar një raport specifik i cili përmban edhe të dhëna numerike për veprimtaritë e kryera nga specializanti.</p> <p>Këshilli Drejtues i programit të studimit ngrihet në nivel njësie kryesore dhe përbëhet nga të paktën 5 anëtarë pedagogë me kohë të plotë të IAL, jo më pak se 2 pedagogë për çdo program studimi që ofron njësia kryesore, të cilët duhet të jenë figura të spikatura në fushën e specialitetit përkatës, me përvojë klinike dhe akademike të paktën 10 vjeçare. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se Këshilli Drejtues është zgjedhur nga</p>
Kriteri 2: Në rregullore përcaktohen kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së mjekut përgjegjës/tutor për çdo specializant si dhe detyrat e tij.	



Kolegji i docentëve të UNIZKM në mbledhjen e datës 13.02.2022 dhe përbëhet nga 5 anëtarë, ku të gjithë kanë të paktën gradën shkencore Doktor.

Në nivel njësie bazë, programi i studimit disponon pedagogë të angazhuar në procesin e mësimdhënies brenda programit të studimit dhe pedagogë jo anëtarë të personelit akademik të universitetit të cilët ushtrojnë profesionin në strukturat e rrjetit formues me të cilët lidhet një kontratë specifike private.

Tutori (udhëheqësi klinik) ndjek specializantin gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe është përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit dhe zhvillimin e monitorimin e punës së tij. Fusha e tij përputhet me atë të programit specializues të studentit dhe ka eksperiencë profesionale me përvojë klinike në fushën klinike përkatëse. Tutori mund të ndjekë deri në 3 specializantë, mund të punojë me kohë të plotë në një nga strukturat e rrjetit formues, si dhe ka një kontratë bashkëpunimi me strukturën që ofron programin specializues. Kur tutori nuk është pjesë e personelit akademik të universitetit, studenti ka në dispozicion dhe një udhëheqës akademik, i cili është anëtar i personelit akademik të institucionit, ka së paku gradën shkencore Doktor dhe është i specializuar në fushën e programit të specializimit. Kontratat e tutorëve u verifikuan edhe gjatë vizitës në Institucion. Tutorët zgjidhen nga Këshilli Drejtues i programit, pas marrjes së mendimit të departamentit dhe fakultetit përgjegjës të programit të studimit dhe miratohen nga Rektori.



Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se Këshilli Drejtues, në mbledhjen e datës 13.02.2022, pasi ka marrë mendimin e Departamentit dhe Dekanit, ka emëruar udhëheqësit akademikë dhe klinikë të cilët do të udhëheqin ecurinë klinike dhe kërkimin shkencor të specializantëve, me miratimin e Rektorit. Tutorët e zgjedhur kanë të gjithë të paktën gradën shkencore Doktor.

Sipas vendimit të Dekanit të fakultetit nr. 4_1/20 prot., datë 21.01.2020 "Masat për funksionimin e shkollave të specializimit" është parashikuar gjithashtu që tutori klinik, përgjegjës për praktikën klinike të specializantit, ka për detyrë të vlerësojë frekuentimin mujor të secilit specializant që ka në tutorazh dhe ka për detyrë të nënshkruajë periodikisht librezën e frekuentimit që



	disponojnë në të cilën shënohet frekuentimi klinik dhe aktiviteti mujor.		
	<i>Evidenca nr. 12, 28, 39, 51; Evidenca shitesë gjatë vizitës nr. 1.</i>		
Konkluzione	<i>Në rregulloren e programit të specializimit pasqyrohen qartë kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së përgjegjës të programit të specializimit dhe tutorit për çdo specializant si dhe detyrat e përgjegjës të secilit prej tyre.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.6	
Në rregullore është përcaktuar qartë mënyra e pranimit të studentëve në programin e specializimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Në rregullore janë përcaktuar kriteret për aplikim (niveli i studimeve të kryera, kohëzgjatja dhe titulli i diplomës që kërkohet etj) si dhe kriteret përjashtuese nëse ka të tilla.	Rregullorja e programeve specializuese afatgjata e miratuar nga UNIZKM parashikon në mënyrë të detajuar kriteret e pranimit të studentëve; mënyrën e aplikimit për pranim në këtë program studimi të kandidatëve; dokumentacionin që duhet të dorëzohet nga kandidatët, përfshirë edhe ata që aplikojnë për transferim studimesh; afatet e zhvillimit të procesit dhe vendin e mënyrën e gjetjes së informacionit prej kandidatëve; dokumentacionin që i vihet në dispozicion kandidatëve në momentin e dorëzimit të dokumentacionit; ngritjen dhe veprimtarinë e komisionit të vlerësimit të pranimeve së bashku me detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse; mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe përzgjedhjen e tyre përmes konkursit të pranimit dhe sistemin e pikëzimit; mënyrën dhe afatet e regjistrimit të kandidatëve fitues; të drejtat dhe detyrat e tyre, etj.
Kriteri 2: Në rregullore përcaktohet qartë dokumentacioni që duhet të dorëzojë kandidati për aplikim, mënyra e dorëzimit të dokumentacionit dhe afati përfundimtar.	
Kriteri 3: Në rregullore janë përcaktuar qartë pikët maksimale që mund të grumbullojë kandidati dhe pikët që i jepen kandidatit për çdo kriter të plotësuar si dhe pikët maksimale dhe minimale që mund ti jepen kandidatit gjatë çdo testimi.	Sipas kësaj rregulloreje, kandidatët për programet e specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë duhet të kenë përfunduar një program të integruar studimi të ciklit të dytë në Mjekësi të Përgjithshme ose Farmaci dhe të kenë diplomën “Master i Shkencave”, të akredituar përpara lëshimit të diplomës. Për studentët e diplomuar jashtë vendit, ata duhet të kenë diplomë “Master i Shkencave” të njohur nga Ministria përgjegjëse për Arsimin dhe Ministria përgjegjëse për Shëndetësinë. Kandidatët duhet të kenë kryer provimin e shtetit sipas ligjit nr. 10171
Kriteri 4: Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e aplikimit, e konkurrimit e kandidati për specializim; përcaktohet sa kohë para datës së shpallur për testimet mbyllet pranimi i dokumenteve.	
Kriteri 5: Në rregullore është përcaktuar qartë mënyra e	

zhvillimit të testeve dhe procedura e tyre.	22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë" dhe të kenë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit.
Kriteri 6: Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e vlerësimit të kandidatëve për çdo testim dhe dokumentacioni i përdorur i cili ruhet sipas procedurave të parashikuara në rregullore.	Kur studenti nuk e ka përfunduar ende provimin e shtetit pranohet me kusht që ta përfundojë atë me sukses brenda vitit të parë të specializimit, në të kundërt përjashtohet nga programi.
Kriteri 7: Emërtimet e programeve të specializimeve të miratuara për vitin akademik, numri i specialistëve që do të pranohen për çdo program specializimi dhe tarifën që duhet të paguajë specialisti për çdo specializim publikohen të paktën 2 javë përpara datës së fillimit të aplikimeve.	Kandidatët duhet të kenë një mesatare të ponderuar notash të gjithë viteve jo më të vogël se 5. Për studentët e diplomuar në të njëjtën degë jashtë vendit në vende perëndimore të cilëve u njihet diploma për ushtrimin e profesionit përkatës në këtë vende, nuk qëndron kriteri për notën mesatare për tu pranuar në program. Gjithashtu, kandidatët duhet të kenë një certifikatë ndërkombëtare të njohjes së një prej pesë gjuhëve të huaja, me përjashtim të kandidatëve të cilët janë diplomuar në një program studimi të kryer në njërin nga këto gjuhë.
Kriteri 8: Mënyra e vlerësimit mbi të cilat kryhet testimi duhet të përcaktohen në rregullore dhe të publikohen të paktën 2 javë përpara datës së fillimit të aplikimeve.	Sipas nenit 20 të Rregullores, kandidati duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: - Kërkesë aplikimi në programin e specializimit; - Fotokopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave për çdo provim të dhënë; - Fotokopje e noterizuar e licensës së ushtrimit të profesionit;
Kriteri 9: Në rregullore është përcaktuar qartë mënyra dhe afatet e shpalljes së rezultateve të testeve dhe të listës përfundimtare me fituesit si dhe është përcaktuar vendi dhe data e shpalljes së rezultateve.	- CV; - Fotokopje e noterizuar e dokumentit të identifikimit; - Tituj të tjerë të mundshëm dhe vërtetime të noterizuara; - Kopje origjinale ose e noterizuar e temës së diplomimit; - Vërtetimi i pagës së tarifës.
Kriteri 10: Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e lidhjes së kontratës me specialistët fitues.	Kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh, përpos dokumentacionit të mësipërm, duhet të përcjellin edhe: - Planin e plotë të programit të studimit që ka ndjekur; - Vërtetim të listës së notave dhe krediteve që ka marrë për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, shoqëruar edhe me syllabuset përkatëse; - Vërtetim për periudhat e praktikave dhe frekuentimin e aktiviteteve të parashikuara në programin specializues të ndjekur. Aplikimet fillojnë jo më vonë se 2 javë kalendrike përpara datës së vlerësimit nga komisioni i posaçëm dhe mbyllet jo më vonë se 7 ditë kalendrike përpara kësaj date. Lista emërore e kandidatëve shpallet në faqen zyrtare të UNIZKM, jo më vonë se 2 ditë pune përpara datës së konkurimit. Orari dhe vendi i konkurimit shpallen

dhe afishohen pranë fakultetit dhe departamenteve përkatës dhe në faqen zyrtare të paktën 4 ditë para datës së konkurimit.

Me propozim të Dekanit dhe miratim të Rektorit, ngrihet Komisioni i Vlerësimeve të pranimeve, i cili përbëhet nga të paktën 3 anëtarë të zgjedhur nga personeli akademik i fushave të specializimit, të cilët duhet të kenë së paku gradën shkencore Doktor apo PhD dhe të kenë një eksperiencë profesionale të paktën 10 vjeçare në fushën përkatëse.

Nga vendimi i miratimit të këtij komisioni nga Rektori me nr. 26/1 prot., datë 22.02.2023, rezulton se komisioni përbëhet nga 4 anëtarë, ku 3 prej tyre mbajnë titullin Profesor dhe 1 gradën shkencore Dr. Vlerësimi i kandidatëve përmes konkursit të pranimit ka një sistem pikëzimi si më poshtë vijon:


- 30 pikë është testi me shkrim mbi njohuritë e përgjithshme të lëndës;
- 40 pikë është testi mbi njohuritë specifike të programit të specializimit;
- 20 pikë është nota mesatare e ponderuar e kandidatëve të cilët kanë përfunduar studimet në Shqipëri dhe nota e diplomës e kandidatëve të cilët kanë përfunduar studimet jashtë;
- 10 pikë është intervista me gojë.

Kuotat në dispozicion për pranim në programin e studimi dhe tarifat përkatëse, përcaktohen çdo vit me Vendim të Senatit Akademik, me propozimin e Fakultetit të Mjekësisë dhe në lidhje me strukturat në dispozicion dhe në përputhje me politikat e zhvillimit shëndetësor të vendit. Numri i specializantëve dhe tarifat publikohen në shpalljen e konkursit, e cila publikohet të paktë 2 javë para datës së fillimit të aplikimeve.


Në rregulloren e studimit nuk parashikohet specifikisht lidhja e kontratës me specializantët fitues, por vetëm të drejtat dhe detyrimet e tyre, edhe pse GVJ, gjatë vizitës në Institucion, verifikoi dosjet e studentëve dhe konstatoi se UNIZKM lidh kontratë me secilin specializant. Për sa më lart, GVJ rekomandon që me përditësimin e rregullore së specializimit, të përfshihet si pikë e rregullore edhe lidhja e kontratës së IAL me specializantët.

	Evidenca nr. 12, 25, 34, 35, 36, 37, 40; Vizita në institucion, evidence shitesë nr. 6.		
Konkluzione	<p>Në rregulloren e programit specializues janë të përcaktuara qartë kriteret për aplikim të kandidatëve, dokumentacioni që duhet të dorëzojë kandidati për aplikim, mënyra e dorëzimit të dokumentacionit dhe afati përfundimtar, pikët maksimale që mund të grumbullojë kandidati për çdo kriter e testim, mënyra e aplikimit dhe konkurrimit të kandidatit për specializim, mënyra e zhvillimit të testimeve dhe procedura e tyre, mënyra e vlerësimit të kandidatëve, afatet përkatëse për hapat e këtij procesi, etj.</p> <p>Në rregulloren e studimit nuk parashikohet specifikisht lidhja e kontratës me specializantët fitues, por vetëm të drejtat dhe detyrimet e tyre, edhe pse GVJ, gjatë vizitës në Institucion, verifikoi dosjet e studentëve dhe konstatoi se UNIZKM lidh kontratë me secilin specializant. GVJ rekomandon që me përditësimin e rregullores së specializimit, të përfshihet si pikë e rregullores edhe lidhja e kontratës së IAL me specializantët.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi IL7	
Në rregullore parashikohen element të procesit mësimor të programit specializues.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Parashikohen në rregulloren e specializimeve mënyra e frekuentimit, maksimumi i mungesave të lejuara dhe arsye, leja e lindjes, dhe mënyra e rikuperimit të mungesave etj.	Specializanti është i detyruar të marrë pjesë në realizimin e programit teorik dhe praktik të specialitetit përkatës me të cilin njihet që në fillim të programit. Studenti merr pjesë në aktivitetet e parashikuara të programit të studimit, jashtë punës së tyre klinike, si dhe është i lirë të marrë pjesë si dëgjues apo referues në leksione, seminare, debate ndërdisiplinore të organizuara në kuadër të programit të specializimeve, konferenca, seminare, etj.
Kriteri 2: Parashikohen në rregulloren e specializimeve procedurat për transferimet për apo nga programe të tjera specializuese, ose për apo nga institucione të tjera që ofrojnë programe specializuese në mjekësi.	Studenti merr pjesë aktive në të gjithë aktivitetin e strukturave klinike dhe universitare ku kryer specializimin gjithmonë nën përgjegjësinë e pedagogëve, tutorëve dhe mjekëve specialist të rrjetit formues. Ai ka të drejtën e pushimit vjetor 4 javë në periudhën e parashikuar në strukturën didaktike-klinike të rrjetit formues. Koha e pushimit vjetor përcaktohet në marrëveshje me drejtuesit e specializimit. Për mungesat për arsye shëndetësore duhet të
Kriteri 3: Parashikohen në rregulloren e specializimeve kriteret dhe mënyra e pezullimit, zgjatjes ose përjashtimit të specializantit nga studimet specializuese.	



36





Kriteri 4: Rregullorja parashikon rastet kur specializimi mund të kryhet në një institucion tjetër që nuk është pjesë e rrjetit formues shqiptar, kohëzgjatjen e kësaj periudhe dhe organin aprovues të kësaj procedure. Këto institucione duhet të jenë të akredituara për kryerjen e programit specializues në vendin përkatës.

paraqitet raporti mjekësor. Në rast se mungesat janë mbi 30% të ciklit apo modulit mësimor, ky i fundit duhet përsëritur. Në rast të lejes së lindjes, specializimi do të shtyhet për aq kohë sa është leja e lindjes, në mënyrë që të kryhet i plotë programi teorik e praktik. Gjatë vizitës në Institucion u njohëm dhe verifikuam rastin e njëres prej studenteve të regjistruara në vitin akademik 2018-2019, e cila ka pezulluar studimet për arsye lindjeje. Në rast fatkeqësie familjare, specializanti mund të mungojë për një periudhë jo më shumë se 30 ditë dhe të shlyejë detyrimet në një kohë të mëvonshme. Specializanti nuk lejohet të përsërisë vitin, përveç rasteve të sipërcituara.

Sikurse përmendur edhe në standardin II.2, sipas rregullores së specializimit, programit nuk mund të zgjasë më tepër se 1 vit nga kohëzgjatja zyrtare e tij, duke zbritur kohën e sëmundjeve të mundshme të vërtetuara. Specializanti që nuk kalon vlerësimin përfundimtar ka të drejtë t'i nënshtrohet edhe një herë tjetër këtij vlerësimi, por jo më vonë se 1 vit pas përfundimit të specializimit. Studenti regjistrohet si përsëritës dhe paguan tarifën e plotë të shkollimit për vitin që ndjek dhe ndjek aktivitetet përkatëse profesionale me kohë të plotë. Studenti që nuk i është nënshtuar vlerësimit përfundimtar brenda 1 viti nga përfundimi, humbet të drejtën e marrjes së diplomës, por i jepet një certifikatë që vërteton se ka kryer ciklin e plotë të studimeve, përveç diplomimit. *Sikurse përmendur edhe më lart, UNIZKM duhet të përditësojë rregulloren e programit të studimit për këtë element, për të qenë në përputhje me nenin 90 të LAL 80/2015.*

Në përfundim të çdo viti akademik organizohet një provim vlerësues teorik dhe praktik, i cili vlerësohet me notë. Vlerësimi vjetor kryhet nga një komision i përbërë nga të paktën 5 anëtarë specialistë të fushës përkatëse ose të përafërt me të. Specializantët që vlerësohen jo kalues 5 herë, marrin një dëshmi për modulet e zhvillua dhe kreditet e grumbulluara dhe ndërpresin studimet. Studenti mund të aplikojë për të konkuruar në një program tjetër specializues jo më shumë se 1 herë. Studentit mund t'i njihen ECTS-të për studimet e organizuara teorike nga Këshilli Drejtues nëse gjykohet se përputhen me fushën e programit të ri ku ka aplikuar, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.



	<p>Studentët kanë të drejtë të transferohen në vite të ndërmjetme, maksimalisht viti i dytë, në programe të tjera specializimi. Shqyrtimi i aplikimit dhe dosjes përkatëse realizohet nga Komisioni i ngritur nga programi ku synon të transferohet. Ky transferim, sipas përcaktimeve në rregullore, mund të realizohet vetëm nëse janë parashikuar kuota specifike për këtë qëllim. Nëse numri i transferimeve është më i madh se kuotat e parashikuara, kandidatët i nënshtrohen konkurimit.</p> <p>Studenti ka të drejtë që një pjesë të periudhës së specializimit ta kryejë jashtë vendit, duke transferuar kreditet e fituara, me miratimin e Drejtuesit të programit, Përgjegjësit të Departamentit dhe Dekanit të Fakultetit. Këto IAL duhet të jenë të licensuara për kryerjen e programit në vendin e tyre të origjinës.</p> <p><i>Evidenca nr. 12.</i></p>								
Konkluzione	<p><i>Rregullorja e programit të studimit parashikon: elemente të procesit mësimor të programit specializues; mënyrën e frekuentimit; mungesat e lejuara dhe arsyt; mënyrën e rikuperimit të mungesave; procedurat për transferimet për apo nga programe të tjera specializuese, ose për apo nga institucione të tjera që ofrojnë programe specializuese në mjekësi; kriteret dhe mënyra e pezullimit, zgjatjes ose përjashtimit të specializantit, etj. UNIZKM duhet të përditësojë rregulloren e programit të studimit lidhur me elementin e kohëzgjatjes maksimale të programit të studimit.</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Nuk përmbushet</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Nuk përmbushet	X			
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Nuk përmbushet						
X									



Standardi II.8	
Në rregullore parashikohen element të procesit mësimor të programit specializues.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1: Rregullorja parashikon librezën e aktivitetit praktik së studentit, mënyrën e plotësimit të saj dhe mënyrën e zëvendësimit të saj në rast humbje. Libreza e studentit e shoqëron atë deri në përfundim të ciklit specializues dhe diplomimit të tij.</p>	<p>Në fillim të programit, student pasjiset me Librezën e Studentit, ku duhet të shënohen të gjitha notat dhe vlerësimet vjetore të tij. Kjo librezë e shoqëron studentin deri në përfundimin e programit dhe diplomimin e tij. Për të gjitha aktivitetet e parashikuara në programin e studimit të cilat përmbajnë vlerësim apo kërkohet të certifikohet frekuentimi, studenti paraqitet me librezën, e cila, në përfundim të aktivitetit plotësohet nga pedagogu përgjegjës për zhvillimin e atij aktiviteti. Plotësimi i librezës është i detyrueshëm</p>

	<p>dhe student nuk pranohet në aktivitetet përkatëse nëse nuk e paraqet atë.</p> <p>Në rastet kur student e humbet librezën, sekretaria e pajis atë me një librezë të re si dhe plotëson në librezë aktivitetet e shlyera deri në atë moment, të cilat rezultojnë në aktet e depozituara në sekretari. Në përfundim të programit specializues, librezat dorëzohet në sekretari. Librezat e studentëve të këtij programi u panë dhe verifikuan edhe gjatë vizitës në Institucion.</p> <p><i>Evidenca nr. 12, 43, 44; Evidenca shtesë gjatë vizitës nr. 6.</i></p>						
Konkluzione	<p><i>Rregullorja e programit të studimit parashikon pajisjen e studentit me librezën e aktivitetit praktik së studentit, mënyrën e plotësimit të saj dhe mënyrën e zëvendësimit të saj në rast humbje. Librezat e studentit e shoqëron atë deri në përfundim të ciklit specializues dhe diplomimit të tij.</i></p>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					



Standardi II.9	
Në rregullore parashikohen procedurat për testimet vjetore dhe testimin përfundimtar si dhe formati i diplomës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1: Në rregullore përcaktohet mënyra e testimit vjetor të lëndëve dhe ai përfundimtar të specializantëve, pikët minimale dhe maksimale, lloji i testit, etj.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet mënyra e vlerësimit të studentit, rastet e nungesave dhe pajisja me diplomën e programit.</p> <p>Studenti vlerësohet për çdo cikël praktik me notë dhe pa notë, e cila depozitohet në sekretari. Studenti mund të futet në provimin përfundimtar pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve vjetore të parashikuara në planin mësimor dhe miratimit të dosjes nga Këshilli i programit specializues, ku përfshihen vlerësimet mbi praktikën dhe modulet mësimore të kryera si dhe vlerësimet periodike nga udhëheqësi. Në rast se studentit vlerësohet negativisht nga Këshilli, studentit duhet të përsërisë pjesën në mënyrë që të mund të hyjë në provimin përfundimtar. Vlerësimi përfundimtar vjetor bazohet në rezultatet e vlerësimeve periodike vjetore, provimin përfundimtar dhe temën eksperimentale të diplomës, si dhe gjykimin e pedagogëve dhe udhëheqësit, me një sistem notash nga 18/30 deri në 30/30.</p>
<p>Kriteri 2: Në rregullore përcaktohen rastet e mungesave të justifikuar në testime dhe mënyra e rikuperimit të testimit në këto raste.</p>	
<p>Kriteri 3: Në përfundim të studimeve të specializimit afatgjatë, I diplomuari pajiset me diplomën e specializimit. Diploma duhet të firmoset nga rektori i IAL dhe dekani i fakultetit përkatës</p>	

	<p>Studenti që ka shlyer të gjitha detyrimet teorike dhe praktike dhe ka marrë vlerësimin përfundimtar, pajiset me Diplomën e studimit, të miratuar nga Senati Akademik dhe QSHA.</p> <p>Sipas rregullores, studenti që nuk kalon vlerësimin përfundimtar, ka të drejtë t'i nënshtrohet edhe një herë tjetër këtij vlerësimi, por jo më vonë se 1 vit pas përfundimit të programit. Studenti që nuk i është nënshtruar këtij vlerësimi brenda 1 viti, humbet të drejtën e marrjes së diplomës, por i jepet një certifikatë që vërteton se ka kryer ciklin e plotë të studimeve, përveç diplomimit, si dhe listën e notave dhe të aktiviteteve të kryera.</p> <p><i>Evidenca nr. 12.</i></p>						
Konkluzione	<p><i>Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet mënyra e vlerësimit të studentit, rastet e nungesave dhe pajisja me diplomën e programit. Studenti vlerësohet për çdo cikël praktik me notë dhe pa note dhe mund të futet në provimin përfundimtar pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve vjetore të parashikuara në planin mësimor dhe miratimit të dosjes nga Këshilli i programit specializues, ku përfshihen vlerësimet mbi praktikat dhe modulet mësimore të kryera si dhe vlerësimet periodike nga udhëheqësi. Vlerësimi përfundimtar vjetor bazohet në rezultatet e vlerësimeve periodike vjetore, provimin përfundimtar dhe temën eksperimentale të diplomës, si dhe gjykimin e pedagogëve dhe udhëheqësit. Studenti që ka shlyer të gjitha detyrimet teorike dhe praktike dhe ka marrë vlerësimin përfundimtar, pajiset me Diplomën e studimit, të miratuar nga Senati Akademik dhe QSHA.</i></p>						
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përbushet kryesisht</td> <td>Përbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

Standardi II.10	
Të drejtat dhe detyrimet e specializantit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Rregullorja duhet të përmbajë detyrat dhe të drejtat që ka specializanti.	Në kapitullin IV të rregullores së specializimeve parashikohen të drejtat dhe detyrimet e studentit.
Kriteri 2: Në rregullore përcaktohet tipologjia dhe mënyra e sigurimit të specializantëve gjatë kryerjes së specializimit.	Studenti, gjatë gjithë periudhë së specializimit dhe të gjitha aktivitetet e parashikuara është i siguruar. Studenti sigurohet për përgjegjësinë profesionale për dëmet që mund t'u shkaktojë të

<p>Parashikohet tipi i policës së sigurimit dhe masa e mbulimit.</p> <p>Kriteri 3: Parashikohen rastet kur mund të pezullohet specializimi nga ana e specialistit dhe periudha maksimale e lejuar për pezullim, si dhe procedurat për të hequr dorë nga specializimi.</p>	<p>tretëve, si dhe për dëmet që mund t'i shkaktohen atij, gjatë periudhës së specializimit dhe ushtrimit të detyrave të parashikuara në programin specializues. Masa e mbulimit të policës së sigurimit përfshim sigurim shëndeti për specialistët dhe sigurim për përgjegjësisë profesionale ndaj të tretëve. Polica e sigurimit paguhet dhe lidhet nga Fakulteti me kompaninë e sigurimit. Dokumentacioni mbi policën e sigurimit për studentët e këtij programi u verifikua edhe gjatë vizitës në Institucion.</p>
<p>Kriteri 4: Në rregullore përcaktohen tregues të matshëm lidhur me plagjiaturën të punimit të diplomës si dhe referenca lidhura me to duke u kujdesur që niveli i ngjashmërisë të punimit të diplomës të jenë nën 30%.</p>	<p>Studenti që ka shlyer të gjitha detyrimet teorike dhe praktike dhe ka marrë vlerësimin përfundimtar, pajiset me Diplomën e studimit, të miratuar nga Senati Akademik dhe QSHA.</p> <p>Sipas rregullores, studenti që nuk kalon vlerësimin përfundimtar, ka të drejtë t'i nënshtrohet edhe një herë tjetër këtij vlerësimi, por jo më vonë se 1 vit pas përfundimit të programit. Detyrie të mbartura lejohen vetëm në raste të veçanta të parashikuara në nenin 35 të rregullores. Kur studenti dëshiron të pezullojë studimet, duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim drejtuar Rektorit, duke e depozituar në sekretarinë mësimore. Në rast të çregjistrimit, duhet të paraqitet një kërkesë për tërheqje drejtuar Rektorit, duke e depozituar në sekretarinë didaktike. Pas miratimit të kërkesës nga Rektori, sekretaria mësimore mbyll të gjitha veprimet ekzistuese në lidhje me studentit dhe anulon regjistrimin e tij si student.</p> <p>UNIZKM vë në dispozicion të studentëve sistemin antiplagjiaturë "Google for Education", i cili përdoret si për provimet përfundimtare ashtu edhe për studime të tjera. Në këtë sistem, pedagogëve u jepet leje nga IT për përdorimin e platformës, për të kontrolluar për plagjiaturë të mundshme në temën e studimit eksperimental të diplomës që paraqitet në komision. Është ky komision i cili vendos nivelin e pranueshëm të ngjashmërive të tezës. Në këtë program studimi nuk është diplomuar ende brezi i parë i studentëve, prandaj ky program nuk është përdorur ende.</p> <p><i>Evidenca nr. 12, 46, 47, 48, 49; Evidenca shtesë gjatë vizitës nr. 2</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në kapitullin IV të rregullores së specializimeve parashikohen të drejtat dhe detyrimet e studentit, mënyra e sigurimit të specialistëve gjatë kryerjes së specializimit, tipi i policës së sigurimit dhe masa e mbulimit, rastet e pezullimit apo heqjes dorë nga programi i studimit, etj.</i></p> <p><i>UNIZKM vë në dispozicion të studentëve sistemin antiplagjiaturë "Google for Education", i cili përdoret si për provimet përfundimtare ashtu edhe për studime të tjera.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.11	
Njësia kryesore përgjegjëse për programin e specializimit administron të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për çdo specializant nga aplikimi, pranimi deri përfundim të studimeve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Njësia kryesore mban në formë elektronike dhe në letër të gjithë dokumentacionin e aplikantëve në fazën e aplikimit.	Sekretaria didaktike është struktura e cila është përgjegjëse, ndër të tjera, edhe për dokumentimin e zhvillimit të procesit mësimor, si dhe dokumentacionin e rezultateve të provimeve deri në lëshimin e diplomës.
Kriteri 2: Njësia kryesore mban në formë elektronike dhe në letër të gjithë dokumentacionin e procesit të përzgjedhjes dhe vendimmarrjes të kandidatëve aplikantë dhe fitues dhe garanton transparencë në vendimmarrje e proceset e ankimimit.	IAL mban në formë elektronike dhe letër dokumentacionin lidhur me studentët e programit, i cili u verifikua edhe gjatë vizitës në IAL. Gjatë kësaj vizite, GVJ verifikoi dhe u informua gjithashtu se IAL nuk disponon ende regjistrin themeltar sipas modelit të miratuar nga QSHA, pasi ende nuk është kthyer përgjigja prej tyre. GVJ u njoh gjatë vizitës edhe me shkresën e dërguar nga UNIZKM në QSHA.
Kriteri 3: Njësia kryesore mban në formë elektronike dhe në letër të dhënat e çdo specializanti në lidhje me veprimtaritë akademike dhe kërkimore eksperimentale gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve.	Fakulteti mban në formë elektronike dhe në letër të dhënat e çdo specializanti në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar, pezulluar apo çregjistruar, veprimtaritë akademike dhe kërkimore eksperimentale gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve, raportimet dhe vlerësimet e specializantëve, etj.
Kriteri 4: Njësia kryesore mban në formë elektronike dhe në letër raportimet, komunikimet zyrtare, vlerësimet e lëndëve dhe të progresit të specializantit.	UNIZKM vë në dispozicion të studentëve sistemin antiplagjiaturë "Google for Education", i cili përdoret si për provimet përfundimtare ashtu edhe për studime të tjera.
Kriteri 5: Njësia kryesore ve në dispozicion të studentëve sistemin elektronik antiplagjiaturë si dhe mekanizma tjerë të vetëkontrollit për eliminimin e plagjiaturës dhe respektimin e të drejtës së pronësisë intelektuale.	Sipas rregullores së Njesisë së Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë, është pjesë e përgjegjësisë së kësaj strukture hartimi në mënyrë periodike i raportimeve mbi ecurinë e programit të specializimit, të cilat i dërgohen Rektorit, me qëllim përmirësimin e cilësisë së performancës. <i>Në dokumentacionin e përcjellë nga IAL, evidentohet një relacion i shkurtër që Drejtuesi i Departamentit harton, por ky relacion nuk përbën një raportim të mirëfilltë dhe nuk jep një informacion të plotë mbi ecurinë e programit të specializimit të hartuar nga njësia kryesore.</i>
Kriteri 6: Njësia kryesore harton në mënyrë periodike raportime mbi ecurinë e programit të specializimit.	<i>Evidenca nr. 12; Vizita në Institucion.</i>
Konkluzione	<i>Njësia kryesore përgjegjëse për programin e specializimit administron të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për çdo</i>

	<i>specializant nga aplikimi, pranimi deri përfundim të studimeve. Në dokumentacionin e përcjellë nga IAL, evidentohet një relacion i shkurtër që Drejtuesi i Departamentit harton, por ky relacion nuk përbën një raportim të mirëfilltë dhe nuk jep një informacion të plotë mbi ecurinë e programit të specializimit të hartuar nga njësia kryesore.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Plotërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

III. BURIMET NË FUNKSION TË PROGRAMIT SPECIALIZIM AFATGJATË



Standardi III.1 Njësia përgjegjëse garanton personelin e nevojshëm akademik, administrativ dhe mbështetës për zhvillimin e programit dhe realizimin e objektivave të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Personeli akademik i angazhuar në programin e specializimit afatgjatë është i kategorisë profesor (profesor, profesor i asociuar), i kategorisë lektor (Dr/Phd), të cilët janë të angazhuar me punë klinike/diagnostikuese të paktën 10 vite eksperiencë.	Sipas evidencës shtesë të përditësuar të marrë gjatë vizitës në Institucion (evidenca shtesë nr. 4. Shkresa e HR – CARDIO), personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga <i>17 personel akademik</i> , prej të cilëve <i>15 PAE</i> , me kualifikimin 8 Dr., 4 Prof. As. dhe 2 Prof. dhe <i>2 PAK</i> , me kualifikimin 1 Dr. dhe 1 Prof.As. dhe <i>9 personel akademik udhëheqës klinik PAK</i> , me kualifikimin 5 Dr., 3 Prof.As dhe 1 Prof. Sipas të dhënave të përcjella nga Institucioni, të gjithë anëtarët e personelit akademik të angazhuar në këtë program kanë eksperiencë të paktën 10 vjeçare, duke variuar nga 10 në 45 vite eksperiencë. <i>Evidenca shtesë gjatë vizitës nr. 4. Shkresa e HR – CARDIO.</i>
Kriteri 2: Në çdo program specializues përcaktohen: Një figurë drejtuese, përgjegjësi/drejtuesi i programit të specializimit. Përgjegjësi/drejtuesi i programit të specializimit duhet të jete pedagog me kohe te plote ne	Sipas rregullores së programit të studimit, programi i specializimit ka të përcaktuara strukturat drejtuese: Drejtorin e programit, Këshillin Drejtues, Përgjegjësin e menaxhimit ekonomik-financiar dhe detyrimeve administrative të universitetit dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

43

<p>fushën përkatëse, të ketë të paktën titullin “Profesor i asociuar” dhe jo me pak se 10 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Kjo figure propozohet nga njësia baze përgjegjëse dhe miratohet në nivel të njësisë kryesore.</p>	<p>Përgjegjësin e monitorimit dhe vlerësimit të brendshëm të programit të studimit. Për këtë program studimi, Drejtor është caktuar F.R, i cili mban titullin Profesor dhe ka një eksperiencë 23 vjeçare. <i>Evidenca 28; Evidenca shtesë gjatë vizitës nr. 4. Shkresa e HR – CARDIO.</i></p>
<p>Kriteri 3: Personeli akademik i programit të studimit specializim afatgjatë përbëhet nga: i. personel akademik me kohë të plotë me tituj akademikë dhe grada shkencore, jo më pak se 50% të pedagogëve që mbulojnë programin e studimit. Të paktën 1 (një) pedagog me kohë të plotë, i kategorisë profesor, duhet t’i përkasë fushës së programit të studimit. ii. Personel akademik, i cili ushtron profesionin në strukturat shëndetësore universitare të përcaktuara, sipas legjislacionit në fuqi në masën jo më shumë se 50% e pedagogëve që mbulojnë programin e studimit. Ky personel akademik të ketë eksperiencë didaktike-formuese dhe eksperiencë profesionale-klinike diagnostike. Zhvillimi i aktivitetit mësimdhënës nga personeli i strukturave shëndetësore të rrejtit formues kërkon miratimin paraprak të drejtuesit të strukturës shëndetësore. Zhvillimi i aktivitetit mësimdhënës nga personeli i strukturave shëndetësore universitare, kërkon në çdo rast miratimin paraprak nga IAL përkatëse, ku struktura shëndetësore universitare është pjesë përbërëse e saj. iii. personel akademik me kohë të pjesshme, për disiplina të veçanta, jo më shumë se 10% e pedagogëve që mbulojnë programin e studimit, me të cilët lidhet një kontratë, sipas nevojave të strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - personel akademik me kohë të plotë, i cili është i gjithi me tituj dhe grada dhe përbën 88% të numrit të personelit të angazhuar në programin e studimit ose 58% të numrit total duke përfshirë dhe udhëheqësit klinikë, dhe ku tre prej tyre mbajnë titullin Profesor; - personel akademik që ushtron profesionin në strukturat shëndetësore universitare, të cilët përbëjnë 35% të numrit total të personelit pjesë të programit, i cili ka eksperiencë eksperiencë didaktike-formuese dhe eksperiencë profesionale-klinike diagnostike; - personel akademik me kontratë (me kohë të pjesshme), i cili përbën 12% të numrit të personelit të angazhuar në programin e studimit ose 7.8% të numrit total duke përfshirë dhe udhëheqësit klinikë. <p>Duke qenë se programi i studimit ofrohet në bashkëpunim me Universitetin e Romës “Tor Vergata”, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit, në programin e studimit janë të angazhuar edhe pedagogë të këtij universiteti partner.</p> <p><i>Evidenca 26, 30; Evidenca shtesë gjatë vizitës nr. 4. Shkresa e HR – CARDIO.</i></p>

Kriteri 4: Programi i studimit specializim afatgjatë ka drejtuesin/përgjegjës in e programit. Përgjegjësi/drejtuesi i programit të specializimit duhet të jetë personel akademik me kohë të plotë. Përgjegjësi/drejtuesi i programit të specializimit është njëkohësisht dhe anëtar i njësisë bazë përgjegjëse/shërbimit përgjegjës për programin e specializimit afatgjatë. Përgjegjësi/drejtuesi i programit të specializimit zgjidhet nga anëtarët të asamblesë së njësisë bazë, me shumicë të thjeshtë (50%+1). Përgjegjësi/drejtuesi i programit në një IAL nuk mund të ngarkohet me përgjegjësinë e drejtimit të një tjetër programi studimi që realizohet nga IAL-të e tjera.

Kriteri 5: Njësia përgjegjëse garanton se ka kapacitete për udhëheqjen e specializantit. Udhëheqësi i specializantit është: udhëheqës akademik dhe udhëheqës klinik diagnostik.

Numri maksimal i studentëve që mund të ndiqet nga udhëheqës akademik/klinik diagnostik është sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Drejtimi i specializantit i ngarkohet, në cilësinë e udhëheqësit, një pedagogu (udhëheqës akademik) dhe/ose një anëtar i personelit të strukturës shëndetësore të rrjetit formues (udhëheqës klinik/tutori) të programit të studimit, i cili/të cilët udhëheqin specializantin gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe janë përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit, si edhe për zhvillimin dhe monitorimin e punës së studentit.

Fusha e specializimit të udhëheqësit duhet të përputhet me atë të programit specializues që ndjek.

Sipas rregullores së specializimit afatgjatë dhe dokumentacionit të përcjellë nga IAL, programi i specializimit ka të përcaktuar si Drejtor, profesorin F.R, i cili është anëtar me kohë të plotë i Departamentit të Shkencave Mjekësore, përgjegjës për programin afatgjatë të specializimit.

Gjithashtu, programi i studimit ka të përcaktuar tutorët e studentëve, të cilët ndjekin studentët gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe janë përgjegjës për orientimin, këshillimin dhe vlerësimin e nevojave të tij, si dhe monitorimin e punës së studentëve specializantë.

Sipas procesverbalit të mbledhjes së datë 13.02.2022, Këshilli Drejtues, pasi ka dëgjuar mendimin e Departamentit dhe Dekanit, ka emëruar pedagogët dhe udhëheqësit klinikë, të cilët do të udhëheqin ecurinë klinike dhe kërkimin shkencor të specializantëve, me miratimin e Rektorit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se njësia përgjegjëse ka kapacitete për udhëheqjen e specializantit.



Fusha e specializimit të tutorëve përputhet me atë të programit specializues, kanë të paktën gradën shkencare "Doktor" dhe eksperiencë profesionale të paktën 10 vjeçare.

Sipas rregullores së programit, por dhe dokumentacionit të shqyrtuar, tutori nuk ndjek më shumë se 3 studentë dhe mund të punojë më kohë të plotë në një nga strukturat e rrjetit të formimit, si dhe duhet të ketë një kontratë bashkëpunimi me strukturën partnere, e cila u verifikua nga GVJ edhe gjatë vizitës në Institucion.



Nëse tutori nuk është pjesë e personelit akademik të IAL, vihet në dispozicion edhe një udhëheqës akademik, anëtar i personelit akademik me së paku gradë shkencore Doktor.

Aktiviteti i mësimdhënies kryhet njëkohësisht me aktivitetin profesional, në përputhje me kërkesat e programit të studimit. Zhvillimi i aktivitetit mësimdhënës nga personeli i strukturave shëndetësore universitare realizohet me miratimin paraprak të drejtuesit të këtij shërbimi.

Evidenca 12, 26, 28, 30, 39, 51, 55, 55.1; Evidenca shitesë gjatë vizitës nr. 4.



<p>Udhëheqësi klinik/tutori ka një experiencë profesionale të paktën 10-vjeçare (dhjetëvjeçare) me përvojë klinike në fushën klinike përkatëse dhe ka të paktën gradën shkencare “Doktor”. Numri maksimal i studentëve specializantë që mund të ndiqet nga udhëheqësi akademik/klinik është 3 (tre).</p> <p>Udhëheqësi klinik/tutori është personel i punësuar me kohë të plotë pranë njëri nga strukturat e rrejtit formues dhe ka kontratë bashkëpunimi me IAL-në që ofron programin. Kur tutori nuk është pjesë e personelit me kohë të plotë të strukturës që ofron programin e specializimit, specializantit i caktohet edhe një udhëheqës akademik, anëtar i personelit akademik me kohë të plotë të institucionit. Për caktimin e udhëheqësit klinik merret vendimi i drejtuesit të strukturës shëndetësore dhe udhëheqja e tij klinike konsiderohet si pjesë e orarit të punës.</p> <p>Aktiviteti i mësimdhënies kryhet njëkohësisht me aktivitetin asistencial/profesional, në përputhje me kërkesat e programit të studimit. Zhvillimi i aktivitetit mësimdhënës në selinë ku realizohet programi i studimit nga personeli i strukturave shëndetësore universitare kërkon miratimin paraprak të drejtuesit të këtij shërbimi.</p>	
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Njësia përgjegjëse për këtë program studimi dëshmon se ka personelin e nevojshëm akademik, administrativ dhe mbështetës për zhvillimin e programit dhe realizimin e objektivave të tij, përfshirë këtu drejtuesin e programit, personelin akademik me kohë të plotë pjesë të UNIZKM, personelin akademik që ushtron profesionin në strukturat shëndetësore universitare dhe personelin akademik me kontratë, si dhe personelin e angazhuar nga universiteti partner.</i></p>






Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2

Institucioni garanton infrastrukturën dhe logjistikën e nevojshme në funksion të programit të specializimit afatgjatë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1: Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore. Këto mjedise duhet të jenë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet.</p>	<p>UNIZKM ushtron veprimtarinë e saj në një vendndodhje të përhershme, që prej hapjes së këtij institucioni, prej më shumë se 6 vitesh. IAL disponon gjashtë objekte me një sipërfaqe prej 61.460 metër katror, ku përfshihen ambiente administrative dhe mësimore.</p> <p>Sikurse u verifikua edhe nga vizita në Institucion, UNIZKM dëshmon se ka kapacitete infrastrukturore dhe teknologjike për të ofruar një program specializimi afatgjatë në “Sëmundje të Aparatit Kardiovaskular”, në përputhje edhe me kërkesat e standardeve në shtojcën 2.</p>
<p>Kriteri 2: Institucioni duhet të ketë kapacitete të mjaftueshme infrastrukturore dhe teknologjike. Ai disponon struktura administrative dhe klinike, të mjaftueshme për aktivitetet e parashikuara në programin e studimit specializues sipas standardeve specifike bashkëngjitur këtij dokumenti (Shtojca 2).</p>	<p>UNIZKM disponon klasa për leksione e seminare për të ofruar programin e studimit, projektorë powerpoint, laborator IT, bibliotekë fizike dhe elektronike.</p> <p>UNIZKM ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore të akredituara, për realizimin e aktiviteteve të ndryshme diganostikuese klinike, si: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Qendra Spitalore Universitare “Koço Gliozheni”, Spitali Amerikan, Spitali Gjerman, Spital Rajonal Durrës, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, si dhe me struktura spitalore italiane si: Ospedale M.G Figlie di San Camillo G. Vannini Roma, San Giuseppe Hospital Arezzo, Eurosanita’ Spa Policlinico Casilino, Casa Di Cura Luigi Cobellis, L’Azienda sanitaria Locale Cn2 di Alba-Bra, etj.</p>
<p>Kriteri 3: Institucioni disponon struktura shëndetësore të akredituara për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme klinike diagnostikuese, profesionale dhe didaktike. Akreditimi i këtyre strukturave bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.</p>	<p>UNIZKM ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore të akredituara, për realizimin e aktiviteteve të ndryshme diganostikuese klinike, si: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Qendra Spitalore Universitare “Koço Gliozheni”, Spitali Amerikan, Spitali Gjerman, Spital Rajonal Durrës, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, si dhe me struktura spitalore italiane si: Ospedale M.G Figlie di San Camillo G. Vannini Roma, San Giuseppe Hospital Arezzo, Eurosanita’ Spa Policlinico Casilino, Casa Di Cura Luigi Cobellis, L’Azienda sanitaria Locale Cn2 di Alba-Bra, etj.</p>
<p>Kriteri 4: Institucioni mund të organizojë programe të përbashkëta të studimeve specializuese afatgjata me një a më shumë institucione të tjera, të njohura/akredituara sipas legjislacionit në fuqi.</p>	<p>Gjithashtu, UNIZKM ka hapur së fundmi spitalin e tij, ku pavioni funksionon si pavion patologjie, nuk është i ndarë sipas specialiteteve. Gjithashtu spitali nuk është akredituar ende sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.</p> <p>Programi i studimit ofrohet në bashkëpunim me Universitetin e Romës “Tor Vergata”, i cili është i akredituar nga ministria dhe agjencia përgjegjëse në vendin e origjinës.</p>



	<i>Evidenca nr. 14, 23, RVB, Vizita në Institucion.</i>		
Konkluzione	<p><i>UNIZKM ushtron veprimtarinë e saj në një vendndodhje të përhershme, që prej hapjes së këtij institucioni, prej më shumë se 6 vitesh. IAL disponon gjashtë objekte me një sipërfaqe prej 61.460 metër katror, ku përfshihen ambiente administrative dhe mësimore.</i></p> <p><i>Sikurse u verifikua edhe nga vizita në Institucion, UNIZKM dëshmon se ka kapacitete infrastrukturore dhe teknologjike për të ofruar një program specializimi afatgjatë në “Sëmundje të Aparatit Kardiovaskular”.</i></p> <p><i>UNIZKM ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore të akredituara, për realizimin e aktiviteteve të ndryshme diganostikuese klinike.</i></p> <p><i>Në spitalin e ri të hapur së fundmi nga UNIZKM, pavioni funksionon si pavion patologjie, nuk është i ndarë sipas specialiteteve, si dhe nuk është akredituar ende sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi III.3	
Institucioni mund të ofrojë programe mësimdhënieje në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Institucioni, që ofron programe mësimdhënie në gjuhë të huaj, plotëson të njëjtat standarde të përcaktuara për IAL-të që ofrojnë programet e studimeve specializuese të fushës së mjekësisë në gjuhën shqipe.	<p>Institucioni plotëson të njëjtat standarde të përcaktuara për IAL-të që ofrojnë programet e studimeve specializuese të fushës së mjekësisë në gjuhën shqipe.</p> <p>Duke qenë se programi ofrohet në bashkëpunim me Universitetin e Romës “Tor Vergata” dhe një pjesë e pedagogëve që angazhohen janë pedagogë të universitetit partner, në këto raste nuk kërkohet një certifikatë e gjuhë italiane.</p>
Kriteri 2: Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj disponon një certifikatë për njohje të gjuhës së mësimdhënies të njohur ndërkombëtarisht, sipas kuadrit ligjor në fuqi.	<p><i>Evidenca 55; Vizita në Institucion.</i></p>
Konkluzione	<i>Institucioni ofron program studimi në gjuhë të huaj, duke plotësuar të njëjtat standarde të përcaktuara për IAL-të që ofron programe studimi specializimi në fushën e mjekësisë në gjuhën shqipe. Personeli është i kualifikuar në gjuhën e mësimdhënies.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi III.4 Strukturat e përfshira duhet të disponojnë standardet e përgjithshme dhe specifike të parashikuara.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1: Strukturat qendrore dhe dytësore disponojnë standarde të përgjithshme në përputhje me kapacitetin infrastrukturor, teknologjik, organizativ dhe asistencial sipas kriterëve të mëposhtme dhe sipas kriterëve specifike të parashikuara në shtojcën 2:</p> <p>a. Kapaciteti infrastrukturor: hapësira të mjaftueshme për ushtrimin e funksioneve të parashikuara;</p> <p>b. Kapaciteti teknologjik: pajisje të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të parashikuara;</p> <p>c. Kapaciteti organizativ: kompetenca të nevojshme profesionale;</p> <p>d. Kapaciteti asistencial: sasi dhe tipologji të caktuar të ndërhyrjeve klinike.</p>	<p>Sikurse përmendur edhe më lart, UNIZKM ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore të akredituara, për realizimin e aktiviteteve të ndryshme diganostikuese klinike, si: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Qendra Spitalore Universitare “Koço Gliozheni”, Spitali Amerikan, Spitali Gjerman, Spital Rajonal Durrës, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, si dhe me struktura spitalore italiane si: Ospedale M.G Figlie di San Camillo G. Vannini Roma, San Giuseppe Hospital Arezzo, Eurosanita’ Spa Policlinico Casilino, Casa Di Cura Luigi Cobellis, L’Azienda sanitaria Locale Cn2 di Alba-Bra, etj. Këto struktura disponojnë kapacitetet infrastrukturorë, teknologjike, organizative dhe asistencialë sipas kriterëve të parashikuara.</p> <p>UNIZKM disponon klasa e salla leksionesh e seminaresh, sekretari didaktike, bibliotekë fizike dhe elektronike, laborator informatike e laboratorë të tjerë, si dhe ambjent spitalor të hapur e vënë në funksion së fundmi. Të gjitha strukturat brenda universitetit janë të pajisura me rampa dhe ashensorë për personat me aftësi të kufizuar, si dhe ambjentet plotësojnë standardet e sigurisë dhe ato higjienike.</p>
<p>Kriteri 2: Të gjitha strukturat (psh. Auditorët, biblioteka, sekretaritë, etj.) Plotësojnë standardet e përgjithshme.</p>	<p>Gjatë vizitës në UNIZKM, u panë sallë leksioni/seminari, ambjentet e IAL, biblioteka, si dhe u vizitua spitali i ri i hapur së fundmi dhe të gjitha shërbimet e ofruara prej tij. Kabinetet mjekësore janë të pajisura me aparatet e nevojshme bashkëkohore për diagnostikimin dhe trajtimin e patologjive të ndryshme. <i>Spitali nuk ka pavion kardiologjie, por praktika klinike është siguruar në ambjentet e QSUT-së, Spitalit Amerikan dhe Spitalit Gjerman.</i></p>
<p>Kriteri 3: Struktura bazë është e pajisur me ambientet/pajisjet e nevojshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • sekretari didaktike • bibliotekë shkencore të pasur me botime dhe në formë elektronike • Infrastrukturë të plotë të IT-së. • laboratorë kërkimorë dhe didaktikë (nëse parashikohen në shtojcën nr.2) 	<p><i>Evidenca nr. 12, 14, 23, 59, 60, RVB, Vizita në Institucion.</i></p>

<ul style="list-style-type: none"> • ambulatorë dhe struktura asistencialë (me pajisjet e nevojshme teknologjike sipas specialitetit) • ambjente spitalore me shtretër (në rastet kur janë parashikuar në standardet specifike të specialitetit në shtojcën 2) <p>Ambjentet më sipër duhet të sigurojnë standardet e sigurisë dhe ato higjienike dhe nuk kanë barriera arkitektonike që pengojnë aksesin në veprimtaritë e ndryshme të parashikuara nga programi i studimit.</p>	
<p>Kriteri 4: Çdo program specifik i specializimit plotëson standardet specifike sipas tipologjisë së specializimit (psh. laboratorë specifikë, shërbime, shtrime spitalore, etj.) sipas shtojcës 2. Standardet specifike ndahen në:</p> <p>a. bazë: standarde që duhet domosdoshmërisht të përmbushen si nga struktura bazë dhe nga strukturat dytësore/satelite.</p> <p>b. dytësore: standarde që, për të plotësuar kriteret e akreditimit të strukturës, duhet të plotësohen si nga struktura qendrore edhe nga ajo dytësore ose nga strukturat të tjera të IAL-së sipas një përqindjeje të caktuar të parashikuar për akreditimin. Nëse nuk plotësohen as nga struktura bazë e as nga ajo dytësore duhet të plotësohen nga strukturat komplementare me të cilat ka një marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>c. shërbime të përgjithshme: janë shërbimet operative që duhet të ketë struktura në të cilën bën pjesë struktura qendrore ose ajo dytësore që do të akreditohen.</p>	<p>Programi i specializimit plotëson standardet bazë, dytësore dhe të përgjithshme të shërbimeve specifike për këtë program studimi. Me standarde bazë nënkuptohen numri i shtretërve, spitali ditor, klinikat ambulatorë, shërbimi i terapisë intensive koronare, hemodinamika dhe elektrofiziologjia. Strukturat me të cilat kanë marrëveshje përmbushin standardet bazë. Në funksionon në ambjentet e Spitalit të UNIZKM, janë terapia intensive koronare, hemodinamika dhe elektrofiziologjia.</p> <p>Me standarde dytësore nënkuptohen laboratorët e ekokardiografisë, laboratorët për ekzaminimet kardiace jo invazive dhe rehabilitimi kardiak. Me strukturat me të cilat janë lidhur marrëveshjet plotësohen standardet dytësore.</p> <p>Me shërbime të përgjithshme dhe diagnostike nënkuptohen imazheria diagnostike, laborator i mjekësor diagnostik, anatominë patologjike, ndihmën e parë. Plotësohen standardet e shërbimeve të përgjithshme. <i>Sikurse përmendur edhe më lart, UNIZKM si spital universitar i sapohapur nuk është ende i akredituar.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 14, 23, RVB, Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 5: Institucioni që ofron programet specializuese garanton se ka kapacitete të mjaftueshme në personel shëndetësor, ndihmës dhe administrativ në strukturat qendrore</p>	<p>Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga UNIZKM dëshmohet se Institucioni ka kapacitete të mjaftueshme në personel shëndetësor, ndihmës dhe administrativ në strukturat qendrore dhe dytësore për të mbuluar nevojat e këtij specialiteti.</p>

dhe dytësore për të mbuluar nevojat e specialiteteve të ofruara, në bazë të kapaciteteve.	<i>Evidenca nr. 14, 23, RVB, Vizita në Institucion.</i>		
Kriteri 6: Institucioni që ofron programet specializuese është i mirëorganizuar dhe disponon dokumentacion që tregon mënyrën e organizimit dhe strukturën drejtuese si dhe personelin administrativ dhe akademik me titujt përkatës si dhe rolet e parashikuara për secilin.	UNIZKM është një Institucion i mirëorganizuar dhe ka një strukturë organizative të përcaktuar, të përbërë nga struktura drejtuese, akademike e administrative si: Senati Akademik, Rektori, Administratori, njësitë kryesore, njësitë bazë, personeli akademik me titujt përkatës, etj. <i>Evidenca nr. 14, 23, RVB, Vizita në Institucion.</i>		
Konkluzione	<i>UNIZKM dhe strukturat shëndetësore me të cilat bashkëpunon për ofrimin e programit të studimit përmbushin standardet bazë, dytësore dhe të përgjithshme të shërbimeve për programin, strukturën e duhur organizative dhe administrative dhe kapacitetet infrastrukturore, teknologjike dhe asistente. Kabinetet mjekësore në Spitalin e UNIZKM janë të pajisura me aparatet e nevojshme bashkëkohore për diagnostikimin dhe trajtimin e patologjive të ndryshme. Spitali nuk ka pavion kardiologjie, por praktika klinike është siguruar në ambjentet e QSUT-së, Spitalit Amerikan dhe Spitalit Gjerman. UNIZKM si spitali universitar i sapohapur nuk është ende i akredituar.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi III.5

Rrjeti formues plotëson kriteret minimale të parashikuara dhe është i përshtatshëm për të ofruar programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1: Institucioni plotëson kërkesat minimale të përgjithshme të parashikuara në këtë dokument përsa i përket rrjetit formues.</p> <p>Kriteri 2: Institucioni duhet të plotësojë kërkesat minimale specifike për çdo specialitet të parashikuara në shtojcën 2 të këtij dokumenti përsa i përket rrjetit formues.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet nga një rrjet institucionesh, të cilat ofrojnë aktivitete teorike dhe praktike. Programi i studimit ofrohet nga UNIZKM në bashkëpunim me Universitetin e Romës "Tor Vergata". UNIZKM ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore të akredituara, për realizimin e aktiviteteve të ndryshme diganostikuese klinike, si: Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Qendra Spitalore Universitare "Koço Gliozheni", Spitali Amerikan, Spitali Gjerman, Spital Rajonal Durrës, Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi", si dhe me struktura spitalore italiane si: Ospedale M.G Figlie di San Camillo G. Vannini Roma, San Giuseppe Hospital</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



51




	<p>Arezzo, Eurosanita' Spa Policlinico Casilino, Casa Di Cura Luigi Cobellis, L'Azienda sanitaria Locale Cn2 di Alba-Bra, etj.</p> <p>Dy prej strukturave shëndetësore nuk i plotësojnë të gjitha kriteret e parashikuara, jo të gjitha janë qendra spitalore.</p> <p><i>Evidenca nr. 14, 23, Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 3: Kërkesat e përgjithshme dhe specifike janë të organizuara sipas kriterëve të mëposhtme:</p> <p>a. Përshtatshmëria e strukturave dhe pajisjeve, me shërbimet përkatëse të përgjithshme dhe diagnostikuese dhe ekzistencën në to të specialiteteve të ngjashme</p> <p>b. Ekzistenca e numrit dhe procedurave praktike të mjaftueshme për një formim të plotë profesional</p> <p>c. Burime financiare të mjaftueshme</p> <p>d. Tutorë dhe pedagogë të përshtatshëm dhe ekspertë</p> <p>e. Strukturë organizative e përshtatshme, me kapacitetet e nevojshme profesionale</p> <p>f. Programim i aktiviteteve orientuese, analizuese sipas kërkesave të tregut dhe përcaktimi i një programi formues</p> <p>g. Seleksionimi dhe vlerësimi i studentëve</p> <p>h. Efikasiteti dhe eficaenca në aktivitetet e ndryshme të parashikuara.</p>	<p>Programi i studimit realizohet pranë strukturave të rrjetit formues, në përputhje me programin përkatës të specializimit, procedurat përkatëse dhe nën mbikëqyrjen e personave dhe autoritetit përgjegjës.</p> <p>Rrjeti i trajnimit për programin afatgjatë të specializimit në “Sëmundje të aparatit kardiovaskular” plotëson kërkesat e përgjithshme dhe specifike të organizuara si në vijim:</p> <p>a. Disponojnë pajisjet dhe strukturën e duhur përkatëse për mësimdhënien dhe aktivitetet klinike në fushën specifike të programit të studimit;</p> <p>b. Realizojnë një numër procedurash praktike të mjaftueshme për një formim të plotë profesional;</p> <p>c. Disponojnë burime të mjaftueshme financiare për të mbështetur dhe ofruar aktivitete klinike;</p> <p>d. Vënë në dispozicion personelin e përshtatshëm me kualifikimin dhe eksperiencën profesionale të nevojshme për programin e studimit;</p> <p>e. Disponojnë një strukturë organizative të përshtatshme, me kapacitetet e nevojshme profesionale;</p> <p>f. Është realizuar një studim tregu për analizimin e nevojave të tregut të punës për mjekë specialistë të sëmundjeve të aparatit kardiovaskular dhe reflektimi i gjetjeve në program;</p> <p>g. Parashikimi dhe ndjekja e procedurave të bazuara në legjislacionin në fuqi për seleksionimin dhe vlerësimin e studentëve;</p> <p>h. Realizimi i aktiviteteve të parashikuara me efikasitet.</p> <p><i>Evidenca nr. 14, 23, Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 4: Institucioni disponon dokumentacion që provon përbërjen e rrjetit formues dhe të gjitha strukturave të përfshira në formimin specializues (qendrore/bazë).</p> <p>Kriteri 5: Strukturat qendrore dhe dytësore të përfshira në formimin specializues duhet të jenë të</p>	<p>UNIZKM disponon dokumentacion provues idhur me bashkëpunimin e tij me strukturat e anëtarët e tjerë të rrjetit formues.</p> <p>Strukturat qendrore dhe dytësore me të cilat UNIZKM ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, të përfshira në formimin specializues, janë të akredituara sipas legjislacionit në fuqi.</p>

akredituara sipas legjislacionit ne fuqi.	UNIZKM ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me struktura pjesë të rrjetit të formimit, në të cilat parashikohet disponueshmëria e kapaciteteve të tyre klinike dhe infrastrukture për programin e studimit.		
Kriteri 6: Institucioni duhet të disponojë dokumentacion që sqaron ekzistencën e shërbimeve të përgjithshme dhe diagnostikuese të përfshira në formimin e specializantëve. Shërbimet e përgjithshme dhe diagnostikuese të pranishme në strukturat shëndetësore pjesë e rrjetit formues nuk mund të jenë të ndryshme apo inferiore nga ato të parashikuara në shtojcën 2 për akreditimin e strukturave.	Strukturat shëndetësore pjesë të rrjetit formues disponojnë specialitete të ngjashme, shërbime të përgjithshme dhe diagnostikuese të përfshira në formimin e specializantëve në këtë program studimi. <i>Sikurse përmendur edhe më lart, dy prej strukturave shëndetësore nuk i plotësojnë të gjitha kriteret e parashikuara, jo të gjitha janë qendra spitalore.</i>		
Kriteri 7: Institucioni disponon dokumentacion që sqaron ekzistencën e specialiteteve të ngjashme në strukturat shëndetësore pjesë të rrjetit formues, shërbimeve të përgjithshme dhe diagnostikuese të përfshira në formimin e specializantëve (sipas shtojcës 2).	UNIZKM disponon raportime për çdo student të programit të studimit lidhur me shërbimet mjekësore që ofron për formimin profesional të tyre. UNIZKM disponon dokumentacion provues mbi aktivitetin asistencial vjetor të studentëve specializantë në strukturat shëndetësore të rrjetit formues, i cili nuk kalon 30% të aktivitetit total që kryejnë këto struktura.		
Kriteri 8: Institucioni disponon dokumentacion që sqaron numrin e shërbimeve mjekësore që ofron për ushtrimin profesional të specializantëve (sipas shtojcës 2).	<i>Evidenca nr. 14, 23, RVB, Vizita në Institucion.</i>		
Kriteri 9: Institucioni duhet të disponojë dokumentacion që sqaron aktivitetin asistencial vjetor të strukturave të përfshira në rrjetin formues. Aktiviteti asistencial vjetor që kryhet nga specializantët në kuadër të formimit të tyre nuk mund të jetë më i madh se 30% e aktivitetit asistencial total që kryejnë strukturat e përfshira në rrjetin formues (sipas shtojcës 2).			
Konkluzione	<i>Strukturat shëndetësore pjesë të rrjetit formues disponojnë specialitete të ngjashme, shërbime të përgjithshme dhe diagnostikuese të përfshira në formimin e specializantëve në këtë program studimi. Sikurse përmendur edhe më lart, dy prej strukturave shëndetësore nuk i plotësojnë të gjitha kriteret e parashikuara, jo të gjitha janë qendra spitalore.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

			X	
--	--	--	---	--



Standardi III.6	
Njësia përgjegjëse për programin e specializimit afatgjatë dëshmon qëndrueshmëri financiare dhe siguron mjetet e duhura të financimit dhe mbështetjes së studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Institucioni nëpërmjet raporteve dhe auditeve financiare dëshmon ecuri pozitive dhe qëndrueshmëri në gjenerimin dhe përdorimin e të ardhurave financiare.	Sipas deklarimeve në RVB, UNIZKM përgatit raporte vjetore financiare të cilat paraqesin të dhëna mbi ecurinë dhe gjendjen e të ardhurave financiare. Megjithatë, GVJ nuk disponon ndonjë dokument për raportimet financiare apo audituese.
Kriteri 2: Njësia përgjegjëse siguron nëpërmjet institucionit, projekteve ose financimeve nga subjekte të tjera fondet e nevojshme për zhvillimin e programeve të specializimeve.	Gjenerimi i të ardhurave të IAL bazohet në të ardhurat e Fondacionit UNIZKM, tarifat e regjistrimit, të ardhurat nga aktiviteti i tij, veprimtaritë kërkimore-shkencore etj., ndërkohë që shpenzimet kryesore shkojnë për shpenzime personeli, shpenzime operative, transferata ndërkombëtare, investime, kërkim shkencor, etj.
Kriteri 3: Programi i studimeve të specializimit afatgjatë mbështetet nga një buxhet i mjaftueshëm i njësisë përgjegjëse.	Njësia bazë përgjegjëse siguron fondet e nevojshme për zhvillimin e programeve të specializimeve, edhe prej pjesëmarrje në projekte.
Kriteri 4: Struktura e shpërndarjes së buxhetit financiar të programit të studimeve të specializimeve përputhet me politikën dhe zhvillimin e institucionit.	Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga IAL, në rang Departamenti/Fakulteti janë fituar 17 projekte kërkimore, janë zbatuar 10 projekte, si dhe 25 anëtarë të personelit akademik kanë marrë si partnerë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.
Kriteri 5: Përdorimi i mjeteve financiare të alokuara për zhvillimin e programit të specializimit është objekt i raportimit dhe auditimit të vazhdueshëm.	Programi i studimit mbështetet me një buxhet të përshtatshëm për realizimin e aktiviteteve mësimore dhe klinike. Në marrëveshjet e bashkëpunimit që UNIZKM ka nënshkruar parashikohet që ajo është përgjegjëse për koston financiare të të gjitha aktiviteteve klinike që kryhen në këto struktura nga studentët. Sipas deklarimeve të UNIZKM, të ardhurat e alokuara për zhvillimin e programit të studimit janë objekt i raportimit dhe auditimit të vazhdueshëm. Sipas IAL, Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë, pjesë e së cilës është UNIZKM, depoziton çdo vit pranë Drejtorisë Tatimore, Bilancin Vjetor sipas legjislacionit shqiptar, i cili tregon performancë financiare pozitive dhe të qëndrueshme dhe institucioni ka raporte vjetore auditimi që mbulon fushat e veprimtarisë së tij, por GVJ nuk disponon ndonjë dokument për të provuar këtë deklaram.

	<i>Evidenca nr. 16, Vizita në Institucion.</i>		
Konkluzione	<i>UNIZKM ka dëshmuar një qëndrueshmëri financiare ndër vite. GVJ nuk disponon ndonjë dokument provues mbi raportimet financiare të realizuara nga UNIZKM dhe auditimet e vazhdueshme.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	



IV. KËRKIMI DHE EKSPERIENCA KLINIKE /DIAGNOSTIKUESE

Standardi IV.1	
Specializanti ka një tutor që e ndjek atë gjatë gjithë periudhës së specializimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Studenti ka një udhëheqës klinik (tutor) të diplomuar dhe specializuar në fushën e programit të studimit të aplikantit i cili ka një eksperiencë të paktën 10 (dhjetë) vjeçare në fushën klinike diagnostike me gradën "Doktor".	UNIZKM për realizimin e Programin Aftagjatë të specializimit për çdo student ka siguruar një tutor (udhëheqës klinik) që e ndjek atë gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe është përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit si dhe për monitorimin e punës së tij. Tutori ka një eksperiencë profesionale me përvojë klinike në fushën klinike përkatëse që përputhet me atë të programit të specializimit. Tutori zgjidhet në bazë të kriterëve të parashikuara në Rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata, respektivisht 10 (dhjetë) vjet përvojë pune në fushën përkatëse klinike që përputhet me Programin e specializimit afatgjatë. <i>Evidenca nr. 12, 25; Evidenca shitesë gjatë vizitës nr. 4.</i>
Kriteri 2: Njësia bazë përgjegjëse/shërbimi përgjegjës përzgjedh udhëheqësit klinikë, të aftë për të drejtuar punën klinike e kërkimore të specialistëve, mbështetur në vlerësimin e veprimtarive klinike e kërkimore botuese të tyre, brenda e jashtë vendit.	Tutori është përgjegjës për zbatimin e programit të specializimit të specialistëve që ndjek në të gjitha strukturat e rrjetit formues; njëkohësisht merret me organizimin dhe ndjekjen nga afër të realizimit të programit specializues duke ndjek praktikat klinike në përputhje me programin mësimor të specializimit të parashikuar në Rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata.


	<i>Evidenca nr. 12, 25; Evidenca shitesë gjatë vizitës nr. 4.</i>
Kriteri 3: Tutori është i punësuar me kohë të plotë pranë njëres nga strukturat e rrejtit formues dhe ka një kontratë bashkëpunimi me institucionin që ofron programin specializues.	Tutori është i punësuar me kohë të plotë pranë njëres nga strukturat e rrejtit formues dhe ka një kontratë bashkëpunimi me institucionin që ofron këtë program specializues. Kur tutori nuk është pjesë e personelit akademik të institucionit që ofron programin e specializimit, studenti ka në dispozicion një udhëheqës akademik anëtar i personelit akademik që ka gradën shkencore “Doktor i shkencave” (PhD) të fituar në institucione prestigjioze të botës, në fushën që kërkojnë kriteret e programit të specializimit. <i>Evidenca nr. 12, 25; Evidenca shitesë gjatë vizitës nr. 4.</i>
Kriteri 4: Udhëheqësit klinikë punojnë për përditësimin e njohurive dhe aftësive të tyre, mbështetur në marrëveshjet institucionale, me qëllim mundësimin e shkëmbimeve të praktikave më të mira dhe dhënien e këshillave në mbështetjen efektive të studentëve.	Tutorët klinikë të zgjedhur nga personeli i institucionit përgjegjës të specializimit edhe ata të zgjedhur nga institucionet partnere të rrejtit, i plotësojnë kërkesat e përcaktuara ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe kriteret e përcaktuara në Rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata. UNIZKM nënshkruan marrëveshje të veçanta me tutorët ku përcaktohen obligimet dhe përgjegjësitë e tutorit ndaj specializantëve në realizimin e programit të studimit. <i>Evidenca nr. 12, 25; Evidenca shitesë gjatë vizitës nr. 4.</i>
Kriteri 5: Udhëheqësi klinik ka ekspertizën, formimin dhe udhëzimet e duhura për rolin e tij në udhëheqjen e specializantit në realizimin e studimeve specializuese dhe në veçanti të pjesës praktike/ klinike.	Tutori në rolin e udhëheqësit klinik udhëheq specializantët në përvetësimin e procedurave teknike dhe praktike të specializantit, nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë të tij në të gjitha etapat e diagnozës dhe trajtimit të pacientëve. Tutori, në përfundim të çdo viti të specializimit, nënshkruan librezën e specializantit dhe bën vlerësimin e specializantit në bazë të aftësisë për të kryer me sukses procedurat teknike të praktikës mjekësore që kërkojnë në bazë të Rregullores së programit të studimit të specializimit. Tutori nëpërmjet shembullit profesional përcjell tek specializantët parime të shëndosha etike dhe të komunikimit me pacientë, me të afërmit e tyre dhe me kolegët, bazuar në parimet etike mjekësore. <i>Evidenca nr. 12, 25; Evidenca shitesë gjatë vizitës nr. 4.</i>
Kriteri 6: Udhëheqësi klinik nuk mund të mbikëqyrë më shumë se 3 (tre) studentë njëkohësisht.	UNIZKM me Rregullore ka siguruar që numri maksimal i studentëve specializantë që mund të ndiqen nga një tutor është 3 (tre) specializantë që mund të punojnë me kohë të plotë pranë

	<p>njërës nga strukturat e rrjetit formues me të cilën kanë kontratë bashkëpunimi</p> <p><i>Evidenca nr. 12, 25; Evidenca shitesë gjatë vizitës nr. 4.</i></p>
<p>Kriteri 7: Fusha e specializimit të udhëheqësit përputhet me atë të programit specializues që ndjek specializanti.</p>	<p>Tutorët klinik që plotësojnë kushtet për këtë përgjegjësi zgjidhen nga Këshilli Drejtues i programit të specializimit mbi bazën e medimit pozitiv nga ana e Departamentit të referencës dhe Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë. Fusha e specializimit të tutorit përputhet me atë të programit specializues që ndjek specializanti. Institucioni që ofron programin e specializimit, UNIZKM dhe Tor Vergata, me tutorët e përzgjedhur, nënshkruan Kontratë individuale për detyrat dhe obligimet e tutorit në relizimin e programit të specializimit.</p> <p><i>Evidenca nr. 12, 25; Evidenca shitesë gjatë vizitës nr. 4; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 8: Në të gjitha rastet, studenti ka vetëm një pikë të identifikuar kontakti, i cili duhet të jetë udhëheqësi klinik kryesor i tij. Nëse udhëheqësi kryesor nuk është në dispozicion, studentit i bëhet e ditur se cili do të jetë personi që do ta zëvendësojë.</p>	<p>UNIZKM ka siguruar që kur tutori nuk është pjesë e personelit akademik të institucionit që ofron programin e specializimit, studentit i vihet në dispozicion një udhëheqës akademik i institucionit që ka së paku gradën shkencore “Doktor” apo “PhD”, të fituar në universitete të mirënjohura, në fushën në të cilën vazhdon specializanti. Nëse udhëheqësi nuk është në dispozicion, studentit i bëhet e ditur se cili do ta zëvendësojë atë.</p> <p><i>Evidenca nr. 12, 25; Evidenca shitesë gjatë vizitës nr. 4.</i></p>
<p>Kriteri 9: Institucioni siguron që udhëheqësi të ketë kohën e mjaftueshme për ta mbikëqyrur specializantin.</p>	<p>Institucioni parashih kohën e duhur për të realizuar mbikëqyrjen e specializantit. Për tutorët nga institucionet e rrjetit jashtë institucionit ofruet të specializimit në kontratën e angazhimit duhet siguruar koha e duhur për angazhimit të tyre gjatë kohës të specializimit.</p> <p>Kontrata e bashkëpunimit me njësinë që ofron programin specializues duhet të jetë jo më pak se sa kohëzgjatja e programit specializues.</p> <p><i>Evidenca nr. 11, 12, 14.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UNIZKM për realizimin e programin aftagjatë të specializimit për çdo student ka siguruar një tutor (udhëheqës klinik) që e ndjek atë gjatë periudhës së specializimit dhe është përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit si dhe për</i></p>






	<p>monitorimin e punës së tij. Tutori është personi kyç përgjegjës për realizimin e pjesës praktike të programit të specializimit.</p> <p>Përshkrimi i detajuar i obligimeve të tij në kontratën e tij dhe Institucionit ofruar të specializimit, komunikimi dhe informimi i tij me rrjedhën e specializimit e bën përmbyshjen e programit në shkallën e duhur gjë që ai e konfirmon me nënshkrimin e tij në Librezën e specializantit për çdo vit.</p>		
Shkalla e përmbyshjes së standardit	Nuk përmbyshet	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
			X

Standardi IV.2	
Objektiva të programit të studimit të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë janë angazhimi i vazhdueshëm në punën klinike e kërkimore dhe nxitja e punës në ekip e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1: Studenti angazhohet në punën klinike e kërkimore për aftësimin dhe përfundimin me sukses të programit të studimit.</p>	<p>Angazhimi i vazhdueshëm në punën klinike e kërkimore - shkencore dhe nxitja e punës në ekip i studentëve janë objektivat kryesore të programit të studimit të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë.</p>
<p>Kriteri 2: Studenti merr pjesë në aktivitete të ndryshme klinike të lidhura ngushtë me fushën specifike në të cilën ndjek studimet e specializimeve, të cilat e ndihmojnë të aftësohet për:</p> <p>a. Përvetësimin e metodologjive dhe njohurive klinike e kërkimore për veprimtari krijuese të pavarura si: artikuj shkencorë, prezantime, etj;</p> <p>b. Punën e pavarur në laborator/klinikë;</p> <p>c. Përdorimin e burimeve të informacionit (p.sh. bibliotekat dhe internetin, databazat me karakter shkencor/klinik) dhe administrimin e informacionit;</p> <p>d. Përdorimin e teknologjive bashkëkohore për prezantime publike;</p> <p>e. Përvetësimin e metodave të avancuara të analizës dhe përpunimit të të dhënave;</p> <p>f. Njohjen dhe përvetësimin e terminologjisë së specializuar lidhur me fushën klinike të specializantit.</p>	<p>Specializanti merr njohuri teorike, shprehi praktike si edhe elementët e nevojshëm etikë dhe profesionalë.</p> <p>Specializanti njihet që në fillim të specializimit me programin teorik dhe praktik përkatës dhe është i detyruar të marrë pjesë në realizimin e tërësishëm të programit.</p> <p>Realizimi i aktiviteteve të specializantit shënohet në dosjen e tij nga ana e tutorit përgjegjës që përcillet në mjediset e Shërbimit univertitar përkatës si miratim që studenti specializant është përgatitur dhe i udhëzuar që të kryejë me sukses procedurat teknike të praktikës mjekësore (ekzaminime, procedura terapeutike dhe të marrë pjesë aktive në procedurat intrevante, etj.) nën mbikqyrje të drejtëpërdrejtë dhe si i pavarur.</p> <p>Sikurse parashikuar edhe në rregulloren e specializimit, specializanti duhet të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme klinike të lidhura ngushtë me fushën specifike, të cilat e ndihmojnë të aftësohet për:</p> <p>- përvetësimin e metodologjive dhe njohurive klinike e kërkimore për veprimtari krijuese të pavarura si: artikuj shkencorë, prezantime rastesh klinike, etj.;</p>





	<p>- punën e pavarur në laborator/klinikë/sallë operatore; - përdorimin e burimeve bashkëkohore të informacionit dhe administrimin e informacionit; - përdorimin e teknologjive bashkëkohore për prezantime shkencore; - përvetësimin e metodave të avancuara të analizës dhe përpunimit të të dhënave; - njohjen dhe përvetësimin e terminologjisë së specializuar lidhur me fushën klinike të specializimit.</p> <p><i>Evidenca nr. 12.</i></p>
<p>Kriteri 3: Studenti i programit specializues merr pjesë në aktivitetet e parashikuara të programit të studimit jashtë punës së tyre klinike. Specializanti është i lirë të marrë pjesë si dëgjues apo si referues në:</p> <p>a. Ligjërata; b. Seminare; c. Debate ndërdisiplinore, të organizuara në kuadër të programit të studimit të specializimeve; d. Mundësi të tjera të të mësuarit si: ndjekja e prezantimeve të konferencave dhe seminareve të ndryshme me karakter klinik.</p> <p>Udhëheqësit i këshillojnë studentët të marrin pjesë në aktivitete dhe konferenca shkencore që i ndihmojnë në punën e tyre dhe klinike.</p>	<p>Specializanti është i lirë të marrë pjesë si dëgjues apo si referues në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Leksione • Seminare • Debate ndërdisiplinore dhe mundësi të tjera të të mësuarit, prezentim në konferenca, seminare në kuadër të programit të specializimit. <p>Për studentët të pranuar në programin e studimeve specializuese afatgjata institucioni ka krijuar kushtet e nevojshme për të realizuar planin e studimit me karakter akademik e klinik.</p> <p>Gjatë gjithë procesit të trajnimit dhe kryerjes së detyrave të tij profesionale, specializanti duhet të ketë sjellje korrekte etike dhe profesionale me pacientët, pedagogët dhe kolegët, në përputhje me rregullat e etikës mjekësore, duke fituar dhe përparuar aftësitë e tij për komunikim korrekt me pacientët, anëtarët e familjes së tyre dhe me kolegët.</p> <p><i>Evidenca nr. 12.</i></p>
<p>Kriteri 4: Studenti para diplomimit të tij, duhet të ketë botuar ose të pranuar të paktën një artikull kërkimor shkencor/ eksperimental në një revistë shkencore brenda ose jashtë vendit, ku garantohet që niveli i ngjashmërisë artikullit të jetë nën 30%. Po ashtu ai duhet të ketë marrë pjesë në jo më pak se 2 aktivitete shkencore kombëtare dhe/ose</p>	<p>Programi i specializimit parasheh mundësi infrastrukturore dhe mbështetje akademike dhe shkencore nga udhëheqësit e programit të specializimit për punë kërkimore shkencore/ekperimentale të specializantit, nga fusha e kardiologjisë që duhet të botohet si artikull shkencor në revista shkencore në vend dhe jashtë vendit. Përgjegjësi i programit respektivisht Udhëheqësi akademik, udhëzon dhe mban evidencën për pjesëmarrjen e specializantit në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e specializimit.</p>





ndërkombëtare në fushën përkatëse të specializimit.	<i>Evidenca nr. 12.</i>		
Kriteri 5: Studenti fiton aftësi ¹ për komunikimin e duhur me nivel profesional.	Komunikimi interpersonal, ndërkolegial dhe mjek-pacient sigurohet nëpërmjet kultivimit të përditshëm të raporteve dhe në seminare dhe konferencat e parashikuara në kuadër të syllabusit të programit. <i>Evidenca nr. 12, 29.</i>		
Kriteri 6: Studenti ndjek rregullat e sjelljes etike dhe profesionale me pacientët dhe kolegët dhe fiton aftësi për komunikim korrekt me të tjerët.	UNIZKM me anë të Rregullores ka parashikuar masat përkatëse në rast të shkeljeve disiplinore, të cilave i nënshtrohet edhe specializanti. Kodi i sjelljes për specializantët si për të gjithë ofruesit e tjerë të kujdesit shëndetësor në UNIZKM i nënshtrohen edhe masave disiplinore të parashikuara nga ana e Urdhrit të Mjekit dhe organet e tjera kompetente. <i>Evidenca nr. 12.</i>		
Konkluzione	<i>UNIZKM në programin e studimit të specializimit afatgjatë në fushën e sëmundjeve kardiovaskulare ka parashikuar metodologji, aktivitete dhe përkujdesje për realizim të vazhdueshëm në punën klinike dhe kërkimore shkencore, në krijimin e një ambienti bashkëpunues dhe kolegial duke kultivuar njohuritë etike dhe aftësi komunikuese me kolegët dhe pacientët e anëtarët e familjes së tyre mbi parimet etike. Në rast cënimi të këtyre parimeve janë parashikuar masa disiplinore të parashikuara nga organet përkatëse të Universitetit dhe organe tjera profesionale jashtë universitetit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardeve		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X



¹ Aftësitë e komunikimit të studentit përfshijnë: kompetencën për të përshkruar në mënyrë të qartë rastet klinike; përdorimin e argumenteve bindëse dhe artikullimin e qartë të ideve para pacientit dhe kolegeve; zotësinë për të debatuar dhe mbështetur të tjerët, të përfshirë, në klinikë, mbikqyrje ose demonstrime.



60




V. STUDENTËT

Standardi V.1	
Studenti që ka përfunduar një program të integruar të studimeve në fushat e mjekësisë, farmacistë, stomatologjisë, plotëson standardet akademike të kriterëve të pranimit të institucionit respektiv dhe gëzon të drejtën për t'u regjistruar në programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1: Aplikanti që kërkon të pranohet në programin e studimeve specializues i nënshtrohet provimit të pranimit në programin e studimit specializues për të cilin ka aplikuar.</p>	<p>UNIZKM, për pranimin e kandidatëve për specializimin afatgjatë në Sëmundje të aparatit kardiovaskular, ka siguruar procedurë transparente për pranimin e tyre. Procedura parashikon kriteret përkatëse që janë të përcaktuara në rregullore dhe në thirrjen për aplikime për programin e specializimit.</p> <p>Kandidatët me dokumentacionin e plotë të kërkuar i nënshtrohen testit të pranimit për të cilin kanë aplikuar duke plotësuar formularin dhe bashkëlidhur dokumentacionin e nevojshëm.</p> <p>Vlerësimi i kandidatit dhe përzgjedhja e tyre bëhet nëpërmjet një sistemi vlerësimi të përbërë nga 100 pikë, ku 30 pikë i ka testi me shkrim mbi njohuritë e përgjithshme të lëndës, 40 pikë i ka testi me shkrim mbi njohuritë specifike të programit, 20 pika ka nota mesatare e ponderuar dhe 10 pikë i ka intervista me gojë.</p> <p><i>Evidenca nr. 12, 34.</i></p>
<p>Kriteri 2: Institucioni disponon një model teorik të informatizuar për përcaktimin e njohurive, kapacitetit, aftësive të aplikantëve në këndvështrime të ndryshme (operativ, konjitiv e relacionues).</p>	<p>UNIZKM promovon dhe informon të gjithë të interesuarit për programet e specializimit aktive nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njoftimit të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Universitetit: <p>www.unizkm.alhttps://www.unizkm .al/study/course/programma-di-specializzazione-a-lungo-termine-dellarea-medica;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Postimeve publikuar në rrjetet sociale të Universitetit (Facebook dhe Instagram) që promovojnë çdo program studimi.
<p>Kriteri 3: Institucioni shpall paraprakisht programin e parashikuar për provimin e pranimit dhe instrumentat që përdor për përcaktimin e njohurive, kapacitetit, aftësive të aplikantëve në këndvështrime të ndryshme.</p>	<p>Institucioni përgjegjës i programit të specializimit ndjek dhe shpall procedurat të qarta, të përcaktuara dhe të bëra të ditura që në fillim të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca nr. 12.</i></p>
<p>Kriteri 4: Institucioni vlerëson në mënyrë të vazhdueshme politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>UNIZKM si përgjegjës i programit të specializimit ndjek dhe vlerëson politikat e pranimit nëpërmjet rrjetit të të diplomuarve, përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe duke u komunikuar me alumni, respektivisht të diplomuarit e programit të specializimit.</p>

	RVB.		
Konkluzione	<p>UNIZKM, për pranimin e kandidatëve për specializimin afatgjatë, ka siguruar procedurë transparente për pranimin e tyre. Procedura parashikon kriteret përkatëse që janë të përcaktuara në Rregullore dhe në thirrjen për aplikime për programin e specializimit.</p> <p>UNIZKM si përgjegjës i programit të specializimit ndjek dhe vlerëson politikikat e pranimit nëpërmjet rrjetit të të diplomuarve, përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2	
Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin dhe të dhënat e studentëve që ndjekin programet e studimit specializuese afatgjata.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1: Institucioni ka një pasqyrë të përvitshme për numrin e të diplomuarve, në programet specializuese afatgjata, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik.</p>	<p>UNIZKM disponon të dhënat përkatëse në lidhje me numrin e specializantëve ndër vite që prej hapjes së programit të studimit, përfshirë numrin e studentëve të cilët janë çregjistruar dhe që kanë përfunduar studimet, të cilat u panë edhe gjatë vizitës në Institucion. Sekretaria Mësimore dhe Zyra e Statistikave janë dy zyrat që disponojnë informacionet për numrin vjetor të studentëve specializantë si dhe për tërheqjen nga studimet.</p> <p><i>Evidenca nr. 57; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 2: Institucioni zotëron të dhëna individuale për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi (notat e mëparshme p.sh. vlerësimin e studentëve në programin e mëparshëm të studimit, etj.).</p>	<p>Sekretaria Mësimore disponon të dhëna individuale për ecurinë akademike të kandidatëve që nga momenti i pranimit, ku bashkë me aplikimin për pjesëmarrje në konkurs paraqesin edhe një serë dokumentash si: Diplomën dhe listën e notave për secilën lëndë; Licensën për ushtrimin e profesionit të Kirurgut/Mjekut të Përgjithshëm (Certifikatë e Provimit të Shtetit ose Regjistrim në Regjistrin profesional).</p> <p>Kjo zyrë mban dosjen e specializantit që disponon të gjithë dokumentacionin që lidhet me ecurinë akademike të studentit si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - procesverbalet e provimeve që jep secili në fund të çdo viti akademik; - raportet e veprimtarisë praktike të tutorëve klinikë, etj.






	<p>- çdo kualifikim të vlerësuar dhe të certifikuar (punime shkencore të botuara në revista të specializuara, pjesëmarrje të certifikuar në projekte kërkimore, kurse të avancuara dhe specializuese, kurse gjuhësore, etj.).</p> <p><i>Evidenca nr. 44, 57; Vizita në Institucion; evidenca shitesë gjatë vizitës nr. 6.</i></p>		
Konkluzione	<p><i>Sekretaria Mësimore disponon të dhëna individuale për ecurinë akademike të specializantëve që nga momenti i pranimit. Sekretaria Mesimore e UNIZKM është përgjegjëse për mbajtjen e dosjes së specializantit që disponon të gjithë dokumentacionin që lidhet me ecurinë akademike të studentit.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përbashet kryesisht	Përbashet plotësisht
			X



Standardi V.3	
Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1: Studenti informohet në mënyrë të detajuar për programin e studimit, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit.</p>	<p>Studenti pasi përfundon të gjitha hapat e regjistrimit, konsiderohet i regjistruar zyrtarisht dhe mund të ndjekë të gjitha aktivitetet akademike teorike/klinike-praktike që do të zhvillohen në institucionet shëndetësore me të cilat Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi. Universiteti informon studentët mbi Tutorin dhe institucionin shëndetësor ku ai/ajo mund të kryejë aktivitetet klinike-praktike.</p> <p>Vlerësimi i aftësive kryhet nga të gjithë pedagogët dhe tutorët që kanë mbikëqyrur periudhën kohore të konsideruar, duke përdorur metoda të përbashkëta, të vlefshme dhe të riprodhueshme të vlerësimit.</p> <p>Të gjitha vlerësimet në lidhje me secilin mjek specializant diskutohen dhe përmbledhen në një vendim përfundimtar vjetor, i cili vlerësohet nga Këshilli i programit, i cili në tërësi garanton procesin e vlerësimit dhe mbi bazën e tij, vlerësimin e mjekëve për nivelin e realizimit të përgjegjësive.</p> <p>Ky gjykim, vetëm nëse është pozitiv, i lejon mjekut specializant të kalojë në vitin pasardhës ose të pranohet në provimin përfundimtar. Moskalimi i provimit vjetor sjell mundësinë e</p>

	<p>përsëritjes së vitit. Më pas, nëse mospërputhja vazhdon, mjeku specializant do të përjashtohet nga programi.</p> <p><i>Evidenca nr. 12, 25, 34, 58.</i></p>						
<p>Kriteri 2: Studenti informohet nga njëësia përgjegjëse për rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Në fillim të programit të studentëve të specializimit, ai pajiset me Librezën e Studentit, ku shënohen të gjitha notat dhe vlerësimet vjetore të tij. Libreza e Studentit e shoqëron specializantin deri në përfundim të ciklit specializues dhe diplomimin e tij. Specializantët informohen për rezultatet e vlerësimit kur provimi përfundon dhe komisioni komunikon vlerësimin dhe gjithashtu përmes portalit ku secili prej specializantëve ka kredencialet e tij.</p> <p><i>Evidenca nr. 12, 25, 38, 43, 58.</i></p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UNIZKM informon studentët për programin e studimit, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit. UNIZKM, në fillim të programit të specializimit, pajis studentët me Librezën e Studentit, ku shënohen të gjitha notat dhe vlerësimet vjetore të tij. Libreza e Studentit e shoqëron specializantin deri në përfundim të ciklit specializues dhe diplomimin e tij.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					



<p>Standardi V.4 Studenti ka të gjitha kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1: Studenti i pranuar në programin e studimeve specializuese afatgjata ka kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit me karakter akademik e klinik.</p>	<p>UNIZKM ka vënë në dispozicion të studentëve të tij klasa, laboratore, bibliotekë dhe hapësira të tjera të përbashkëta. Strukturat e rrjetit formues me të cilat univeristet ka marrëveshje po ashtu kanë vënë në dispozicion të specializantëve personelin përkatës dhe pajisjet e spitalit në kohëzgjatjen e specializimit. Specializantët mund të udhëzohen dhe të realizojnë ndonjë fazë të specializimit vetëm në strukturat e rrjetit me të cilët kanë kontratë ofruesit e specializimit. Për realizimin e fazave të specializimit në institucionet e rrjetit të deklaruar specializanti njoftohet dhe merr udhëzim nga përgjegjësi i programit.</p> <p><i>Evidenca nr. 12, 28; Vizita në Institucion.</i></p>

<p>Kriteri 2: Programi i studimeve specializuese afatgjata siguron harmonizim të synimeve të studentit në fushën klinike/ diagnostike dhe kërkimore-shkencore dhe, në përfundim të tij, edhe të mundësisë për karrierë profesionale ose punësim.</p>	<p>Programi i studimeve specializuese afatgjata siguron harmonizim të synimeve të studentit në fushën klinike/diagnostike dhe kërkimore-shkencore dhe, në përfundim të tij, edhe të mundësisë për karrierë profesionale ose punësim. Studentit i sigurohet vazhdimisht mbështetje teknike për zhvillimin e aktivitetit klinik dhe kërkimor me të dhënat më të reja në fushën përkatëse. <i>Krijimi i mundësive për mbështetje financiare të specializantëve gjatë kohës së specializimit do të siguronte një qëndrueshmëri në furnizimin e nevojshëm me specialistë të kësaj fushe.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 12, 22, 28.</i></p>
<p>Kriteri 3: Studenti që ndjek programet specializuese afatgjata të studimit ka në dispozicion bibliotekë shkencore të pasur me botime në letër dhe në formë elektronike si dhe infrastrukturë të plotë të IT-së.</p>	<p>Studenët që ndjekin programin e specializimit afatgjatë kanë në dispozicion Bibliotekën e cila ka literaturë prej mbi 18000 tituj të përditësuar vazhdimisht me botime të reja dhe me revista periodike online nga tre baza të dhënash. Në mbështetje të kërkimit shkencor, përveç bazës së të dhënave në dispozicion, ofrohet edhe shërbimi i dërgimit të dokumenteve (document delivery).</p> <p>Universiteti gjithashtu ofron për studentët Licensë për Eëindoës për PC i laptop personal, deri në 5 pajisje, Licensë Office 365 për secilin student, deri në 5 pajisje, AutoCAD, AutoDesk, Lumion dhe licensa të tjera të programeve të përdorimit profesional, si dhe Portal kushtuar studentëve: https://unizkm.onthehub.com, ku ata mund të shkarkojnë aplikacione dhe licensa falas.</p> <p>UNIZKM ka një softëare të menaxhimit universitar të quajtur UniMS (University Management System). Qëllimi i këtij sistemi është dixhitalizimi i të gjithë informacionit të të dhënave të prodhuara gjatë proceseve të mësimdhënies dhe punës administrative në universitet.</p> <p>UniMS mban të gjitha të dhënat e kërkuara nga Regjistri Bazë i Studentëve në bazën e të dhënave, në një mënyrë të ngjashme me ato shkresore, sipas udhëzimeve të Ministrisë.</p> <p>Ekziston gjithashtu nje sistem menaxhimi i llojit ERP (Enterprise Resource Planning) i cili menaxhon dhe koordinon të gjitha proceset e universitetit. Sistemi është zhvilluar brenda universitetit sipas Statutit dhe procedurave dhe rregulloreve të UKZKM, dhe siguron koordinimin e fluksit të punës sipas rregullave.</p> <p>Studentit i sigurohet vazhdimisht mbështetje teknike për zhvillimin e aktiviteteve klinike dhe kërkimeve të lidhura me to.</p>

	<p>Gjithashtu, studenti është i siguruar për të gjithë periudhën pas specializimit dhe për të gjitha aktivitetet e parashikuara në program. Një kopje e policës së sigurimit i jepet studentit.</p> <p><i>Evidenca nr. 12, 28, 59, 60; Evidenca shtesë gjatë vizitës nr. 2.</i></p>
<p>Kriteri 4: Studenti ka mbështetje teknike të mjaftueshme për zhvillimin e aktivitetit klinik dhe kërkimor të lidhur me të.</p>	<p>Institucioni ka siguruar realizimin e programit me teknologji modernë dhe në kushte infrastrukturore cilësore që mundësojnë një proces të mësimdhënies teorike, kërkimore dhe ekperimentale për studentët specializantë dhe për personelin akademik.</p>
<p>Kriteri 5: Hulumtimet që kanë të përfshira kërkime laboratorike mbështeten me bazë laboratorike të mjaftueshme.</p>	<p>Kushtet higjieniko-sanitare sigurohen me përkujdesje të plotë dhe të përhershme duke përfshirë edhe mjetet dezinfektuese dhe mbrojtëse sipas rregullave ligjore në fuqi.</p> <p>Studentit në institucionin shëndetësor i sigurohet vazhdimisht mbështetje teknike për zhvillimin e aktiviteteve klinike dhe kërkimeve laboratorike të lidhura me to.</p> <p><i>Evidenca nr. 12, 53, 54; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 6: Studenti është i siguruar gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe për të gjitha aktivitetet e parashikuara në programin specializues. Për këtë disponohet dokumentacion i mjaftueshëm nga institucioni. Një kopje e policës së sigurimit i dorëzohet studentit në momentin e lidhjes së saj.</p>	<p>Studenti është i siguruar për të gjithë periudhën e specializimit dhe për të gjitha aktivitetet e parashikuara në program. Një kopje e policës së sigurimit i jepet edhe studentit.</p> <p>Studenti është i siguruar për përgjegjësinë profesionale ndaj dëmeve që mund tu shkaktojë personave të tretë si dhe për dëmet që mund të pasojnë gjatë periudhës së specializimit dhe ushtrimit të funksioneve të parashikuara në programin e specializimit.</p> <p>Polica e sigurimit në favor të studentit përcaktohet dhe shlyhet nga Fakulteti përgjegjës për programin e studimit.</p> <p><i>Evidenca nr. 12, 29, 46; Evidenca shtesë gjatë vizitës nr.2</i></p>
<p>Kriteri 7: Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar dhe vendet e punësimit.</p>	<p>Universiteti ka një bazë të dhënash për të diplomuarit, por për momentin nuk ka asnjë të diplomuar për këtë program specializimi. Aktualisht janë regjistruar studentë, të cilët kryejnë specializimin e tyre në struktura të ndyshme shëndetësore me të cilat ka marrëveshje. Studentët e regjistruar në këtë program janë shtetas shqiptarë dhe italianë.</p> <p><i>Evidenca nr. 57; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimeve specializuese afatgjata siguron harmonizim të synimeve të studentit në fushën klinike/diagnostike dhe kërkimore-shkencore dhe, në përfundim të tij, edhe të mundësisë për karrierë profesionale ose punësim. Studentit i sigurohet</i></p>


	<p>vazhdimisht mbështetje teknike për zhvillimin e aktivitetit klinik dhe kërkimor me të dhënat më të reja në fushën përkatëse. UNIZKM vë në dispozicion të studentëve bibliotekë shkencore, infrastrukturë IT-je, bazë laboratorike për kërkime shkencore. Gjatë periudhës së specializimit, studenti është i siguar me policën e sigurimit e cila sigurohet nga Universiteti.</p> <p>Mjekët specializantë pas përvetësimit të aftësive profesionale në fushën specifike të specializimit mund të japin një kontribut të madh për shtetin shqiptar dhe më gjerë në prioritetet e tij për përmirësimin e sektorit shëndetësor, rritjen e numrit të mjekëve specialistë dhe shpërndarjes adekuate gjeografike për të pëmbushur nevojat për mjekë specialiste sipas rajoneve. Krijimi i mundësive për mbështetje financiare të specializantëve gjatë kohës së specializimit do të siguronte një qëndrueshmëri në furnizimin e nevojshëm me specialistë të kësaj fushe.</p>		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
		X	


Standardi V.5	
Institucioni ndjek procedura të qarta për vlerësimin e njohurive të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1: Institucioni ndjek procedura të qarta dhe transparente për vlerësimin në vazhdimësi të dijeve të studentit, të përcaktuara dhe të bëra të ditura që në fillim të programit të studimeve në rregulloren e specializimit.</p>	<p>Në fund të çdo viti akademik organizohet një provim vlerësimi teorik dhe praktik, i cili vlerësohet me notë përfundimtare. Drejtori i programit të specializimit së bashku me Koordinatorin didaktik përcakton datën, modalitetet e zhvillimit të provimit, materialet që sekretaria duhet të përgatisë. Pas përfundimit të provimit, Komisioni (i përbërë nga të paktën 5 anëtarë) mbledhet për të vendosur vlerësimin, i cili i komunikohet me gojë dhe me shkrim secilit specializant.</p> <p>Specializantët që nuk e kalojnë provimin për 5 herë radhazi, marrin certifikatën e moduleve të përfunduara së bashku me kreditet e fituara të trajnimit dhe ndërpresin studimet e specializimit afatgjatë. Në rast vlerësimi pozitiv, procesverbali i dorëzohet sekretarisë i plotësuar dhe i nënshkruar me rezultatet dhe kjo e fundit vazhdon me futjen e rezultateve në portal, të cilat mund të aksesohen edhe nga specializantët në faqen e tyre personale të portalit.</p> <p><i>Evidenca nr. 12, 14, 29, 34.</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al



67




Kriteri 2: Institucioni disponon një sistem të informatizuar për kontrollin dhe vlerësimin e njohurive të marra nga studentët gjatë programit të studimit.

UNIKZM disponon sisteme të menaxhimit:

Menaxhim elektronik universitar-UniMS (University Management System), qëllimi i të cilit është dixhitalizimi i të gjithë informacionit i të dhënave të prodhuara gjatë proceseve të mësimdhënies dhe punës administrative në universitet. Kjo bazë e të dhënave dixhitale përfaqëson të gjithë informacionin shkresor dhe mundësinë e bashkëngjitjes së dokumenteve të skanuara në formatin pdf dhe të tjera. UniMS ruan të gjitha të dhënat e kërkuara nga Regjistri Bazë i Studentëve, në një mënyrë të ngjashme me ato shkresore. UNIKZM disponon edhe një sistem menaxhimi të llojit ERP (Enterprise Resource Planning) i cili menaxhon dhe koordinon të gjitha proceset e universitetit. Sistemi është zhvilluar brenda universitetit sipas statutit dhe procedurave dhe rregulloreve të UNIKZM dhe siguron koordinimin e fluksit të punës sipas rregullave.

Të integruar me ERP janë:

- Portali i Studentëve: adresimi elektronik (e-mail) është pika kryesore e informacionit dhe bashkëpunimit ndërmjet njësive të Universitetit (sekretaria, pedagogët, koordinatorët) dhe studentëve. Studentët mund të identifikohen me emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin e tyre privat, ose me llogaritë e Google @ stud.unizkm.al;
- Portali Pranimeve: Portali i Pranimeve u shërben kandidatëve si pikë informimi, regjistrimi për provimet e pranimit, shfaqja e pikëve dhe pozicioni i tyre në renditje. Më pas u mundëson fituesve të vazhdojnë me regjistrimin ose të tërhiqen nëse nuk janë të interesuar;
- Portali i Bibliotekës: Biblioëeb është një Katalog i Qasjes Publike të Hapur (OPAC), i cili është një paraqitje dixhitale e bibliotekës Paolo Ruatti. Gjithashtu, aksesimi në zonën e rezervuar jep mundësinë e shërbimeve dhe për të bërë kërkesa për blerje: <http://biblioëeb.unizkm.edu.al>;
- WiFi në kampus: Kampusi është i mbuluar me një rrjet pa tel, me SSID të shumta sipas përdorimit dhe aksesit, ku çdo student ka një emër përdoruesi dhe fjalëkalim të dedikuar;
- Klasa në kohë reale: Ky modul është i lidhur me sinjalistikën televizive të cilat janë në çdo ndërtesë dhe japin zënie të klasave, pedagogëve, kursit, lëndës dhe klasës në kohë reale.



	- Aplikacioni i Studentëve: Aplikacioni celular ofron të gjitha shërbimet e portalit studentor, në një ndërfaqe të përshtatshme dhe për aksesin në celular. <i>Evidenca nr. 61.</i>								
Kriteri 3: Konkluzionet e vlerësimit në vazhdimësi, janë të qarta dhe transparente, përfshirë pezullimin, zgjatjen ose përjashtimin nga studimet specializuese.	Studenti mund të hyjë në provimin përfundimtar vetëm pasi të ketë përmbushur të gjitha detyrimet e përcaktuara çdo vit në program dhe pas miratimit të dosjes së tij personale nga Këshilli i Specializimit. <i>Evidenca nr. 12, 32.</i>								
Kriteri 4: Vlerësimi i studentëve bëhet sipas lëndëve që ka ndjekur specializanti gjatë atij viti akademik.	Tutorët klinikë përpilojnë në vazhdimësi (për çdo vit) një raport mbi veprimtarinë praktike të specializantëve, i cili i bashkëlidhet dosjes së tyre në sekretari. <i>Evidenca nr. 12, 29.</i>								
Konkluzione	<i>UNIZKM disponon një sistem të informatizuar për kontrollin dhe vlerësimin e njohurive të marra nga studentët gjatë programit të studimit. Studenti mund të hyjë në provimin përfundimtar vetëm pasi të ketë përmbushur të gjitha detyrimet e përcaktuara çdo vit në program dhe pas miratimit të dosjes së tij personale nga Këshilli i Specializimit.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet jo</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet jo				X
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet jo						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet jo</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet jo				X
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet jo						
			X						

VI. SIGURIMI I CILËSISË NË PROGRAMIN E SPECIALIZIMIT AFATGJATË



Standardi VI.1	
Institucioni dhe njësia përgjegjëse lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të specializimit afatgjatë, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë	Në nivel institucional funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Që nga viti i parë akademik 2004-2005, institucioni ka

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

69

<p>(SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi, dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>aplikuar të njëjtat mekanizma të sigurimit të cilësisë të përdorura në universitete italiane, në të cilat ofrohen të njëjtat programe studimi të përbashkëta. Këto vlerësime zhvillohen në forma të ndryshme, ku forma kryesore e vlerësimit të performancës së programit tëstudimit zhvillohet përmes procesit të vlerësimit nga studentët.</p>
<p>Kriteri 2: Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe ruajtjen e performancës së saj nëpërmjet shqyrtimit dhe mbikëqyrjes së herëpashershme të programeve të studimit të specializimeve afatgjata, në drejtim të pajtueshmërisë së programeve të reja me strategjinë e fakultetit dhe Universitetit, kjo njësi, ka si kompetencë vlerësimin periodik të veprimtarive mësimore të njëjësive kryesore përbërëse të UNIZKM, në përputhje me standardet. Pjesë të kësaj njësie si anëtarë është edhe një ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues i studentëve.</p>
<p>Kriteri 3: Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Organizimi dhe funksionimi i njësisë bëhet në bazë të një Rregulloreje e cila i jep të drejtën e qasjes në të gjitha të dhënat, dokumentet dhe informacionet e tjera të Universitetit dhe në të njëjtën kohë të ruajë konfidencialitetin e dokumentave të mbledhura.</p>
<p>Kriteri 4: Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Në bazë të Statutit të UNIZKM dhe Rregullorës së Njësisë, kjo njësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontrollon ecurinë e menaxhimit të Universitetit dhe aktiviteteve të tij për arritjen e objektivave institucionale; - I paraqet Rektorit dhe Senatit Akademik një raport vjetor mbi mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe shërbimet e ofruara nga Universiteti, si dhe nivelin e funksionalitetit dhe efikasitetit të arritur nga strukturat e ndryshme organizative, duke marrë parasysh veprimtarinë e vitit paraardhës; - informon Rektoratin mbi veprimtarinë e saj, iniciativat e ndërmarra dhe ecurinë e tyre; - shpreh vlerësime dhe i sugjeron Rektoratit propozime mbi objektivat e përcaktuara dhe shkallën e arritjes së tyre, mbi akreditimin institucional dhe programeve të studimit nga institucionet kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi; - bashkëpunon me Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe programeve të Studimit lidhur me hartimin dhe zbatimin e politikave institucionale të sigurimit të






	<p>standardeve institucionale të cilësisë si dhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë.</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë në bashkëpunim me personelin akademik të përfshirë në programin, bën vetëvlerësimin institucional nëpërmjet instrumenteve dhe metodologjive matëse për vlerësim nëpërmjet përpunimit informatik të të dhënave në një sistem të kodifikuar klasifikimi dhe arkivimi.</p> <p>Njësia ka organizuar në bashkëpunim me strukturat e ndryshme të Universitetit një fushatë për mbledhjen e opinioneve me anë të një pyetësori me qëllim të identifikimit të këndvështrimeve të studentëve për tema të ndryshme që kanë të bëjnë me: lëndën (cilësia, përmbajtja etj), koordinimin didaktik / tutorët, pedagogët (marrëdhëniet didaktike, gjithpërfshirja, respektimi i orarit të mësimit etj.).</p> <p><i>Evidenca nr. 12, 15, 39, 62, 63, 64.</i></p>						
Konkluzione	<p><i>UNIZKM harton dhe zbaton politika për sigurimin e cilësisë së programit të specializimit afatgjatë, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. UNIZKM ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</i></p>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>bushet risht</th> <th>Përmobushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	bushet risht	Përmobushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
bushet risht	Përmobushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi VI.2


Institucioni dhe njësia përgjegjëse monitoron dhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kryerësit	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1: Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të specializimit.</p>	<p>UNIZKM ka njësinë përgjegjëse për monitorimin, kontrollin dhe supervizimin e programeve të studimit, Njësia për Vlerësim të Brendshëm të Cilësisë. Njësia, siç e kemi përmendur edhe më lart, mund të shfrytëzojë bashkëpunimin e çdo strukture organizative, administrative, mësimore dhe kërkimore të Universitetit, që konsiderohet e nevojshme për veprimtarinë e saj. Sikurse përmendur edhe më lart, kjo njësi, në bazë të Statutit të UNIZKM dhe Rregullorës së njësisë:</p>



71


	<p>- kontrollon ecurinë e menaxhimit të Universitetit dhe aktiviteteve të tij për arritjen e objektivave institucionale;</p> <p>- i paraqet Rektorit dhe Senatit Akademik një raport vjetor mbi mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe shërbimet e ofruara nga Universiteti, si dhe nivelin e funksionalitetit dhe efikasitetit të arritur nga strukturat e ndryshme organizative, duke marrë parasysh veprimtarinë e vitit paraardhës;</p> <p>- informon Rektoratin mbi veprimtarinë e saj, iniciativat e ndërmarra dhe ecurinë e tyre;</p> <p>- shpreh vlerësime dhe i sugjeron Rektoratit propozime mbi objektivat e përcaktuara dhe shkallën e arritjes së tyre, mbi akreditimin institucional dhe programeve të studimit nga institucionet kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi;</p> <p>- bashkëpunon me Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe programeve të Studimit lidhur me hartimin dhe zbatimin e politikave institucionale të sigurimit të standardeve institucionale të cilësisë si dhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë.</p> <p><i>Evidenca nr. 15, 63, 64, RVB; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 2: Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të specializimit.</p>	<p>Zyrat që ofrojnë më shumë mbështetje për Njësinë janë Zyra e Vlerësimit të Cilësisë dhe kërkimeve, Zyra e Statistikave dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës. Këto zyra mbështesin Njësinë në detyrat e saj të ndryshme institucionale si: në vlerësimin periodik të progresit të mësimdhënies, kërkimin shkencor etj. Në veçanti zyra e Statistikave e cila është përgjegjëse për menaxhimin e ruajtjes, përpunimin e perceptimit të studentëve mbi aktivitetin e realizuar arsimor, praktik dhe shkencor që u ofrohen.</p>
<p>Kriteri 3: Institucioni ka përcaktuar indikatorë dhe tregues cilësorë të matshëm sasiorë për programin e specializimit në kudër të vlerësimit të cilësisë së programit.</p>	
<p>Kriteri 4: Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Nga takimet e realizuara në Institucion, dhe nga dokumenti i paraqitur nga Institucioni, konfirmohet se IAL realizon pyetësorin e studentëve për çdo lëndë dhe se pyetësori për studentët e specializimit afatgjatë është përshtatur sepse kanë specifika të tjera dhe realizohet fizikisht. Gjatë vizitës gjithashtu u tha se në përfundim të këtij procesi hartohet një raport vjetor i cili përcillet tek Dekani dhe Rektori, i cili ka vlerësimet për të gjithë stafin, si dhe secilit pedagog i bëhet me dije që kanë dalë rezultatet dhe mund të marrë vlerësimin e tij privatisht.</p>



72



	<p><i>Përpos elementit të realizimit të pyetësorit të studentëve si më lart cituar, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, evidentohet se në rregulloren për funksionimin e Njesisë së Vlerësimit të Cilësisë, apo në ndonjë dokument tjetër të dorëzuar nga Institucioni, nuk janë të parashikuara në mënyrë të qartë e të detajuar cilat janë mekanizmat që përdoren për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit, cilët janë indikatorët dhe treguesit cilësisë e sasiore për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit, instrumentet matëse dhe vlerësuese të cilësisë së programit, si realizohet procesi i mbledhjes, përpunimit e raportimit të të dhënave të grumbulluara dhe adresimin për përmirësim të gjetjeve përkatëse. Për sa më lart, Institucioni duhet të rishikojë rregulloren e kësaj njësie, për të përfshirë në të elementët e sipërcituar, në përputhje me kërkesat e këtij standardi.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 15, 62, 63, 64, 65, RVB; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 5: Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Sipas deklaramit të Institucionit në RVB, faqe 54, pasi të dhënat mblidhen nga njësitë e ndryshme nga personeli akademik dhe administrativ ku realizohet program i specializimit, njësia paraqet një program vjetor te Rektori dhe Senati akademik mbi veprimtarinë dhe aktivitetin mësimor të Universitetit ku shprehen mendime dhe formulohen gjykime për objektivat, shkallën e arritjes së tyre dhe duke adresuar mangësitë eventuale për përmirësimin e tyre.</p>
<p>Kriteri 6: Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Sikurse cituar dhe më lart, gjatë vizitës në Institucion u tha se në përfundim të këtij procesi hartohet një raport vjetor i cili përcillet tek Dekani dhe Rektori, i cili ka vlerësimet për të gjithë stafin, si dhe secilit pedagog i bëhet me dije që kanë dalë rezultatet dhe mund të marrë vlerësimin e tij privatisht.</p> <p><i>Megjithatë, GVJ nuk disponon ndonjë raport apo dokument provues mbi hartimin e këtij raporti, përcjelljen tek autoritetet e tjera përgjegjëse dhe adresimin e rezultateve të pritshme, të vlerësimeve të marra dhe adresimin e mangësive të evidentuara për përmirësim.</i></p> <p><i>RVB; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UNIZKM ka njësinë përgjegjëse për monitorimin, kontrollin dhe supervizimin e programeve të studimit, Njësia për Vlerësim të Brendshëm të Cilësisë. Përbërja, organizimi dhe funksionimi i saj</i></p>



	<p>janë të parashikuara në Statutin e UNIZKM dhe Rregulloren për funksionimin e njësisë.</p> <p>Nga dokumentacioni i dorëzuar dhe vizita në institucion dëshmohet se UNIZKM realizon një pyetësor për studentët e këtij programi studimi.</p> <p>Përpos elementit të realizimit të pyetësorit të studentëve, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, evidentohet se në rregulloren për funksionimin e Njësisë së Vlerësimit të Cilësisë, apo në ndonjë dokument tjetër të dorëzuar nga Institucioni, nuk janë të parashikuara në mënyrë të qartë e të detajuar cilat janë mekanizmat që përdoren për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit, cilët janë indikatorët dhe treguesit cilësisë e sasiorë për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit, instrumentet matëse dhe vlerësuese të cilësisë së programit, si realizohet procesi i mbledhjes, përpunimit e raportimit të të dhënave të grumbulluara dhe adresimin për përmirësim të gjetjeve përkatëse. Për sa më lart, Institucioni duhet të rishikojë rregulloren e kësaj njësie, për të përfshirë në të elementët e sipërcituar, në përputhje me kërkesat e standardit.</p> <p>UNIZKM deklaron në RVB dhe gjatë vizitës në Institucion se në përfundim të këtij procesi hartohet një raport vjetor i cili përcillet tek Dekani dhe Rektori, i cili ka vlerësimet për të gjithë stafin, si dhe secilit pedagog i bëhet me dije që kanë dalë rezultatet dhe mund të marrë vlerësimin e tij privatisht. Megjithatë, GVJ nuk disponon ndonjë raport apo dokument provues mbi hartimin e këtij raporti, përcjelljen tek autoritetet e tjera përgjegjëse dhe adresimin e rezultateve të pritshme, të vlerësimeve të marra dhe adresimin e mangësive të evidentuara për përmirësim.</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="580 1301 778 1375"></td> <td data-bbox="778 1301 979 1375"></td> <td data-bbox="979 1301 1181 1375">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1181 1301 1394 1375">Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td data-bbox="580 1375 778 1422"></td> <td data-bbox="778 1375 979 1422"></td> <td data-bbox="979 1375 1181 1422">X</td> <td data-bbox="1181 1375 1394 1422"></td> </tr> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi VI.3 Institucioni dhe njësia përgjegjëse përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Vlerësimi i brendshëm i programit të specializimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me	Sipas deklarimeve të Institucionit në RVB: UNIZKM për çdo vit, të dhënat e mbledhura nga pyetësorët e studentëve i përpunon dhe përmbledh në një raport në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43123

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit, apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Statutin e Universitetit. Në përputhje me rregulloret e saj njësia përdor mjete të ndryshme për mbledhjen e informacionit, duke filluar me intervistat e strukturuar ose kërkesat për informacion shpërndarë përmes postës elektronike, deri tek intervistat joformale në mënyrë që të sqarohen ose thellohen temat më me interes ose me mangësi informacioni, për realizimin e të cilave bashkëpunon edhe me strukturat e tjera të IAL. Gjithashtu, mënyrë tjetër për të marrë informacion sidomos nga studentët është edhe nëpërmjet takimeve të realizuara nga Koordinatorit i programit.</p>
<p>Kriteri 2: Për kryerjen e vlerësimit, Institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën që ka programi i specializimit.</p>	<p><i>Institucioni deklaron në RVB se përdoren metodologji të ndryshme për vlerësimin e realizimit dhe ruajtjes së cilësisë së programit. Por, sikundër përmendur edhe në standardin më lart, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, në rregulloren për funksionimin e Njësisë së Vlerësimit të Cilësisë, apo në ndonjë dokument tjetër të dorëzuar nga Institucioni, por as në argumentimin e IAL në RVB, nuk janë të parashikuara në mënyrë të qartë e të detajuar cilat janë metodat e instrumentat e posaçme e të përshtatshme që UNIZKM përdor në përputhje me natyrën dhe specifikën e programit të studimit, metodat e drejtpërdrejta e të tërthorta që përdor në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit (përpos pyetësorit të studentëve), mekanizmat për përfshirjen e palëve të interesuara dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program. Për sa më lart, Institucioni duhet të marrë masa që të përfshijë e parashikojë në aktet e tij të brendshme rregullatore elementët e sipërcituar, në përputhje me kërkesat e këtij standardi.</i></p>
<p>Kriteri 3: Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë.</p>	<p><i>Evidenca nr. 62, 63, 64, 65, RVB; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 4: Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit përdor metoda të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar, të personelit akademik, udhëheqësve dhe partnerëve.</p>	<p><i>Sipas deklarimeve të Institucionit në RVB, UNIZKM për çdo vit, të dhënat e mbledhura nga pyetësorët e studentëve i përpunon dhe përmbledh në një raport në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Statutin e Universitetit, realizon intervista të strukturuar por dhe takime joformale me studentët, si dhe realizon takime me studentët nën drejtimin e Koordinatorit të programit.</i></p> <p><i>Institucioni deklaron në RVB se përdoren metodologji të ndryshme për vlerësimin e realizimit dhe ruajtjes së cilësisë së programit. Por, sikundër përmendur edhe në standardin më lart, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, në rregulloren për</i></p>
<p>Kriteri 5: Mekanizmat e vlerësimit në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të programit, përfshijnë palët e interesuara, institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Konkluzione</p>






	<p><i>funksionimin e Njesisë së Vlerësimit të Cilësisë, apo në ndonjë dokument tjetër të dorëzuar nga Institucioni, por as në argumentimin e IAL në RVB, nuk janë të parashikuara në mënyrë të qartë e të detajuar cilat janë metodat e instrumentat e posaçme e të përshtatshme që UNIZKM përdor në përputhje me natyrën dhe specifikën e programit të studimit, metodat e drejtpërdrejta e të tërthorta që përdor në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit (përpos pyetësorit të studentëve), mekanizmat për përfshirjen e palëve të interesuara dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program. Për sa më lart, Institucioni duhet të marrë masa që të përfshijë e parashikojë në aktet e tij të brendshme rregullatore elementët e sipërcituar, në përputhje me kërkesat e këtij standardi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet jo
		X		



Standardi VL4

Institucioni përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e mara në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1: Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit.</p>	<p>UNIZKM me qëllim të sigurimit të cilësisë përfshin aktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Kjo njësi përbëhet nga personel i universitetit, bashkëpunëtorë të jashtëm si dhe përfaqësues të studentëve.</p> <p>Forma kryesore e vlerësimit të cilësisë së programit të studimit, bëhet nëpërmjet vlerësimit të drejtpërdrejtë të studentëve mbi procesin formues dhe personelin akademik.</p>
<p>Kriteri 2: Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit, dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>UNIZKM këtë proces e kryen në nivelin institucional, për të gjitha programet e studimit gjithashtu për programin e studimit Specializim afatgjatë në Sëmundjet e Aparatit Kardiovaskular përmes plotësimi të një formulari vlerësimi, ku ata shprehen për cilësinë, organizimin, zbatimin e procesit të formimit, mbi metodologjinë, mësimdhënien, mbi infrastrukturën e trajnimit, angazhimin e stafit akademik, shërbimet ndaj studentëve, mbi përdorimin e bibliografisë, etj.</p>
<p>Kriteri 3: Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës-</p>	



<p>akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UNIZKM këtë vlerësim e ka strukturuar në nivel institucional dhe zbatohet përmes përfshirjes së stafit akademik, atij administrativ dhe të studentëve të Specializimit.</p>			
<p>Kriteri 4: Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni siguron përfshirje aktive të gjithë aktorëve të brendshëm në procese ciklike duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj pabarazie ose diskriminimi mbi çdo bazë ndaj personelit dhe studentëve.</p>			
<p>Kriteri 5: Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, mund të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>NjëVBC mbledh informacionin që i nevojitet nga të gjitha strukturat duke filluar nga njësia bazë që është përgjegjëse për këtë program dhe me të gjitha zyrat e mbështetjes.</p> <p>Institucioni me qëllim të vlerësimit më të plotë në procesin e vlerësimit kyç edhe institucione të jashtme që merren me vlerësimin dhe zhvillimin e cilësisë si dhe organet tjera rregullatore si Urdhri i mjekësve, asociacionin e mbrojtjes së pacientëve dhe të tjera të ngjashme.</p>			
<p>Kriteri 6: Monitorimi i ecurisë akademike e programit dhe sigurimi i cilësisë, është pjesë e veprimitarisë së njësisë përgjegjëse që ofron programin dhe NJSBC.</p>	<p>Aktorët e programit të Specializimit afatgjatë për Sëmundjet e Aparatit Kardiovaskular, studentët, personeli teknik administrativ dhe pedagogët janë të përfshirë dhe përgjegjës në proceset e ndryshme të menaxhimit dhe zhvillimit të programit të studimit përmes konsultimeve, takimeve periodike në të cilat diskutohen dhe shqyrtohen problemet e ndryshme që lindin nga koha gjatë specializimit dhe zgjidhjet e identifikuara për të siguruar nivelin e lartë të cilësisë së programit të studimit.</p>			
	<p><i>Evidenca nr. 15, 17, 38, 46, 63, 64; Vizita në Institucion.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në ruajtjen dhe sigurimin e cilësisë në realizimin e programit të specializimit janë të kyçura njësitë akademike dhe stafi respektiv, studentët nëpërmjet procedurave të Sigurimit të brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe për rezultatet e vlerësimit informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p><input type="checkbox"/></p>	<p><input type="checkbox"/></p>	<p><input type="checkbox"/></p>	<p><input checked="" type="checkbox"/></p>

Standardi VL5



Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1: Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>UNIZKM mësimdhënien e ka shtyllën kryesore mbi të cilën bazohet jeta e Universitetit dhe marrëdhënia mes studentëve, pedagogëve dhe administratës që është thelbësore për suksesin e programit të studimit. UNIZKM në Statutin e tij ka definuar mbështetjen e politikave të tij të cilësisë së mësimdhënies të integruar me kërkimin shkencor për të inkurajuar transferimin e kufirit të dijes në realizimin e programit të specializimit. Rezultati i perceptimit të studentëve është transparent dhe publikohet në faqen e internetit të universitetit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin në fuqi.</p> <p><i>Evidenca nr. 15, 64, 66, RVB.</i></p>
<p>Kriteri 2: Institucioni dhe njësia përgjegjëse publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	
<p>Kriteri 3: Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Sipas deklarimeve në RVB, faqe 57, rezultatet e vlerësimit shoqërohen nga një plan masash, të cilat adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive dhe pikave të dobëta të theksuara, <i>por GVJ nuk disponon një dokument provues të planit të masave të hartuar.</i></p>
<p>Kriteri 4: Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Përkushtimi i institucionit për rritjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dëshkohet nga rishikimi aktiv dhe sigurimi i efikasitetit dhe ndikimit të aktiviteteve në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca nr. 15, 64; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 5: Institucioni dhe njësia përgjegjëse organizon veprimtari periodike me personelin akademik përgjegjëse dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit.</p>	<p>Institucioni, në bashkëpunim me njësinë, planifikon aktivitete të rregullta që përfshijnë stafin dhe studentët për të nxitur mirëkuptimin dhe ndërgjegjen për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë.</p> <p><i>RVB; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UNIZKM mbështet politikat e tij të cilësisë së mësimdhënies të integruar dhe kërkimit shkencor për të inkurajuar transferimin e kufirit të dijes në realizimin e programit të specializimit.</i></p> <p><i>Sipas deklarimeve të IAL, rezultatet e vlerësimit shoqërohen nga një plan masash, të cilat adresojnë dhe synojnë përmirësimin e</i></p>

	<p><i>mangësive dhe pikave të dobëta të theksuara, por GVJ nuk disponon një dokument provues të planit të masave të hartuar.</i></p> <p><i>Institucioni, në bashkëpunim me njësinë, planifikon aktivitete të rregullta që përfshijnë stafin dhe studentët për të nxitur mirëkuptimin dhe ndërgjegjen për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë. Rezultati i perceptimit të studentëve është transparent dhe publikohet në faqen e internetit të Universitetit.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit specializues afatgjatë në “Sëmundje të aparatit kardiovaskular”, ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Me programin e specializimit afatgjatë në “Sëmundje të aparatit kardiovaskular” synohet që të kontribuohet në ngritjen dhe modernizimin e nivelit profesional në fushën e Kardiologjisë dhe përmirësimin e nevojave për një numër më të madh të mjekëve specialistë në këtë fushë specialistike në Republikën e Shqipërisë dhe më gjerë.
2. Programi i studimit realizohet nga një staf akademik profesional nga UNIZKM dhe universiteti bashkëpunues “Tor Vergata” Romë, që paraqet një dimension plotësues për një orientim të fuqishëm ndërkombëtarizimi.

Pika të dobëta:

1. Rregullorja e programit të studimit specializues nuk është përditësuar në përputhje me VKM Nr. 824, datë 24.12.2021 për miratimin e Kodit të Cilësisë, dispozitat e parashikuara në rregullore lidhur me kohëzgjatjen maksimale të studimeve në këtë program nuk janë në përputhje me parashikimet e nenit 90 të LAL 80/2015, si dhe në rregullore mungojnë parashikime lidhur me lidhjen e kontratës me specializantët fitues, edhe pse gjatë vizitës në Institucion u verifikua se Institucioni lidh kontratë me secilin specializant. *(Standardi II.2/Standardi II.4/Standardi II.6)*
2. Në modelin e vlerësimit nga tutori klinik nuk ka një shprehje me njësi matëse të punës së kryer në strukturën spitalore përkatëse. *(Standardi II.1)*
3. Dy prej strukturave shëndetësore me të cilat institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunim nuk i plotësojnë të gjitha kriteret e parashikuara pasi jo të gjitha janë qendra spitalore, si dhe spitali i hapur së fundmi nga UNIZKM, nuk ka një pavion kardiologjie, pavioni funksionon si pavion patologjie jo i ndarë sipas specialiteteve dhe nuk është akredituar ende sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. *(Standardi III.2/Standardi III.4/Standardi III.5)*
4. Mungon një raportim i mirëfilltë i hartuar nga institucioni mbi ecurinë e programit të specializimit afatgjatë. *(Standardi II.11)*
5. Në rregulloren për funksionimin e Njësisë së Vlerësimit të Cilësisë nuk janë të parashikuara në mënyrë të qartë e të detajuar cilat janë mekanizmat që përdoren për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit, cilët janë indikatorët dhe treguesit cilësorë e sasiorë për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit, instrumentet matëse dhe vlerësuese të cilësisë së programit, si realizohet procesi i mbledhjes, përpunimit e raportimit të të dhënave të grumbulluara dhe adresimi për përmirësim i gjetjeve përkatëse. *(Standardi VI.2/Standardi VI.5)*
6. Institucioni nuk ka parashikuar në mënyrë të qartë e të detajuar, në rregulloren për funksionimin e Njësisë së Vlerësimit të Cilësisë, apo në ndonjë dokument tjetër të brendshëm të Institucionit, se cilat janë metodat e drejtpërdrejta e të tërthorta që institucioni përdor në kuadër të vlerësimit të realizimit të programit. *(Standardi VI.3)*


Rekomandime:

1. Institucioni duhet të përditësojë rregulloren e programit të studimit, për të qenë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. *(Standardi II.2/Standardi II.4/Standardi II.6)*
2. Aktivitetet e realizura në raportin e tutorit të prezantohen me numrin e realizuar ose të asistimeve respektivisht pjesëmarrjes në aktivitetin e kërkuar. *(Standardi II.1)*
3. Institucioni, të sigurojë që strukturat shëndetësore spitalore me të cilat nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e aktivitetit praktik të studentëve specializantë, të plotësojnë të gjitha kriteret e parashikuara nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Gjithashtu, institucioni në vijim, të sigurojë infrastrukturën e përshtatshme në spitalin e ri të hapur, të lidhur me fushën e specialitetit të këtij programi studimi, si dhe të nënshtrohet procedurave të akreditimit të spitalit. *(Standardi III.2/Standardi III.4/Standardi III.5)*
4. Institucioni, të realizojë një studim të mirëfilltë dhe me informacion të plotë mbi ecurinë e programit të specializimit afatgjatë. *(Standardi II.11)*
5. Institucioni, të rishikojë rregulloren e Njesisë së Vlerësimit të Cilësisë për të përfshirë në të parashikime të qarta e të detajuara mbi mekanizmat që përdoren për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit, indikatorët dhe treguesit cilësorë e sasiorë për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit, instrumentet matëse dhe vlerësuese të cilësisë së programit, si realizohet procesi i mbledhjes, përpunimit e raportimit të të dhënave të grumbulluara dhe adresimi për përmirësim i gjetjeve përkatëse. *(Standardi VI.2/Standardi VI.5)*
6. Institucioni, të parashikojë në mënyrë të qartë e detajuar, në rregulloren për funksionimin e Njesisë së Vlerësimit të Cilësisë, apo në ndonjë dokument tjetër të brendshëm të Institucionit, metodat e drejtpërdrejta e të tërthorta që institucioni përdor në kuadër të vlerësimit të realizimit të programit, mekanizmat për përfshirjen e palëve të interesuara dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program. Gjithashtu, institucioni të sigurojë shoqërimin e rezultateve të vlerësimit me një plan masash që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. *(Standardi VI.3)*

Evaluation's conclusions for the long term specialization study program in "Diseases of cardiovascular apparatus", provided by the Higher Education Institution Catholic University "Our Lady of Good Counsel"

Strengths and affirmations:

1. With the long-term specialization program in "Diseases of cardiovascular system" it is intended to contribute to raising and modernizing the professional level in the field of Cardiology and improving the needs for a greater number of specialist doctors in this specialist field in the Republic of Albania and beyond.



2. The study program is carried out by a professional academic staff from UNIZKM and the collaborating university “Tor Vergata” Rome, which represents a complementary dimension for a strong internationalization orientation.

Weaknesses:

1. The regulation of the specialization study program has not been updated in accordance with DCM No. 824, dated 24.12.2021 for the approval of the Quality Code, the provisions provided in the regulation regarding the maximum duration of studies in this program are not in accordance with the provisions of Article 90 of LAL 80/2015, as well as the regulation lack provisions regarding the conclusion of the contract with the winning specialists, even though during the visit to the Institution it was verified that the Institution concludes a contract with each specialist. *(Standard II.2/Standard II.4/Standard II.6)*
2. In the evaluation model by the clinical tutor, there is no expression with measurement units of the work performed in the relevant hospital structure. *(Standard II.1)*
3. Two of the health structures with which the institution has signed a cooperation agreement do not meet all the stipulated criteria as not all of them are hospital centers, as well as the hospital recently opened by UNIZKM does not have a cardiology ward, the ward functions as a ward pathology not divided according to specialties and has not yet been accredited according to the requirements of the legislation in force. *(Standard III.2/Standard III.4/Standard III.5)*
4. There is a lack of a genuine report drawn up by the institution on the progress of the long-term specialization program. *(Standard II.11)*
5. In the regulation for the operation of the Quality Assessment Unit, are not provided in a clear and detailed manner the mechanisms that are used for the review, approval and occasional supervision of the program, the qualitative and quantitative indicators and indicators for the assessment of the quality of the study program, the measuring and evaluation instruments of the quality of the program, how the process of collection, processing and reporting of the collected data is carried out and the addressing for improvement of the relevant findings. *(Standard VI.2/Standard VI.5)*
6. The Institution has not provided in a clear and detailed manner, in the regulation for the operation of the Quality Assessment Unit, or in any other internal document of the Institution, what are the direct and indirect methods that the institution uses in the framework of evaluation of program implementation. *(Standard VI.3)*

Recommendations:

1. The institution should update the regulation of the study program, to be in accordance with the legal and by-laws in force. *(Standard II.2/Standard II.4/Standard II.6)*
2. The activities carried out in the tutor's report should be presented with the number of assistances or participation in the required activity. *(Standard II.1)*
3. The institution shall ensure that the hospital health structures with which it signs a cooperation agreement for the realization of the practical activity of the specialized

students, meet all the criteria provided by the legal and by-laws in force. Also, in the following, institution must provide the appropriate infrastructure in the newly opened hospital, related to the field of specialty of this study program, as well as must undertake the accreditation procedures for the hospital. (*Standard III.2/Standard III.4/Standard III.5*)

4. The institution should carry out a genuine study with complete information on the progress of the long-term specialization program. (*Standard II.11*)
5. The institution should review the regulation of the Quality Assessment Unit to include in it clear and detailed provisions on the mechanisms used for the review, approval and periodic supervision of the program, qualitative and quantitative indicators for the assessment of the quality of the study program, measuring and evaluation instruments of the quality of the program, how the process of collection, processing and reporting of collected data is carried out and the addressing for improvement of relevant findings. (*Standard VI.2/Standard VI.5*)
6. The Institution should provide in a clear and detailed manner, in the regulation for the operation of the Quality Assessment Unit, or in any other internal document of the Institution, the direct and indirect methods that the institution uses in the framework of the evaluation of the realization of program, the mechanisms for the involvement of interested and other parties that are involved in the realization or that serve to evaluate the knowledge and competences obtained from this program. Also, the institution should ensure the association of the evaluation results with a plan of measures that address and aim to improve the identified deficiencies and weaknesses. (*Standard VI.3*)

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
			Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. KUADRI I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT SPECIALIZIM AFATGJATË				X
II. ORGANIZIMI, STRUKTURA DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT				X
III. BURIMET NË FUNKSION TË PROGRAMIT SPECIALIZIM AFATGJATË			X	
IV. KËRKIMI DHE EKSPERIENCA KLINIKE /DIAGNOSTIKUESE				X
V. STUDENTËT				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË NË PROGRAMIN E SPECIALIZIMIT AFATGJATË			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X